dukagjini
shtëpia botuese publishing house




*Dhurata Tara Nixha,*
*Miranda Stavileci, Lindita Lutaj*

## LIBRI I MËSUESIT/ES

# SHOQËRIA DHE MJEDISI

PËR KLASËN E TRETË TË ARSIMIT FILLOR

3

## Përmbajtja

Hyrje......................................................................................................................................4

Pse është i rëndësishëm studimi i librit “Shoqëria dhe mjedisi 3”?............................................5

Tabela e përmbajtjes së njësive mësimore.........................................................................6

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI
LËNDA: SHOQËRIA DHE MJEDISI…………………………………………………….…….....10
REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCAT KRYESORE TË SHKALLËS 1

PLANIFIKIMI VJETOR
Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi/ Klasa: E tretë..........................................................14

PLANI DYMUJOR: shtator - tetor
Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi/ Lënda mësimore:.....................................................15
Shoqëria dhe mjedisi Klasa: III

PLANI DYMUJOR: nëntor- dhjetor
Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi/ Lënda mësimore:......................................................20
Shoqëria dhe mjedisi Klasa: III

PLANI DYMUJOR: janar – shlkurt-mars
Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi/ Lënda mësimore:.....................................................27
Shoqëria dhe mjedisi Klasa: III

PLANI DYMUJOR: prill – maj - qershor
Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi/ Lënda mësimore:.....................................................32
Shoqëria dhe mjedisi Klasa: III

Kriteret e vlerësimit.............................................................................................................38

Vlerësimi sipas periudhave…………………………………………………………………39

Lojëra didaktike…………………………………………………………………………….41

**Hyrje**

**Të nderuar mësues/e dhe prindër,**

Lënda "Shoqëria dhe mjedisi 3" është pjesë e fushës kurrikulare Edukim për shoqërinë dhe është vazhdim i tekstit "Shoqëria dhe mjedisi 2". Ky tekst kërkon pajisjen e nxënësve me njohuri të qëndrueshme, shkathtësi dhe shprehi qytetare. Vend të zënë në këtë tekst zë edhe edukimi dhe formimi i nxënësve me qëndrime dhe vlera të rëndësishme për një shoqëri demokratike. Në qendër të gjithë procesit të edukimit qytetar të nxënësve qëndron gërshetimi i njohurive që ata zotërojnë me sjelljet që reflektojnë qytetari në mjedise të ndryshme. Ajo që duhet theksuar është fakti se ky tekst krijon mundësi për pjesëmarrje, vendimmarrje, tolerancë, mirëkuptim, solidaritet etj.

**Çfarë përmban libri?**

Libri "Shoqëria dhe mjedisi 3" është konceptuar në përputhje me programin "Shoqëria dhe mjedisi" të miratuar nga MASHT-i. Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që t'i arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat që trajtohen në klasën e tretë, të dala nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) "Shoqëria dhe mjedisi". Për të realizuar të nxënit bashkëkohor dhe sipas standardeve që kërkohen sot, mësuesi/ja duhet ta analizojë lidhjen me Kurrikulën Bërthamë. Nisur nga kompetencat që nxënësi/ja duhet t'i zotërojë, sidomos kompetencën e qytetarisë, ky libër ia krijon mundësinë mësuesit t'i përdorë metodat, strategjitë dhe teknikat në qendër me nxënësin dhe procesin e të nxënit. Ky tekst bën të mundur që nxënësit të kuptojnë rolin dhe përgjegjësitë që ata kanë në familje, në shkollë dhe në shoqëri, duke krijuar hapësira për vetëveprim dhe bashkëpunim me njëri-tjetrin.

Formimi i shprehive praktike zë një vend të rëndësishëm në këtë tekst, gjë e cila realizohet nëpërmjet veprimtarive të planifikuara për t'u realizuar brenda dhe jashtë mjedisit të shkollës, si dhe atyre që do të realizohen në komunitet. Teksti e ndihmon mësuesin në planifikimin dhe realizimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve, në gërshetimin më të mirë të punës individuale dhe asaj me gjithë klasën. Teksti mundëson që mësuesi me punën e tij të dalë jashtë mureve të klasës dhe të shkollës, duke krijuar hapësira dhe mundësi për zhvillimin e mendimeve dhe të ideve të nxënësve.

Teksti u mundëson nxënësve që të jenë pjesë aktive e shoqërisë, të bëjnë propozime konkrete për ndryshimin e rregullave, mbi bazë argumentesh. Promovohet toleranca dhe diversiteti që

duhet t`i karakterizojë nxënësit në jetën e përditshme, si dhe aftësimi i tyre për t'u bërë të vetëdijshëm në marrjen e vendimeve të drejta.

**Pse është i rëndësishëm studimi i librit "Shoqëria dhe mjedisi 3"?**

Teksti "Shoqëria dhe mjedisi 3" është i thjeshtë, i qartë dhe i kuptueshëm për nxënësit e kësaj moshe. Ai ua krijon nxënësve mundësinë për pjesëmarrje aktive, për vlerësim dhe vetëvlerësim. Nxënësit aftësohen që t'i komentojnë ilustrimet e dhëna, të dinë të japin mendime të ndryshme për vazhdimësinë e situatave të dhëna, t'i zgjidhin problemet me të cilat përballen, të japin argumente për zgjidhjen e situatave problemore etj. Teksti mundëson integrimin më të mirë me të gjitha fushat e tjera të procesit mësimor, si: Gjuha dhe Komunikimi, Njeriu dhe Natyra, Matematika, Artet, Shkathtësi për jetën, Edukata Fizike, Sportet dhe Shëndeti etj.

Teksti mundëson kërkimin e informacioneve shtesë nga nxënësit, duke iu përshtatur aftësive psikosociale të tyre. Krijon mundësi për fleksibilitet, duke ua lënë në dorë të lirë mësuesve për zbatimin e tij në mënyrë krijuese. Mundëson bashkëpunimin e nxënësve me njëri-tjetrin, me mësuesin, me institucione të ndryshme për ta realizuar të nxënit efektiv.

Në tekst janë dhënë disa modele orientuese të orëve mësimore, të cilat nuk janë detyrimisht të zbatueshme. Mbështetur në nivelin e nxënësve tuaj, në mundësitë reale që keni në shkollë dhe në klasë, si dhe në përvojën e grumbulluar ndër vite, ju mund të përdorni metoda, strategji dhe teknika të ndryshme në funksion të temave mësimore, duke i përshtatur ato me nivelin e nxënësve, si dhe me kushtet në të cilat punoni. Libri është mjet pune shumë i domosdoshëm për mësuesit në planifikimin dhe realizimin e veprimtarive mësimore të nxënësve. Po ashtu, nëpërmjet këtij teksti, prindërit do ta kenë mundësinë që t'ua lehtësojnë të nxënit fëmijëve të tyre. Veç tekstit bazë, ata do të përdorin edhe fletoren e punës, internetin, enciklopeditë, vizitat jashtë mjediseve të shkollës etj.

Në vlerësimin e nxënësve, mësuesi/ja duhet të ketë parasysh jo vetëm informacionin teorik që ata zotërojnë, por edhe zbatimin praktik të njohurive të marra. Po ashtu, rëndësi t'i kushtohet edhe vlerësimit të aftësive bashkëpunuese që nxënësit kanë në marrëdhënie me të tjerët. Mësuesi gjatë gjithë punës së tij duhet të ketë parasysh që vlerësimi i nxënësve të ketë karakter motivues, pasi kjo lëndë i përgatit ata si qytetarë aktivë të së nesërmes, për t'i marrë rolet dhe përgjegjësitë që u takojnë në të ardhmen.

**AUTORËT**

## TABELA E PËRMBAJTJES SË NJËSIVE MËSIMORE:

## SHOQËRIA DHE MJEDISI 3


- **NË ARKIVIN E FAMILJES**

Mirë se erdhe në klasën e tretë
Unë dhe familja ime
Paraardhësit dhe pasardhësit e familjes sime
Sendet e vlefshme të familjes sime
Ngjarjet në familje
Veprimtaria 1- Albumi i familjes

- **UNË, KLASA DHE SHKOLLA IME**

Jetojmë së bashku
Grupet shoqërore
Unë dhe familja
Unë dhe shkolla
Unë dhe komuniteti
Respektojmë njëri-tjetrin
Planifikojmë dhe veprojmë
Pjesëmarrja ime
Veprimtaria 2- Gjelbërojmë mjedisin në shkollë dhe në komunitet

- **UNË KAM TË DREJTA NË SHKOLLË DHE NË SHOQËRI**

Të drejtat dhe përgjegjësitë
Unë kam të drejta në familje
Të drejtat e mia në shkollë
Përgjegjësitë në komunitet

Ndal dhunës në familje

Jo, dhunës në shkollë

**NGJARJE DHE AKTIVITETE NË VENDIN TIM**

Shkolla ime

Bukuritë e vendit tim

Festojmë së bashku

Mjediset natyrore dhe kulturore të vendit tonë

Ekspozita jonë - Ngjarje dhe aktivitete në vendbanimin tim

**TË AFËRMIT E MI JETOJNË NË VENDE TË NDRYSHME**

Atdheu

Të afërmit e mi jetojnë larg atdheut

Vendndodhja e të afërmve të mi

Ruajmë traditat tona

Jemi të ngjashëm, por ndryshojmë

- **RAPORTI NJERI - NATYRË**

Mjedisi ku jetoj

Pasuritë natyrore të vendit tim

Njeriu dhe natyra

Ndotja e mjedisit

Flora dhe fauna

Kujdesem për bimët

Kujdesem për kafshët

Uji është jetë

Rëndësia e ujit për jetën e njeriut

Toka dhe ajri

- **LLOJLLOJSHMËRI NË SHOQËRI**

Të gjithë së bashku

Diversiteti etnik e kulturor

Jetojmë së bashku me tolerancë e

dashuri Njeriu dhe profesionet

- **SË BASHKU DHE TË BARABARTË**

Të ndryshëm, por të barabartë

Të punojmë së bashku

Veprimtaria 3 - "Unë, ti, të barabartë"

- **KONSULTOHEMI SË BASHKU DHE VENDOSIM**

Vendosim së bashku në familje

Vendosim së bashku në shkollë

Vendimmarrja në komunitet

Respektojmë mendimin ndryshe

Përvojat na ndihmojnë

Edhe unë vendos

Si të marr një vendim të drejtë

Ekskursioni 1- Vizitë në kuvendin komunal: Si merren vendimet?

- **LLOJET E PASURIVE DHE NDARJA E TYRE**

Pasuritë natyrore

Pasuritë nëntokësore

Trashëgimia e profesioneve

Kursejmë energjinë

Riciklimi i mbetjeve

Veprimtaria 4 - Ta mbrojmë mjedisin ku jetojmë

- **GJENDJA E MJEDISIT NË VENDBANIMIN TIM**

Njeriu dhe mjedisi natyror

Njeriu dhe mjedisi kulturor

Një mjedis i pastër për të gjithë

Kujdesem për higjienën personale

Higjiena në komunitet

Lojë zbavitëse

Provo veten

Projekti "Gazeta jonë", 2 orë

Ekskursioni 2- ”Shijojmë bukuritë natyrore të vendit tonë”, **2 orë**

**FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI**
**LËNDA: SHOQËRIA DHE MJEDISI**
**REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCAT KRYESORE TË SHKALLËS 1**

| |
|---|
| **I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv**<br><br>1. Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë.<br><br>3.Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.<br><br>4.Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësimdhënësi), përmbajtja e të cilit nuk përmban më shumë se një faqe tekst të shtypur.<br><br>5.Shpreh mesazhin e dhënë të një teksti të thjeshtë letrar të lexuar, përmes njërës nga format shprehëse, si: të folurit, shkrimit, vizatimit, dramatizimi - luajtjes me role, këngës apo vallëzimit.<br><br>7.Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët, si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera. |
| **II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ**<br><br>1.Gjen dhe ndan në grup veçoritë e përbashkëta dhe veçoritë dalluese ndërmjet gjallesave, ndërmjet ngjarjeve apo ndërmjet dukurive të njohura për të.<br><br>6.Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, shoqërore - historike) në njërën nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie.<br><br>7.Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shndërrimeve apo pozitave në kohë e në hapësirë dhe bashkëveprimit) të tyre. |
| **III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm**<br><br>1.Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërës nga format e shprehjes.<br><br>2.Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.<br><br>3.Identifkon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar, duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shenjuar me shenja të ndryshme). |

| |
|---|
| 4.Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.<br><br>5.Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një aktiviteti të caktuar.<br><br>7. Identifkon cilësitë e veta që i posedon dhe cilësitë e nevojshme që duhet t'i zhvillojë për të nxënë një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët.<br><br>8. Menaxhon sjelljet e veta, materialet/mjetet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/ aktiviteti individual apo të përbashkët në klasë/shkollë apo jashtë saj. |
| **IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv**<br><br>3.Përgatit një projekt të vogël, duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupojnë atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre etj.<br><br>5.Diskuton me moshatarët për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë apo për një grup të caktuar njerëzish në raport me të tjerët apo me mjedisin që e rrethon gjatë realizimit të një aktiviteti të caktuar. |
| **V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë**<br><br>1.Prezanton para të tjerëve rregullat themelore të higjienës personale (p.sh., fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit të vet, në të cilin jeton dhe vepron.<br><br>6.Propozon alternativa për zgjidhjen konstruktive të një konfikti ndërpersonal, duke i analizuar paraprakisht me kujdes rrethanat që kanë shkaktuar konfliktin, ndan përvojat, mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit.<br><br>8.Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).<br><br>9.Përkujdeset për një mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes dhe pjesëmarrësve të tjerë kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.). |

| VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm |
| --- |
| 1.Paraqet në forma të ndryshme të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të familjes së vet dhe i diskuton ato me të tjerët, më pas i krahason me të drejtat dhe përgjegjësitë e nxënësve, mësuesve dhe stafit menaxhues në shkollë apo me pjesëtarët e ndonjë institucioni.<br><br>2.Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.<br><br>3.Propozon vlera shoqërore, që janë të rëndësishme të kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si p.sh. besimi i ndërsjellë, toleranca, solidariteti, respekti, mirësjellja etj.) dhe me shembull konkret përshkruan ndonjë situatë ku gjen shprehje ndonjëra nga ato.<br><br>5.Merr pjesë në hartimin e rregullave të lojës, në klasë, në shkollë (p.sh., si propozues rregullash, menaxhues i propozimeve nga të tjerët etj.) dhe argumenton rëndësinë e respektimit të ndonjë rregulle të propozuar në forma të ndryshme të shprehjes, duke parashikuar pasojat e moszbatimit të saj.<br>6.Identifkon dy e me shumë organizime shoqërore dhe përshkruan (në formë të shkruar apo në ndonjë formë tjetër) mënyrat/mundësitë se si njerëzit e ndryshëm me përvoja të ndryshme mund të organizojnë diçka të përbashkët.<br><br>7.Prezanton në mënyrë kronologjike ndryshimet e familjes dhe të rrethit në aspekte të ndryshme (si: objektet e banimit, festat, veshjet, ushqimet-mënyra e të ushqyerit, menaxhimi i ekonomisë familjare, të drejtat, përgjegjësitë dhe vendimmarrja në familje etj.) ose disa nga personalitetet dhe ngjarjet kryesore të popullit të vet, duke e dalluar të tashmen nga e kaluara. |

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:**

| 1. **Mëson për vetveten, strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e përfshirjes në to:** |
| --- |
| 1.1. Identifkon dhe krahason dëshmi të thjeshta (objekte, mjete, fotografi, veshje dhe gjëra të tjera), që lidhen me ngjarje personale, familjare dhe të komunitetit ku jeton dhe i klasifkon sipas kronologjisë. |
| 1.2. Dallon strukturën e grupeve të ndryshme shoqërore, si p.sh.: familja, shkolla, etj., dhe mund të bëjë krahasime si kanë qenë ato dikur dhe si janë tani. |
| 1.3. Kupton dhe respekton të drejtat e njeriut dhe të drejtat themelore të fëmijëve si mënyra më e mirë për mbrojtjen e individëve dhe të bashkësisië nga padrejtësitë. |
| 2. **Njeh rëndësinë e monumenteve dukurive, proceseve historike, shoqërore, natyrore e mjedisore, si dhe lidhjet dhe ndikimet ndërmjet tyre:** |

| |
|---|
| 2.1. Identifkon ngjarje shoqërore, kulturore e historike të nivelit lokal, vendor, kombëtar e më gjerë dhe shkaqet që sollën ato. |
| 2.3. Tregon respekt për trashëgiminë kulturore e natyrore, si dhe shpreh solidaritet në proceset shoqërore ku ai është i përfshirë. |
| 3. **Njeh dhe mëson t'i zbatojë normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet:** |
| 3.1. Dallon llojllojshmërinë e etnive, kulturave, racave, besimeve, profesioneve në shoqëri dhe shpreh respekt për këtë diversitet. |
| 3.2. Tregon ndërgjegjshmëri për dallimet gjinore, liritë dhe të drejtat e njeriut dhe demonstron tolerancë dhe solidaritet në komunikim dhe bashkëpunim me të tjerët. |
| 4. **Përfshihet në dhënien e ideve, propozime dhe merr vendime në mënyrë të përgjegjshme:** |
| 4.1. Identifkon dhe shpjegon faktorët që duhet t`i marrë parasysh me rastin e marrjes së vendimeve në situata të ndryshme nga jeta e përditshme. |
| 4.2. Kupton nivelet e ndryshme të vendimmarrjes në institucione dhe në shoqëri, dikur dhe tani, dhe i respekton ato në veprimet e tij. |
| 5. **Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit, si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm:** |
| 5.1. Shpjegon disa nga shkaqet dhe pasojat e rreziqeve natyrore e shoqërore si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe veprimeve të njeriut dhe merr pjesë në aktivitete për ruajtjen e mjedisit dhe përkujdesjen për trashëgiminë. |
| 5.2. Bashkëpunon me të tjerët dhe ndërmerr veprime të dobishme që promovojnë mjedisin e pastër, kujdeset për përdorim të drejtë të të mirave jetësore, për higjienën e përgjithshme dhe për atë personale. |

## PLANIFIKIMI VJETOR

**Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi        Klasa: E tretë**

| Lëndët e fushës kurrikular | TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE DHE PERIUDHAVE | | | | Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës |
|---|---|---|---|---|---|
| | **shtator-tetor 17 orë** | **nëntor – dhjetor 16 orë** | **janar- shkurt-mars 19 orë** | **prill-maj-qershor 22 orë** | |
| **Lënda: Shoqëria dhe mjedisi** | Në arkivin e familjes<br>(6 orë);<br>Unë, klasa dhe shkolla ime<br>(9 orë);<br>Unë kam të drejta në shkollë dhe në shoqëri<br>( 2 orë). | Unë kam të drejta në shkollë dhe në shoqëri<br>( 4 orë);<br>Ngjarje dhe aktivitete në vendin tim<br>(5 orë);<br>Të afërmit e mi jetojnë në vende të ndryshme<br>(5 orë);<br>Raporti njeri-natyrë<br>( 2 orë). | Raporti njeri-natyrë<br>( 8 orë);<br>Llojllojshmëri në shoqëri<br>(5 orë);<br>Së bashku, por të barabartë<br>(3 orë);<br>Konsultohemi së bashku dhe vendosim<br>( 3 orë). | Konsultohemi së bashku dhe vendosim<br>( 5 orë);<br>Llojet e pasurive dhe ndarja e tyre<br>( 6 orë);<br>Gjendja e mjedisit në vendbanimin tim<br>( 11 orë). | **Komunikues efektiv:**<br>**I-1,3,7**<br>**Mendimtar kreativ;**<br>**II-1, 6,7**<br>**Nxënës i sukseshëm**<br>**III-1,4, 8**<br>**Kontribues produktiv**<br>**IV- 1, 3, 4, 5,**<br>**Individ i shendoshë**<br>**V- 6, 8, 9**<br>**Qytetar i përgjegjshëm**<br>**VI- 1,2, 5, 6** |

## PLANI DYMUJOR: shtator - tetor

**Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi** **Lënda mësimore: Shoqëria dhe mjedisi** **Klasa: III**

**Tema mësimore:** Në arkivin e familjes

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:**

| | |
|---|---|
| **I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv** | I.1, 3 |
| **II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ** | II.1, 6 |
| **III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm.** | III.1, 5, 7 |
| **IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv** | IV. 5 |
| **V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë** | V. 8 |
| **VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm** | VI.1,7 |

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:**

1. Mëson për vetveten, strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e përfshirjes në to.

**1.1,2 ; 3.1**
**Tema mësimore: Unë, klasa dhe shkolla ime**

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:**

| | |
|---|---|
| **I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv** | I.1, 3 |
| **II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ** | II. 7 |

**III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm.** III. 2, 8

**IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv** IV.3,5

**V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë** V.1,8

**VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm** VI.2,5

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:**

1. Mëson për vetveten, strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e përfshirjes në to

1.1 ; 4.1; 5. 2

**Tema mësimore: Unë kam të drejta në shkollë dhe në shoqëri**

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:**

**I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv** I.7

**II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ** II. 1

**III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm** III. 1

**IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv** IV. 5

**V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë** V.1

**VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm** VI. 1, 2

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:**

1. Mëson për vetveten, strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e përfshirjes në to 1.1, 2, 3

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore | Njësitë mësimore | Koha e mësimore (orë mësimore) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Në arkivin e familjes** | -Grumbullon gjësende të veçanta të familjes dhe të komunitetit, i klasifikon ato sipas llojit dhe bën prezantimin e tyre (në klasë, në grup, etj.).<br><br>-Mbledh informacione për ngjarje të rëndësishme, nga familjarët dhe të tjerët, gjen të përbashkëtat dhe dallimet në mes tyre dhe i prezanton ato para të tjerëve.<br><br>-Krahason ngjarjet personale dhe familjare, dikur dhe sot dhe i evidenton ndryshimet në mënyrë kronologjike, përmes kujtimeve, fotove familjare dhe gjësendeve të tjera.<br><br>-Përshkruan grupet shoqërore ku bën pjesë (në familje, në klasë, në | 1. Mirë se erdhe në klasën e tretë.<br>2. Unë dhe familja ime.<br>3. Paraardhësit dhe pasardhësit e familjes sime.<br>4. Sendet e vlefshme të familjes sime.<br>5. Ngjarjet në familje.<br>6. Veprimtaria - Albumi i familjes. | | Lexim i drejtuar;<br>-Semafori<br>-Diagrami i Venit;<br>-Copëzat e përziera;<br>-Diskutim i lirë;<br>- Zgjidh situatën;<br>- Stilolapsat në mes;<br>- Kllaster;<br>- Stuhi mendimesh;<br>- Ditari dypjesësh;<br>- RAFT;<br>- Di, dua të di mësova;<br>- Të nxënit në bashkëpunim;<br>Lojëra;<br>Përralla;<br>Vjersha;<br>Këngë. | Vëzhgimi në klasë;<br>Evidencë e vlerësimit të vazhdueshëm;<br>Vlerësimi përmes portofolios;<br>Vlerësimi përmes përshkrimeve me komente konstruktive. | Gjuhë dhe komunikimi;<br><br>Artet;<br><br>Jeta dhe puna;<br><br>Matematika. | Edukata shoqërore 1 – 5;<br>Interneti dhe burime të tjera. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Unë , klasa dhe shkolla ime** | shkollë etj.) dhe dallon përbërjen e tyre.<br><br>-Dallon llojllojshmërinë në klasë, në shkollë dhe në shoqëri dhe tregon mirëkuptim dhe respekt ndaj të tjerëve ndryshe.<br><br>-Tregon shembuj konkretë të aktiviteteve shkollore (shënime të ditëve të veçanta, koncerte, shfaqje, gara, gjelbërimin e mjedisit etj.) dhe përshkruan mënyrën e planifikimit të tyre.<br><br>-Merr pjesë aktive në organizimin e aktiviteteve në klasë dhe në shkollë dhe kontribuon në mënyrë kreative në realizimin e tyre.<br>Planifikon bashkërisht me bashkëmoshatarët, aktivitete të ndryshme<br><br>duke përcaktuar përbërjen dhe rolin e secilt anëtar pjesëmarrës. | 1.Jetojmë së bashku.<br><br>2.Grupet shoqërore.<br><br>3.Unë dhe familja<br><br>4.Unë dhe shkolla.<br><br>5.Unë dhe komuniteti.<br><br>6.Respektojmë njëri-tjetrin.<br><br>7.Planifikojmë dhe veprojmë.<br><br>8.Pjesëmarrja ime.<br><br>9.Veprimtaria 2- Gjelbërojmë mjedisin në shkollë dhe në komunitet. | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Unë kam të drejta në shkollë dhe në shoqëri** | -Identifikon të drejtat themelore në familje, në klasë, në shkollë dhe në shoqëri dhe i respekton ato.<br><br>-Dallon raste të shkeljes së të drejtave të fëmijëve: në familje, në shkollë dhe në komunitet (cenimi i shprehjes së lirë, braktisja e shkollës, puna e detyruar, dhuna fizike e psikologjike etj.).<br><br>-Dallon përgjegjësitë e veta, të anëtarëve të familjes, të bashkësisë, të shkollës dhe argumenton rëndësinë e zbatimit të tyre për të mirën e përgjithshme. | 1.Të drejtat dhe përgjegjësitë.<br><br>2.Unë kam të drejta në familje. | | | | |

**PLANI DYMUJOR: nëntor- dhjetor**

**Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi** **Lënda mësimore: Shoqëria dhe mjedisi** **Klasa: III**

**Tema mësimore: Unë kam të drejta në shkollë dhe në shoqëri**
**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:**

**I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv** I.7

**II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ** II. 1

**III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm** III. 1

**IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv** IV.
5

**V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë** V.1

**VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm** VI. 1, 2

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:**

1. Mëson për vetveten, strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e përfshirjes në to.

1.1, 2, 3

**Tema mësimore: Ngjarje dhe aktivitete në vendin tim**
**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:**

**I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv** I.1, 3

**II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ** II.1, 6

**III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm** III.8

**IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv** IV. 5

**V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë** V.1

**VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm** VI.3

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:**

1. Mëson për vetveten, strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e përfshirjes në to.

5. 2
**Tema mësimore: Të afërmit e mi jetojnë në vende të ndryshme**
**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:**

**I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv** I.1,7

**II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ** II. 6

**III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm.** III.1, 4

**IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv.**
IV.5

**V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë** V.1

**VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm** VI.6, 7

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:**

1. Mëson për vetveten, strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e përfshirjes në to

1.1,2 ; 3.1
**Tema mësimore: Raporti njeri natyrë**

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:**

**I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv** I.1, 7

**II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ** II.1, 6, 7

**III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm** III. 4

**IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv** IV. 5

**V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë** V. 9

**VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm** VI.1

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:**

1. Mëson për vetveten, strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e përfshirjes në to.

2. 3 ; 5.1,2

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore | Njësitë mësimore | Koha e mësimore (orë mësimore) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Unë kam të drejta në shkollë dhe në shoqëri** | -Identifikon të drejtat themelore në familje, në klasë, në shkollë dhe në shoqëri dhe i respekton ato.<br><br>-Dallon raste të shkeljes së të drejtave të fëmijëve: në familje, në shkollë dhe në komunitet (cenimi i shprehjes së lirë, braktisja e shkollës, puna e detyruar, dhuna fizike e psikologjike etj.). | 1.Të drejtat e mia në shkollë.<br>2.Përgjegjësitë në komunitet.<br>3.Ndal dhunës në familje.<br>4.Jo dhunës në shkollë. | 4 | Lexim i drejtuar;<br>-Semafori;<br>-Diagrami i Venit;<br>-Copëzat e përziera;<br>-Diskutim i lirë;<br>-Zgjidh situatën;<br>-Stilolapsat në mes;<br>- Kllaster;<br>- Stuhi mendimesh;<br>- Ditari dypjesësh;<br>- RAFT;<br>- Di, dua të di mësova;<br>- Të nxënit në bashkëpunim;<br>Lojëra;<br>Përralla;<br>Vjersha;<br>Këngë. | Vëzhgimi në klasë;<br>Evidencë e vlerësimit të vazhdueshëm;<br>Vlerësimi përmes portofolios;<br>Vlerësimi përmes përshkrimeve me komente konstruktive. | Gjuhë dhe komunikimi;<br>Artet;<br>Jeta dhe puna;<br>Matematika. | Edukata shoqërore 1 – 5;<br>Interneti dhe burime të tjera. |
| **Ngjarje dhe aktivitete** | -Dallon përgjegjësitë e veta, të anëtarëve të familjes, të bashkësisë, të shkollës dhe argumenton rëndësinë e zbatimit të tyre për të mirën e përgjithshme.<br><br>-Identifikon disa nga ngjarjet që | 1.Shkolla ime. | 5 | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **në vendin tim** | organizohen në shkollë dhe në rrethin e tij dhe shpjegon arsyet e manifestimeve të tyre.<br><br>-Dallon ndonjë zonë të veçantë (natyrore dhe kulturore) në vendbanimin e tij dhe më gjerë, i veçon në bazë të dedikimit, funksionimit dhe shpreh kujdes për to. | 2.Bukuritë e vendit tim.<br><br>3.Festojmë së bashku.<br><br>4. Mjediset natyrore dhe kulturore të vendit tonë.<br><br>5.Ekspozita jonë: Ngjarje dhe aktivitete në vendbanimin tim. | 5 | | | | |
| **Të afërmit e mi jetojnë në vende të ndryshme** | -Liston vendbanimet e të afërmve të tij, brenda dhe jashtë vendit dhe tregon ku gjenden ato.<br><br>-Identifikon dallimet dhe ngjashmëritë (në | 1.Atdheu.<br><br>2.Të afërmit e mi jetojnë larg atdheut. | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Raporti njeri-natyrë**<br><br>etj.) | sjellje, në gjuhë, në veshje, në ushqim, në afinitete etj.) e të afërmve të tij brenda dhe jashtë vendit.<br><br>-Identifikon objekte dhe dukuri natyrore (lumi, liqeni, fusha, kodra, mali, era, etj), të cilat kanë shërbyer dhe i shërbejnë njeriut për udhëtim, për ushqim, për energji etj.<br><br>-Përshkruan veprimet e njeriut për transformimin e vazhdueshëm të natyrës (hapja e tokave të reja, rritja e plleshmërisë së tokës, çelja e kanaleve për ujitje dhe lundrim, akumulimi i ujit – liqene artificiale, ndërtimi i rrugëve,urave dhe<br>-Identifikon disa nga këto transformime në vendbanimin e tij. | 3.Vendndodhja e të afërmve të mi.<br><br>4.Ruajmë traditat tona.<br><br>5.Jemi të ngjashëm, por ndryshojmë.<br><br>1.Mjedisi ku jetoj.<br><br>2.Pasuritë natyrore të vendit tim. | 2 | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | -Dallon anët negative të ndërhyrjes së njeriut në natyrë (ndotja e mjedisit, shpyllëzimi, erozioni, dëmtimi i florës dhe i faunës etj.) dhe përshkruan disa nga këto dukuri në vendbanimin e tij.<br><br>-Shpjegon ndërvarësinë njeri-natyrë dhe shfaq përgjegjësi për ruajtjen e natyrës (ndaj bimëve, kafshëve, ujit, tokës dhe ajrit). | | | | | | |

## PLANI  DYMUJOR: janar – shlkurt-mars

**Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi**  **Lënda mësimore: Shoqëria dhe mjedisi**  **Klasa: III** **Tema mësimore: Raporti njeri-natyrë**

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:**

| | |
|---|---|
| **I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv** | I.1, 7 |
| **II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ** | II.1, 6, 7 |
| **III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm** | III. 4 |
| **IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv** | IV. 5 |
| **V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë** | V. 9 |
| **VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm** | VI.1 |

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:**

1. Mëson për vetveten, strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e përfshirjes në to

2. 3 ; 5.1,2

**Tema mësimore: Llojllojshmëri në shoqëri**
**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:**

| | |
|---|---|
| **I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv** | I.1 |
| **II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ** | II. 6 |

**III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm** III.1

**IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv** IV.3

**V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë** V.1

**VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm** VI.3

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:**

1. Mëson për vetveten, strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e përfshirjes në to

1.2, 3 ; 3.1,2;
Tema mësimore: Së bashku, por të barabartë
**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:**

**I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv** I.1

**II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ** II. 6

**III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm** III.1

**IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv** IV.3

**V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë** V.1

**VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm** VI.3

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:**

1. Mëson për vetveten, strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e përfshirjes në to

1.2, 3 ; 3.1,2;

**Tema mësimore: Konsultohemi së bashku dhe vendosim**

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

**I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv** I.1, 3

**II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ** II.6

**III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm** III.1, 8

**IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv** IV.5

**V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë** V. 6, 8

**VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm** VI. 2, 5

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

1. Mëson për vetveten, strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e përfshirjes në to

1.1 ; 4.1, 2

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore | Njësitë mësimore | Koha e mësimore (orë mësimore) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Raporti njeri- natyrë** | -Identifikon objekte dhe dukuri natyrore (lumi, liqeni, fusha, kodra, mali, era, etj), të cilat kanë shërbyer dhe i shërbejnë njeriut për udhëtim, për ushqim, për energji etj.<br>Përshkruan veprimet e njeriut për transformimin e vazhdiueshëm të natyrës (hapja e tokave të reja, rritja e plleshmërisë së tokës, çelja e kanaleve për ujitje dhe lundrim, akumulimi i ujit – liqene artificiale, ndërtimi i rrugëve, urave etj.) dhe identifikon disa nga këto transformime në vendbanimin e tij.<br><br>-Dallon anët negative të ndërhyrjes së njeriut në natyrë (ndotja e mjedisit, shpyllëzimi, erozioni, dëmtimi i florës dhe i faunës etj.) dhe përshkruan disa nga këto dukuri në vendbanimin e tij. | 1.Njeriu dhe natyra.<br>2.Ndotja e mjedisit.<br>3.Flora dhe fauna.<br>4.Kujdesem për bimët.<br>5.Kujdesem për kafshët.<br>6.Uji është jetë.<br>7.Rëndësia e ujit për jetën e njeriut.<br>8.Toka dhe ajri. | 8 | Lexim i drejtuar;<br>-Semafori;<br>-Diagrami i Venit;<br>-Copëzat e përziera<br>- Diskutim i lirë;<br>- Zgjidh situatën;<br>-Stilolapsat në mes;<br>- Kllaster;<br>- Lojëra;<br>- Përralla;<br>- Vjersha;<br>- Këngë. | Vëzhgimi në klasë;<br>Evidencë e vlerësimit të vazhdueshëm;<br>Vlerësimi përmes portofolios;<br>Vlerësimi përmes përshkrimeve me komente konstruktive. | Gjuhë dhe komunikimi;<br><br>Artet;<br><br>Jeta dhe puna;<br><br>Matematika. | Edukata shoqërore 1 – 5;<br>Interneti; dhe burime të tjera. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Llojllojshmëri në shoqëri** | -Shpjegon ndërvarësinë njeri-natyrë dhe shfaq përgjegjësi për ruajtjen e natyrës (ndaj bimëve, kafshëve, ujit, tokës dhe ajrit).<br><br>-Dallon llojllojshmërinë kulturore, etnike dhe fetare në mjedisin e tij shoqëror (familje, shkollë, komunitet) dhe shpjegon thjesht këto dallime. | 1.Të gjithë së bashku.<br><br>2.Diversiteti etnik e kulturor.<br><br>4.Jetojmë së bashku me tolerancë e dashuri. | 5 | | | | |
| **Së bashku, por të barabartë** | -Identifikon profesione të ndryshme (mësues, mjek, artist, polic, murator, bujk etj.) dhe arsyeton këtë llojllojshmëri veprimtarie | 5.Njeriu dhe profesionet. | 3 | | | | |
| **Konsultohemi së bashku dhe vendosim** | -Demonstron mirëkuptim dhe solidaritet midis të ndryshmve (në aspektin gjinor) dhe angazhohet për trajtim të barabartë mes tyre. | 1.Të ndryshëm, por të barabartë.<br><br>2.Të punojmë së bashku. | 3 | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | -Demonstron gatishmëri për bashkëpunim gjinor (djalë, vajzë) në aktivitetet grupore (lojë, detyra, gara etj.).<br>-Vlerëson komunikimin (në familje, në grup dhe në shkollë) si element të përbashkët pozitiv për vendimmarrje të qëndrueshme.<br><br>-Diskuton me të tjerët përvoja të ndryshme, para se të marrë vendime për situata nga jeta e përditshme.<br><br>-Gjykon se mendimet e ndryshme midis shokëve e shoqeve janë përparësi dhe jo pengesë për vendimmarrje të drejtë.<br><br>-Trajton vendimin e të tjerëve dhe vlerëson në mënyrë objektive (pa anime, tendenca) atë vendim. | 3.Veprimtaria 3- "Unë, ti, të barabartë".<br><br>1.Vendosim së bashku në familje.<br>2.Vendosim së bashku në shkollë.<br>3.Vendimmarrja në komunitet. | | | | | |

## PLANI DYMUJOR: prill – maj - qershor

**Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi** **Lënda mësimore: Shoqëria dhe mjedisi** **Klasa: III** **Tema mësimore:**

**Konsultohemi së bashku dhe vendosim**

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:**

| | |
|---|---|
| **I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv** | I.1, 3 |
| **II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ** | II.6 |
| **III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm** | III.1, 8 |
| **IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv** | IV.5 |
| **V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë** | V. 6, 8 |
| **VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm** | VI. 2, 5 |

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:**

1. Mëson për vetveten, strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e përfshirjes në to

1.1 ; 4.1, 2
**Tema mësimore: Llojet e pasurive dhe ndarja e tyre**
**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:**

| | |
|---|---|
| **I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv** | I.1, 7 |
| **II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ** | II. 1, 6, 7 |

| | |
|---|---|
| **III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm** | III.1, |
| **IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv** | IV.1 |
| **V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë** | V.9 |
| **VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm** | VI. 7 |

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:**

1. Mëson për vetveten, strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e përfshirjes në to

1.1 ; 2. 3 ; 3.1 ; 4.1; 5.1

**Tema mësimore: Gjendja e mjedisit në vendbanimin tim**
**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:**

| | |
|---|---|
| **I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv** | I.1, 7 |
| **II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ** | II. 1, 6, 7 |
| **III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm** | III. 4 |
| **IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv** | IV. 5 |
| **V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë** | V.1,9 |
| **VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm** | VI.6 |

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:**

1. Mëson për vetveten, strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e përfshirjes në to
   2. 3 ; 5.1,2

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore | Njësitë mësimore | Koha e mësimore (orë ...) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Konsultohemi së bashku dhe vendosim** | -Vlerëson komunikimin (në familje, në grup, dhe shkollë) si element të përbashkët pozitiv për vendimmarrje të qëndrueshme.<br><br>-Diskuton me të tjerët përvoja të ndryshme, para se të marrë vendime për situata nga jeta e përditshme.<br><br>-Gjykon se mendimet e ndryshme midis shokëve e shoqeve janë përparësi dhe jo pengesë për vendimmarrje të drejtë.<br><br>-Trajton vendimin e të tjerëve dhe vlerëson në mënyrë objektive (pa anime, | 1.Respektojmë mendimin ndryshe.<br>2.Përvojat na ndihmojnë.<br>3.Edhe unë vendos.<br>4.Si të marr një vendim të drejtë.<br>5.Ekskursioni - Vizitë në kuvendin komunal «Si merren vendimet»! | 5 | Lexim i drejtuar;<br>-Semafori;<br>-Diagrami i Venit;<br>-Copëzat e përziera;<br>-Diskutim i lirë;<br>-Zgjidh situatën;<br>-Stilolapsat në mes;<br>- Kllaster;<br><br>- Lojëra;<br>- Përralla;<br>- Vjersha;<br>- Këngë. | Vëzhgimi në klasë;<br>Evidencë e vlerësimit të vazhdueshëm;<br>Vlerësimi përmes portofolios;<br>Vlerësimi përmes përshkrimeve me komente konstruktive. | Gjuhë dhe komunikimi;<br><br>Artet;<br><br>Jeta dhe puna;<br><br>Matematika. | Edukata shoqërore 1 – 5;<br>Interneti dhe burime të tjera. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Llojet e pasurive dhe ndarja e tyre**<br><br>**Gjendja e mjedisit në vendbanimin tim** | tendenca) atë vendim.<br><br>-Dallon pasuritë natyrore, (tokësore dhe nëntokësore, si: xehet, ujërat, toka e punueshme etj.) dhe humane (trashëgimia kulturore, arsimimi, profesionet etj.).<br><br>-Ndërlidh llojin e pasurive natyrore dhe humane me vendbanimin (lokalitetin, rrethin) e tij/saj.<br><br>-Prezanton shembuj të shfrytëzimit racional të pasurive në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm (si pëdorimi racional i ujit, energjisë elektrike, drurëve, riciklimi i mbetjeve të ndryshme etj.) dhe tregon se mbrojtja e tyre nuk d.m.th. mosshfrytëzim. | 1.Pasuritë natyrore.<br>2.Pasuritë nëtokësore.<br>3.Trashëgimia e profesioneve.<br>4.Kursejmë energjinë.<br>5.Riciklimi i mbetjeve.<br>6.Veprimtaria 4- Ta mbrojmë mjedisin ku jetojmë. | 6<br><br>11 | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | -Përshkruan të veçantat e mjedisit natyror dhe kulturor (p.sh.: bimët, kafshët, malet, fushat, vendbanimet, fabrikat, rrugët, etj.), karakteristikë e vendit ku jeton, që tërheqin vëmendjen e vizitorëve.<br><br>-Tregon se njeriu është përgjegjës për përkujdesjen, mirëmbajtjen e mjedisit dhe shkaktar kryesor i ndotjes së tij.<br><br>-Demonstron veprime konkrete (në klasë, në shtëpi apo në rrethinë) për një ambient dhe mjedis të qëndrueshëm. | 1.Njeriu dhe mjedisi natyror.<br>2.Njeriu dhe mjedisi kulturor.<br>3.Një mjedis i pastër për të gjithë.<br>4.Kujdesem për higjienën personale.<br>5.Higjiena në komunitet.<br>6.Lojë zbavitëse.<br>7.Provo veten.<br><br>8.Projekt «Gazeta jonë» - 2 orë.<br><br>9.Ekskursioni 2:" Shijojmë bukuritë natyrore të vendit tonë"- 2 orë. | | | | | |

Kriteret e vlerësimit

| Elementet | Arritje minimale | Arritje mesatare | Arritje e kënaqshme | Arritje shumë e lartë |
|---|---|---|---|---|
| **Njohuritë**<br><br>Përgjigjet me gojë dhe me shkrim në detyrat e caktuara. | -Paraqet vështirësi në të shprehur.<br><br>-Me vështirësi kupton pyetjen që i drejtohet. | -Përgjigjet mirë në pyetjet e thjeshta.<br><br>-Kryen një pjesë të detyrave gjatë orës. | -Përdor idetë e tij/saj për t'u përgjigjur në detyrat e dhëna.<br><br>-Kupton pjesën më të madhe të detyrave. | -Gjen mënyra të reja të zgjidhjes së problemeve dhe i lidh ato me situata jetësore.<br>-Zgjidh pa problem të gjitha detyrat. |
| **Kërkesat**<br><br>Kontroll /përcjellje e vazhdueshme: Puna individuale Puna në grup | -Vështirë i kupton detyrat;<br><br>-Ka vështirësi në korrigjimin e gabimit;<br><br>-Punimet janë të thjeshta. | -Kupton një pjesë të detyrave;<br><br>-Përmirëson vetë gabimin;<br><br>-Punimet janë të zakonshme. | -Gjen dhe përmirëson gabimin që bën gjatë kryrjes së detyrave;<br><br>-Mirë lidh paranjohuritë me njohuritë e reja;<br><br>-Punimet janë të përfunduara bukur. | -Shërbehet me tekstin në mënyrë të pavarur;<br><br>-Idetë janë interesante, gjithëpërfshirëse dhe të zbatueshme;<br><br>-Punimet janë të bukura dhe kreative. |
| **Përparimi**<br><br>Detyrat e shtëpisë;<br>Aktivite gjatë orës;<br>Përparimi në zgjidhjen e detyrave. | -Detyrat janë të kryera pjesërisht;<br><br>-Përparon ngadalë;<br><br>-I nevojitet ndihmë e vazhdueshme. | -Kryen mirë detyrat rregullisht;<br><br>-Shihet dukshëm përparimi;<br><br>-Kryen në mënyrë të pavarur një pjesë të detyrave. | -Kryen detyrat saktë dhe me përpikëri;<br><br>-Është aktiv gjatë orës;<br><br>-Aplikon njohuritë e reja në zgjidhjen e detyrave. | -Kryen detyrat duke përdorur edhe burime të tjera;<br><br>-Është aktiv gjatë orës dhe i gatshëm t'i ndihmojë të tjerët;<br><br>-Diskuton për detyrat në mënyrë kritike. |

| Vlerësimi sipas periudhave |
| --- |
| Rezultatet që duhet t'i përmbushin nxënësit për t'u vlerësuar gjatë periudhave të vitit shkollor |

| Periudha e parë | Periudha e dytë | Periudha e tretë | Periudha e katërt |
| --- | --- | --- | --- |
| -Mbledh informacione për ngjarje të rëndësishme, nga familjarët dhe të tjerët, i prezanton ato para të tjerëve.<br><br>-Krahason ngjarjet personale dhe familjare, dikur dhe sot.<br>-Përshkruan grupet shoqërore ku bën pjesë (në familje, në klasë, në shkollë etj.) dhe dallon përbërjen e tyre.<br>-Tregon shembuj konkretë të aktiviteteve shkollore dhe përshkruan mënyrën e planifikimit të tyre.<br>-Planifikon bashkërisht me bashkëmoshatarët, aktivitete të ndryshme, duke përcaktuar përbërjen dhe rolin e secilit anëtar pjesëmarrës.<br>-Identifikon të drejtat themelore në familje, në klasë, në shkollë dhe në shoqëri dhe i respekton ato. | -Dallon raste të shkeljes së të drejtave të fëmijëve: në familje, në shkollë dhe në komunitet.<br>-Dallon përgjegjësitë e veta, të anëtarëve të familjes, të bashkësisë, të shkollës dhe argumenton rëndësinë e zbatimit të tyre për të mirën e përgjithshme.<br><br>-Identifikon disa nga ngjarjet që organizohen në shkollë dhe në rrethin e tij dhe shpjegon arsyet e manifestimeve të tyre.<br><br>-Dallon ndonjë zonë të veçantë (natyrore dhe kulturore) në vendbanimin e tij dhe më gjerë dhe shpreh kujdes për to.<br>-Liston vendbanimet e të afërmve të tij, brenda dhe jashtë vendit dhe tregon ku gjenden ato.<br><br>-Identifikon dallimet dhe ngjashmëritë e të afërmve të tij brenda dhe jashtë vendit.<br>-Identifikon objekte dhe dukuri natyrore, të cilat kanë shërbyer dhe i shërbejnë njeriut për udhëtim, për ushqim, për energji etj. | -Dallon anët negative të ndërhyrjes së njeriut në natyrë dhe përshkruan disa nga këto dukuri në vendbanimin e tij.<br><br>-Shpjegon ndërvarësinë njeri-natyrë dhe shfaq përgjegjësi për ruajtjen e natyrës.<br>-Dallon llojllojshmërinë kulturore, etnike dhe fetare në mjedisin e tij shoqëror dhe shpjegon thjesht këto dallime.<br>-Identifikon profesione të ndryshme dhe arsyeton këtë llojllojshmëri veprimtarie.<br><br>-Demonstron mirëkuptim dhe trajtim të barabartë dy mes gjinive.<br>-Demonstron gatishmëri për bashkëpunim gjinor (djalë, vajzë) në aktivitetet grupore.<br>-Vlerëson komunikimin (në familje, në grup, dhe shkollë) si element të përbashkët pozitiv për vendimmarrje të qëndrueshme. | -Dallon pasuritë natyrore (tokësore dhe nëntokësore, dhe humane (trashëgimia kulturore, arsimimi, profesionet etj.).<br>-Ndërlidh llojin e pasurive natyrore dhe humane me vendbaniminin tij/saj.<br>Prezanton shembuj të shfrytëzimit racional të pasurive në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm, si: pëdorimi racional i ujit, i energjisë elektrike, i drurëve, riciklimi i mbetjeve të ndryshme etj.)<br><br>-Përshkruan të veçantat e mjedisit natyror dhe kulturor karakteristika të vendit ku jeton, që tërheqin vëmendjen e vizitorëve.<br>Tregon se njeriu është përgjegjës për përkujdesjen, mirëmbajtjen e mjedisit dhe shkaktar kryesor i ndotjes së tij. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | -Demonstron veprime konkrete (në klasë, në shtëpi apo në rrethinë) për një ambient dhe mjedis të qëndrueshëm. |

## Lojëra didaktike

Shkollat e sotme bashkëkohore përdorin metoda e teknika për mësimdhënie atraktive dhe kreative. Këto metoda didaktike u mundësojnë nxënësve të jenë pjesëmarrës aktivë të procesit të mësimnxënies. Mësuesit udhëzojnë nxënësit të fitojnë njohuri të reja me punë të pavarur, duke hulumtuar edhe përmes lojërave didaktike, me të cilat mësimi është shumë joshës. Me ndihmën e lojërave didaktike nxënësit marrin përvoja të dobishme dhe krijojnë marrëdhënie të mira me shokët /shoqet. Lojërat në procesin e mësimdhënies mundësojnë: mësimnxënien pa stres, të shprehurit e lirshëm dhe respekt për njëri- tjetrin.
Përmes lojërave didaktike, në një ambient me klimë pozitive, nxënësi merr njohuri dhe i lidh ato me jetën e tij / saj.

**Diskutimi në rreth** - Përfshin të gjithë nxënësit në diskutim. Me këtë lojë u ndihmojmë nxënësve më të tërhequr t'i shprehin lirshëm mendimet e tyre.

**Mikrofoni magjik** – Ndihmon mbajtjen e rregullit në klasë, kur njëri flet, të tjerët dëgjojnë. Nxënësi, që merr mikrofonin, flet (përgjigjet, shpreh mendimin). Ai, që do të marrë fjalën, ngrit dorën dhe fillon të flasë, pasi ta marrë mikrofonin.

**Topi tregon** – ndihmon zhvillimin e bisedës në klasë. Nxënësi që ka topin iu përgjigjet pyetjes ose shpreh mendimin për temën e caktuar. Nxënësi, që ngre dorën, e gjuan topin dhe vazhdon me mendimin. Loja vazhdon duke përfshirë sa më shumë nxënës. Në këtë lojë nxënësit i nxitni për t'i shprehur mendimet, mos ua përmirësoni shumë gabimet që mund t'i bëjnë. Qëllimi është ta fitojnë guximin për t'u shprehur.

**Lajmet** – Përgatit në klasë një tavolinë dhe një karrige, ku nxënësit do të lexojnë sikur janë moderatorë të lajmeve në televizor. Nxënësi, që do të lexojë, do të ulet në karrige dhe do ta luajë rolin e moderatorit.

**Puzle** – lojë që mundëson bashkëpunimin në grup. Prit në copa një figurë që ka lidhje me temën që mësoni dhe futi copat në një kovertë. Kërko nga nxënësit t'i ngjesin copat dhe ta zbulojnë figurën. Fiton lojën grupi që e kryen detyrën më shpejt.

**Emisioni për fëmijë** – Përgatit një rreth me disa karrige ku do të mbahet emisioni. Mësuesi luan lojën e moderatorit të emisionit për fëmijë. Fton në emision fëmijët, me të cilët do të bisedojë dhe u bën pyetjet (pyetjet duhet të jenë rreth mësimeve që keni mësuar). Kjo lojë i nxit nxënësit të përgjigjen me shumë kënaqësi.

| **Kapitulli:** Në arkivin e familjes<br>**Tema:** Mirëserdhe në klasën e tretë |
|---|

**Situata e të nxënit**: Prezantimi i vetes, ndryshimet nga klasa e parë deri në të tretën.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1,3, II.1, 6 III.1, 5, 7, IV. 5, V.8, VI.1, 7

**RNF**: 1.1, 2 ; 3. 1

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Njeh dhe prezanton veten e tij /saj.
-Tregon ndryshimet e tij/saj gjatë viteve.
- Bisedon për dallimet mes shokëve nga klasa e parë deri në të tretën.

**Kriteret e suksesit:**
- Trego së paku dy ndryshime që ke pësuar gjatë këtyre tri viteve.
- Trego disa përgjegjësi që ke në kryerjen e detyrave.
- Trego së paku dy rregulla të përditshme për një shëndet të mirë.

**Fjalët kyçe:** përgjegjësi, rregull, shëndet

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, etiketa me fjalë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**:

Gjuha dhe komunikimi, Arti, Matematika, Edukata fizike, Sporti dhe shëndeti.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Bisedojmë dhe luajmë | Të nxënit në bashkëpunim | Shkrimi i lirë dhe Gjej kush është |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Mësuesi/ ja së bashku me nxënësit formojnë një rreth në mes të klasës. Kërkon nga nxënësit të tregojnë që janë në klasën e tretë dhe t'i përmendin dy ndryshime që ata kanë pësuar gjatë këtyre viteve.

**Hapi 2** - Mësuesi/ ja ka përgatitur për të gjithë nxënësit etiketa me fjalë të ndryshme, si: **pesha, komunikacioni, lodrat, lojërat, gjatësia, dëshirat, leximi, shkrimi** dhe i vendos në një kuti. Nxënësit do të tërheqin nga një etiketë dhe do ta tregojnë ndryshimin që e kanë pasur gjatë këtyre viteve sipas fjalës që është e shkruar në etiketën që e kanë tërhequr.

**PJESA KRYESORE**

**Hapi 3** – Hapet libri. Kërkoni nga nxënësit t'i vështrojnë figurat e librit dhe mënyrën se si u prezantuan Mati dhe Ana.
**Hapi 4** – Kërkoni nga nxënësit të prezentohen ashtu sikur Ana e Mati. Ftoni nga dy nxënës t'i tregojnë ndryshimet para të tjerëve.
**Hapi 5** - Punohet me nxënësit rubrika e pyetjeve.
**Hapi 6-** Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**
**Hapi 7** – Kërkoni nga nxënësit në fisha letre të shkruajnë premtime për mësimet dhe sjelljen e tyre në klasën e tretë. Mblidhni fishat e letrës me premtime në kuti dhe ftoni nxënës ta nxjerrin nga një dhe ta lexojnë. Kërkoni nga ata të gjejnë se premtimi i kujt ishte. Nëse nuk e gjen i kujt ishte, atëherë lajmërohet nxënësi që e ka shkruar atë premtim. Vazhdoni kështu me tërë klasën.

**VLERËSIMI**
- Tregon ndryshimet sipas karakteristikave të ndryshme.
- Bashkëpunon me të tjerët.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Mirëserdhe në klasën e tretë.

| |
|---|
| **Kapitulli:** Në arkivin e familjes<br>**Tema mësimore:** Unë dhe familja ime |

**Situata e të nxënit**: Familja është grupi më i vogël shoqëror në të cilin jetojmë.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1,3, II.1, 6 III.1, 5, 7, IV. 5, V.8, VI.1, 7

**RNF**: 1.1, 2 ; 3. 1

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan familjen si grupin më të vogël shoqëror.
- Përmend karakteristikat e anëtarëve të familjes.
- Vlerëson rëndësinë e familjes për jetën e fëmijës.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku një rast kur të ka mbështetur familja.
- Trego një arsye pse është e rëndësishme të diskutosh me familjen.

**Fjalët kyçe**: familje, mbështetje, dashuri, siqeritet, ngrohtësi. **Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Termat paraprakë | Bashkëbisedim | Pesëvargësh |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Me fjalët: familje, mbështetje, diskutim, zgjidhje e problemit dhe fjalë të tjera që do të shtojnë, kërkoni nga nxënësit të shkruajnë një ngjarje për pesë minuta.

**Hapi 2** – Disa nga nxënësit le t'i lexojnë ngjarjet e tyre.

**PJESA KRYESORE**

Hapet libri
**Hapi 3** – Lexoni dhe diskutoni për situatën e dhënë në libër.
**Hapi 4** – Kërkoni nga nxënësit ta përshkruajnë dhe ta komentojnë ilustrimin e dhënë.
**Hapi 5** – Punohet me nxënësit rubrika e pyetjeve.
**Hapi 6 -** Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 7** – kërkoni nga nxënësit ta krijojnë një pesëvargësh për familjen.

Familja

_______________ _______________ (2 mbiemra, që tregojnë si është familja).

_______________ ______________ ____________ (3 folje, që tregojnë çfarë bën familja).

______________________________________________ (1 fjali për familjen).

_____________ (një emër tjetër për familjen, sinonim).

**VLERËSIMI**

- Komenton dhe diskuton për situatat e dhëna në fotografi.
- Përshkruan situata nga mbështetja e familjes.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Unë dhe familja ime.

| **Kapitulli**: Në arkivin e familjes<br>**Tema mësimore:** Paraardhësit dhe pasardhësit e familjes sime |
|---|

**Situata e të nxënit**: Prezantimi i paraardhësve dhe i pasardhësve të familjes.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë **Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1,3, II.1, 6 III.1, 5, 7, IV. 5, V.8, VI.1, 7

**RNF**: 1.1, 2 ; 3. 1

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Dallon familjen e tij të gjerë.
- Emërton paraardhësit e familjes së tij/saj.
- Emërton pasardhësit e prindërve të tij/saj.
-

**Kriteret e suksesit:**

- Përmend së paku njërin nga stërgjyshërit e tij/saj.

**Fjalët kyçe:** Unë, familje, prind, gjyshër, stërgjyshër, paraardhës, pasardhës.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, fotografi të familjes së gjerë

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**:
Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Bashkëbisedim | DRTA | Truri i galerisë |

**PJESA HYRËSE**

Hapi 1 – Kërkoni nga nxënësit t'i prezantojnë fotografitë e familjes që kanë sjellë. Mundësisht të sjellin edhe foto ku janë edhe stërgjyshërit. Kërkojuni të ulen në rreth dhe t'ia tregojnë njëri- tjetrit anëtarët e familjes së gjerë : prindërit, motrat, vëllezërit, gjyshen, gjyshin dhe stërgjyshërit e tyre.
Hapi 2 – Kërkoni nga nxënësit të tregojnë se cilët janë paraardhësit dhe pasardhësit e tyre.

**PJESA KRYESORE**

Hapet libri
Hapi 3 - Kërkoni nga nxënësit ta lexojnë situatën 1. Bisedoni me ta.
- A keni stërgjyshër?
- Ku shkuan Ana me prindërit?
- Sa gjenerata morën pjesë në ditëlindje?
- Sa gjenerata jeni ju në familje?

Hapi 4: Kërkoni nga nxënësit ta lexojnë situatën 2. Bisedoni me ta.

- Cilët janë paraardhësit e tu?
- Paraardhës i kujt je ti?
- Cilët janë pasardhësit e prindërve tuaj?

Hapi 5– Punohet rubrika e pyetjeve.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

Hapi 5 – Nxënësit në një fletë, do t'i shkruajnë 4 fjali për: gjyshin, gjyshen, stërgjyshin dhe strëgjyshen dhe të vizatojnë diçka për secilin. Punimet do t'i ekspozojnë në mur dhe do t'i prezantojnë para klasës.

**VLERËSIMI**

- Emërton paraardhësit dhe pasardhësit.
- Shkruan dhe vizaton diçka për gjyshërit dhe stërgjyshërit e tij.

Detyrë shtëpie: Fletore pune: Paraardhësit dhe pasardhësit e familjes sime.

**Kapitulli:** Në arkivin e familjes
**Tema mësimore:** Sendet e vlefshme të familjes sime

**Situata e të nxënit**: Sendet me vlerë të familjes janë shumë të rëndësishme.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1,3, II.1, 6 III.1, 5, 7, IV. 5, V.8, VI.1, 7

**RNF**: 1.1, 2 ; 3. 1

| **Rezultatet e të nxënit të lëndës:** | **Kriteret e suksesit:** |
|---|---|
| Nxënësi/ja:<br><br>- Shpalos kujtime të famijes së tij/saj.<br>- Tregon ngjarje të familjes nga e kaluara.<br>- Evidenton ndryshimet e familjes në mënyrë kronologjike përmes kujtimeve. | - Përmend së paku nga një kujtim të familjes. |

**Fjalët kyçe:** kujtime, vlerë, emocion, familje, origjinë.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, sende të ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Bashkëbisedim | DRTA | Diagrami i Venit |

## PJESA HYRËSE

Hapi 1 – Kërkoni nga nxënësit të sjellin në klasë ndonjë send që tregon kujtime të familjes. (p.sh. një veshje, një libër, një mjet pune, një punim dore).
Hapi 2 – Kërkoni nga nxënësit të tregojnë ngjarje të ndryshme, duke u bazuar në sendet që i kanë sjellë (shembull: kjo është llulla me të cilën gjyshi im ka pirë duhan. Këtë e ruajmë, sepse është një pjesë e gjyshit tim në të).

**PJESA KRYESORE**

Hapet libri

Hapi 3 - Kërkoni nga nxënësit ta lexojnë situatën 1. Bisedoni me ta.
- Çfarë ndodhi në familjen e Anës?
-A ndodh edhe në familjen tuaj të tregoni kujtime nga e kaluara?
-Çfarë kishte në Kutinë e Kujtimeve?

Hapi 4– Punohet rubrika e pyetjeve.
Hapi 5- Lexohet informacioni dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**
Hapi 6 – Kërkoni nga nxënësit të krijojnë një Diagram Veni dhe t'i bëjnë krahasimet mes kujtimeve të familjes së Anës dhe të familjes së tij. Diskutohet për punimet e tyre.

**VLERËSIMI**
- Tregon dhe shkruan për kujtimet e familjes.

Detyrë shtëpie: Fletore Pune: Tema: Sendet e vlefshme të familjes.

| **Kapitulli:** Në arkivin e familjes |
|---|
| **Tema mësimore:** Ngjarjet në familje |

**Situata e të nxënit**: Fotografia mundëson ruajtjen e kujtimeve të ndryshme. **Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1,3, II.1, 6 III.1, 5, 7, IV. 5, V.8, VI.1, 7

**RNF**: 1.1, 2 ; 3. 1

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**

Nxënësi/ja:

- Mbledh informacione për ngjarje të rëndësishme të familjes.
- Krahason ngjarjet e tij familjare me ato të shokut.
- Vlerëson rëndësinë e fotografisë për ruajtjen e kujtimeve.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku një ngjarje të familjes.
- Karahaso ngjarjet e familjes tënde me ato të shokut.

**Fjalët kyçe**: album, fotografi, kujtim, kohë.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, albumi i fotografive të familjes.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Termat paraprakë | Bashkëbisedim | Historia jonë |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Kërkohet nga nxënësit ta sjellin në klasë albumun e fotografive të familjes. Edhe mësuesi/ja mundësisht ta marrë albumin e familjes së tij/saj.

**Hapi 2**- Kërkohet nga nxënësit në dyshe të tregojnë ngjarje familjare, duke u bazuar në fotografi. Disa nxënës i prezentojnë para të tjerëve. Edhe mësuesi/ja e tregon një ngjarje, sepse do të jetë shumë interesante për nxënësit.

**PJESA KRYESORE**

Hapet libri

**Hapi 3** – Lexoni dhe diskutoni për situatën e dhënë në libër.

-Çfarë ndodhi në klasën e Anës?

-Po në klasën tënde, a ndodhi njëjtë? Pse?

-Si u ndjeve kur dëgjove histori të familjes së mësueses/it?

**Hapi 4** – Punohet me nxënësit rubrika e pyetjeve.

**Hapi 5 -** Lexohet informacioni i dhënë.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 6** – Kërkoni nga nxënësit të zgjedhin një fotografi, ta ngjesin atë në fletë A/4 dhe ta përshkruajnë ngjarjen që tregon ajo, pra një histori të familjes. Grumbulloni të gjitha historitë e nxënësve dhe bëni një libër klase të titulluar "Historia jonë".

**VLERËSIMI**

- Komenton dhe diskuton për ngjarjet e dhëna në fotografi.
- Përshkruan ngjarje nga fotografia.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Ngjarjet në familje.

| **Kapitulli:** Në arkivin e familjes<br>**Tema mësimore:** Veprimtaria 1: Albumi i familjes |
|---|

**Situata e të nxënit**: **Pema e familjes**

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1,3, II.1, 6 III.1, 5, 7, IV. 5, V.8, VI.1, 7

**RNF**: 1.1, 2 ; 3. 1

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**

Nxënësi/ja:

- Plotëson pemën e famijles sipas udhëzimeve të dhëna.
- Rendit saktë anëtarët e familjes sipas kërkesës së dhënë.
- Vlerëson rëndësinë e pemës së familjes për njohjen e paraardhësve dhe të pasardhësve.

**Kriteret e suksesit:**

- Plotëso me kujdes pemën e familjes sipas udhëzimeve të dhëna.

**Fjalët kyçe** : pemë e familjes, fotografi, kujtim, kohë.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, fotografitë e dhëna në libër.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Bashkëbisedim | Punë e pavarur | Diskutim-krahasim |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1-** Pyeten nxënësit: çfarë është pema e familjes?

Kërkoni nga nxënësit në dyshe të bisedojnë, e më pas diskutoni me tërë klasën.

**Hapi 1 – PJESA KRYESORE**

Hapet libri.

**Hapi 2** – Lexohet me kujdes situata e dhënë dhe kërkohet nga nxënësit t'i shkruajnë aty ku duhet emrat e anëtarëve të familje së Matit në pemën e krijuar në libër.

**Hapi 3**– Kërkohet nga nxënësit në mënyrë individuale, nën përcjellljen e mësueses/it, t'i vendosin fotografitë aty ku duhet.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 4** – Nxënësit karahasojnë punimet, duke parë fotografitë e vendosura në vendet e duhura. Disa nga nxënësit lexojnë emrat e anëtarëve të famijes së Matit dhe të tjerët bëjnë korrigjimet e nevojshme.

**VLERËSIMI**

- Komenton dhe diskuton për pemën e familjes.
- Vendos fotografitë në pemën e familjes sipas situatës së dhënë.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Veprimtaria 1 - Albumi i familjes.

| **Kapitulli:** Unë klasa dhe shkolla ime<br><br>**Tema mësimore:** Jetojmë së bashku |
|---|

**Situata e të nxënit**: Anëtarët e grupit duhet të kenë marrëdhënie të mira midis tyre.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1, 3; II. 7; III. 2,8; IV. 3, 5; V. 1 , 8; VI. 2, 5

**RNF:** 1.1; 4.1; 5.2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan shoqet/shokët e klasës, ata që ka patur dhe ata që kanë ardhur të rinj.
- Përmend karakteristikat individuale që ka gjithësecili.
- Vlerëson rëndësinë që ka ndihma dhe mirëkuptimi brenda grupit.

**Kriteret e suksesit:**

- Përshkruaj së paku një shoqe/shok të klasës, duke evidentuar karakteristikat individuale të tij.
- Trego një arsye, pse është i rëndësishëm mirëkuptimi brenda grupit.

**Fjalët kyçe**: individ, marrëdhënie, solidaritet, tolerancë, zgjidhje

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arte.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Termat paraprakë | Bashkëbisedim | Shkrim i lirë |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Me fjalët: shoqe/shok, cilësi individuale, solidaritet, mirëkuptim dhe fjalë të tjera që do të shtojnë, kërkoni nga nxënësit ta përshkruajnë shoqen/shokun për pesë minuta.

**Hapi 2** – Disa nga nxënësit le t'i lexojnë përshkrimet e tyre.

**PJESA KRYESORE**

Hapet libri.

**Hapi 3** – Kërkoni nga nxënësit ta përshkruajnë dhe ta komentojnë ilustrimin e dhënë.

**Hapi 4** – Lexoni dhe diskutoni për situatën e dhënë në libër.

**Hapi 5** – Punohen pyetjet që janë në librin bazë.

**Hapi 6 -** Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 7** – kërkoni nga nxënësit të shkruajnë një shkrim të lirë me temën: "Respektojmë njëri-tjetrin dhe mirëkuptohemi".

**VLERËSIMI**

- Komenton dhe diskuton për situatat e dhëna në ilustrim.
- Përshkruan solidaritetin dhe mirëkuptimin që tregohet ndaj shoqeve/shokëve.
- Shpreh lirshëm mendimin e saj/e tij.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Jetojmë së bashku.

| |
|---|
| **Kapitulli:** Unë klasa dhe shkolla ime<br><br>**Tema mësimore:** Grupet shoqërore |

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan se si është i ndërtuar grupi shoqëror.
- Përmend karakteristikat e anëtarëve të një grupi shoqëror.
- Vlerëson rëndësinë që ka respektimi i të drejtave dhe marrja e përgjegjësive brenda grupit shoqëror.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku si është i ndërtuar një grup shoqëror, duke treguar karakteristikat e tij.
- Trego për të drejtat dhe përgjegjësitë që ti ke brenda një grupi shoqëror.

**RNSH:** I.1, 3; II. 7; III. 2,8; IV. 3, 5; V. 1 , 8; VI. 2, 5

**RNF:** 1.1; 4.1; 5.2

**Fjalët kyçe**: individ, grup, anëtar, mirëkuptim, grup shoqëror.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arte.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Stuhi mendimesh | Tryeza rrethore | Pesëvargëshi |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Me fjalët *grupet shoqërore* realizohet një stuhi mendimesh. Nxënësit japin mendimet e tyre se çfarë dinë për grupet shoqërore.

**Hapi 2** – Të gjitha mendimet e nxënësve shkruhen në dërrasën e zezë.

**PJESA KRYESORE**

Hapet libri.

**Hapi 3** – Kërkoni nga nxënësit ta përshkruajnë dhe ta komentojnë ilustrimin e dhënë.

**Hapi 4** – Lexoni dhe diskutoni për situatën e dhënë në libër.

**Hapi 5** – Punohen pyetjet që janë në librin bazë.

**Hapi 6 -** Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 7** – kërkoni nga nxënësit të krijojnë një pesëvargësh për grupet shoqërore.

Grupet shoqërore

____________ ___________ (2 mbiemra, që tregojnë si janë grupet shoqërore).

____________ ___________ __________ (3 folje, që tregojnë çfarë bëjnë grupet shoqërore).

_____________________________________________ (1 fjali për grupet shoqërore).

_____________ (një emër tjetër për grupet shoqërore, sinonim).

**VLERËSIMI**

- Komenton dhe diskuton për situatat e dhëna në ilustrim.
- Përshkruan grupet shoqërore dhe shfaq cilësitë e veta në grup.
- Analizon dhe zbaton rregullat që ka secili grup.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Grupet shoqërore.

| **Kapitulli:** Unë, klasa dhe shkolla ime |
|---|
| **Tema mësimore:** Unë dhe familja |

**Situata e të nxënit**: Anëtarët e një familjeje formojnë grupin familjar.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë **Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1, 3; II. 7; III. 2,8; IV. 3, 5; V. 1 , 8; VI. 2, 5

**RNF:** 1.1; 4.1; 5.2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan familjen si grupin më të vogël shoqëror ku bën pjesë secili.
- Përmend përgjegjësitë që ka secili prej anëtarëve brenda familjes.
- Vlerëson rëndësinë që ka mirëkuptimi në familje.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku një përgjegjësi që ti ke brenda familjes.
- Trego një arsye pse është e rëndësishme që të mirëkuptohen anëtarët brenda familjes.

**Fjalët kyçe**: grup familjar, ndihmë, mirëkuptim, anëtar i familjes. **Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arte.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Termat paraprakë | Bashkëbisedim | Pesëvargëshi |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Me fjalët: familje, grup shoqëror, rol, përgjegjësi, mirëkuptim dhe fjalë të tjera që do të shtojnë, kërkoni nga nxënësit të shkruajnë një ngjarje për pesë minuta.

**Hapi 2** – Disa nga nxënësit le t'i lexojnë ngjarjet e tyre.

**PJESA KRYESORE**

Hapet libri.

**Hapi 3** – Lexoni dhe diskutoni për situatën e dhënë në libër.

**Hapi 4** – Kërkoni nga nxënësit ta përshkruajnë dhe ta komentojnë ilustrimin e dhënë.

**Hapi 5** – Punohen pyetjet që janë në librin bazë.

**Hapi 6 -** Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 7** – kërkoni nga nxënësit të krijojnë një pesëvargësh për familjen.

Familja

__________ ________ (2 mbiemra, që tregojnë familjen si grup shoqëror).

__________ __________ ________ (3 folje, që tregojnë çfarë bën ky grup shoqëror).

______________________________________________ (1 fjali për familjen).

____________ (një emër tjetër për familjen, sinonim).

**VLERËSIMI**

- Komenton dhe diskuton për situatat e dhëna në ilustrim.
- Përshkruan familjen si grup shoqëror të rëndësishëm.
- Bashkëpunon me pjesëtarët e tjerë të familjes.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Unë dhe familja.

| |
|---|
| **Kapitulli:** Unë, klasa dhe shkolla ime<br><br>**Tema mësimore:** Unë dhe shkolla |

**Situata e të nxënit**: Shkolla është një familje e madhe.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1, 3; II. 7; III. 2,8; IV. 3, 5; V. 1 , 8; VI. 2, 5

**RNF:** 1.1; 4.1; 5.2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan shkollën si një familje të madhe.
- Përmend rregullat që duhen respektuar mes anëtarëve të ndryshëm.
- Vlerëson rëndësinë që ka respektimi i mendimit të secilit anëtar.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku një grup në të cilin ti bën pjesë.
- Trego një arsye pse është e rëndësishme që të respektohet mendimi i secilit prej nxënësve të klasës.

**Fjalët kyçe**: grup shoqëror, anëtar, drejtues grupi, marrdhënie, rregull. **Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme.

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arte.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Tryeza rrethore | Mbajtja e strukturuar e shënimeve | Diskutim i lirë |

## PJESA HYRËSE

**Hapi 1** – Lexohet situata e dhënë në tekst.
**Hapi 2** – Kërkohet nga nxënësit ta vazhdojnë situatën. Ata diskutojnë, duke dhënë mendimin e tyre në tryezën rrethore.

## PJESA KRYESORE

Hapet libri.
**Hapi 3** – Kërkoni nga nxënësit ta përshkruajnë dhe ta komentojnë ilustrimin e dhënë.

**Hapi 4** – Kërkohet prej nxënësve që të ndahen në grupe sipas pjesëmarrjes së tyre në grupet në të cilat ata bëjnë pjesë.

**Hapi 5** – Secili prej grupeve mban shënime mbi detyrat dhe përgjegjësitë që ka secili prej anëtarëve të grupeve.

**Hapi 6 -** Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

## PJESA PËRFUNDIMTARE

**Hapi 7** – Bëhet një diskutim i lirë, ku nxënësit shprehin mendimet e tyre se përse rregullat duhet të zbatohen nga të gjithë nxënësit njësoj.

## VLERËSIMI

- Komenton dhe diskuton për situatat e dhëna në ilustrim.
- Përshkruan situata ku tregohet pjesëmarrja e tij në grupe të ndryshme.
- Vlerëson rolin që ka si anëtar i një grupi të caktuar.
- Shpreh lirshëm mendimin e saj/tij në shkollë.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Unë dhe shkolla.

| **Kapitulli:** Unë, klasa dhe shkolla ime<br>**Tema mësimore:** Unë dhe komuniteti |
|---|

**Situata e të nxënit**: Foto të ndryshme nga jeta në komunitet.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1, 3; II. 7; III. 2,8; IV. 3, 5; V. 1 , 8; VI. 2, 5

**RNF:** 1.1; 4.1; 5.2

| **Rezultatet e të nxënit të lëndës:** | **Kriteret e suksesit:** |
|---|---|
| Nxënësi/ja:<br><br>- Përshkruan komunitetin si grupin e madh shoqëror.<br>- Përmend detyrimet që ne kemi në komunitet.<br>- Vlerëson rëndësinë që ka marrja e përgjegjësive edhe nga ana e fëmijëve në komunitetin ku jetojnë. | - Trego së paku një detyrim që ti ke në komunitet.<br>- Trego një arsye pse është e rëndësishme pjesëmarrja e secilit në komunitet. |

**Fjalët kyçe**: Grup shoqëror, kontribut, komunitet, ndihmë.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arte.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Tryeza rrethore | Pyetja sjell pyetjen | Shkrim i lirë |

## PJESA HYRËSE

**Hapi 1** – Lexohet situata e dhënë në tekst.

**Hapi 2** – Kërkohet nga nxënësit ta vazhdojnë situatën. Ata diskutojnë, duke dhënë mendimin e tyre në tryezën rrethore.

## PJESA KRYESORE

Hapet libri.

**Hapi 3** – Kërkoni nga nxënësit ta përshkruajnë dhe ta komentojnë ilustrimin e dhënë.

**Hapi 4** – Lexoni dhe diskutoni për situatën e dhënë në libër.

**Hapi 5** – Punohet me nxënësit, duke bërë pyetje dhe duke kërkuar përgjigje nga shumë nxënës. Punohen pyetjet e tekstit, duke patur një vazhdimësi logjike në pyetjen pasuese.

**Hapi 6 -** Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

## PJESA PËRFUNDIMTARE

**Hapi 7** – Kërkoni nga nxënësit të krijojnë një shkrim të lirë për kontributin e tyre në komunitet.

## VLERËSIMI

- Komenton dhe diskuton për situatat e dhëna në ilustrim.
- Përshkruan situata nga puna në komunitet.
- Shpreh lirshëm mendimin e saj/tij mbi kontributin në komunitet.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Unë dhe komuniteti.

| **Kapitulli:** Unë, klasa dhe shkolla ime<br>**Tema mësimore:** Respektojmë njëri-tjetrin |
|---|

**Situata e të nxënit**: Rregullat hartohen së bashku për të mirën e të gjithëve.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1, 3; II. 7; III. 2,8; IV. 3, 5; V. 1 , 8; VI. 2, 5

**RNF:** 1.1; 4.1; 5.2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan rregullat që duhet të respektohen në shoqëri.
- Përmend karakteristikat që duhet të ketë brenda grupit me qëllim që të kemi mirëkuptim.
- Vlerëson rëndësinë që ka hartimi i rregullave së bashku.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku një rregull që ju e keni vendosur së bashku.
- Trego një arsye pse është e rëndësishme që të respektohen rregullat që vendosen së bashku.

**Fjalët kyçe**: pjesëmarrje, respektim i rregullave, bashkëpunim, zbatim

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme.

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arte.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Termat paraprakë | Bashkëbisedim | Lojë me role |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Me fjalët: rregull, respektim, diskutim, mirëkuptim dhe fjalë të tjera që do të shtojnë, kërkoni nga nxënësit të shkruajnë një ngjarje për pesë minuta.

**Hapi 2** – Disa nga nxënësit le t'i lexojnë ngjarjet e tyre.

**PJESA KRYESORE**

Hapet libri.

**Hapi 3** – Kërkoni nga nxënësit ta përshkruajnë dhe ta komentojnë ilustrimin e dhënë.

**Hapi 4** – Punohen pyetjet që janë në librin bazë.

**Hapi 5 -** Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 6** – Nxënësit interpretojnë dy situata nëpërmjet lojës me role. Një rast kur nxënësit kanë zbatuar rregullat dhe një rast kur ata nuk i respektojnë rregullat.

**VLERËSIMI**

- Komenton dhe diskuton për situatat e dhëna në ilustrim.
- Përshkruan situata të respektimit dhe të mosrespektimit të rregullave.
- Vlerëson rëndësinë që ka respektimi i rregullave mes tyre.
- Shpreh lirshëm mendimin e saj/tij.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Respektojmë njëri-tjetrin.

**Kapitulli:** Unë, klasa dhe shkolla ime

**Tema mësimore:** Planifikojmë dhe veprojmë

**Situata e të nxënit**: Zbatimi i rregullave gjatë garës dhe përshtatja me synimet e grupit.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1, 3; II. 7; III. 2,8; IV. 3, 5; V. 1 , 8; VI. 2, 5

**RNF:** 1.1; 4.1; 5.2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan organizimin e një gare sportive.
- Përmend rregullat që ka planifikimi i garave.
- Vlerëson rëndësinë që ka organizimi i garave të tilla.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku një rast kur ke marrë pjesë në një garë.
- Trego një arsye pse është e rëndësishme të zhvillohen gara të tilla.

**Fjalët kyçe**: planifikim, garë, përgatitje, vrapim, aktivitet sportiv, organizator.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme.

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arte, Shkathtësi për jetën.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Termat paraprakë | Bashkëbisedim | Pesëvargëshi |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Me fjalët: grup, organizim, diskutim, rregulla gare dhe fjalë të tjera që do të shtojnë, kërkoni nga nxënësit të shkruajnë një garë vrapimi.

**Hapi 2** – Disa nga nxënësit le të lexojnë se si e kanë shkruar garën e tyre.

**PJESA KRYESORE**

Hapet libri.

**Hapi 3** – Lexoni dhe diskutoni për situatën e dhënë në libër.

**Hapi 4** – Kërkoni nga nxënësit ta përshkruajnë dhe ta komentojnë ilustrimin e dhënë.

**Hapi 5** – Punohen pyetjet që janë në librin bazë.

**Hapi 6 -** Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 7** – kërkoni nga nxënësit të krijojnë një pesëvargësh për fjalën *planifikim.*

Planifikim

____________ ____________ (2 mbiemra, që tregojnë si është planifikimi).

__________ __________ ________ (3 folje, që tregojnë se për çfarë ndihmon planifikimi).

__________________________________________ (1 fjali për planifikimin).

____________ (një emër tjetër për planifikim, sinonim).

**VLERËSIMI**

- Komenton dhe diskuton për situatat e dhëna në ilustrim.
- Përshkruan situata nga pjesëmarrja e tij në gara.
- Bashkëpunon me të tjerët për të mirën e shoqërisë.
- Shpreh lirshëm mendimin e saj/tij.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Planifikojmë dhe veprojmë.

| |
|---|
| **Kapitulli:** Unë, klasa dhe shkolla ime<br><br>**Tema mësimore:** Pjesëmarrja ime |

**Situata e të nxënit**: Shkolla krijon mundësi për pjesëmarrje në veprimtari të ndryshme.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1, 3; II. 7; III. 2,8; IV. 3, 5; V. 1 , 8; VI. 2, 5

**RNF:** 1.1; 4.1; 5.2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan pjesëmarrjen në veprimtari të ndryshme.
- Përmend rëndësinë që ka pranimi i tjetrit me mundësitë dhe aftësitë që ka.
- Vlerëson rëndësinë që ka shkolla në krijimin e mundësive për pjesëmarrje.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku një rast kur ke marrë pjesë në ndonjë veprimtari.
- Trego një arsye pse është i rëndësishëm roli i shkollës në krijimin e mundësive për pjesëmarrje.

**Fjalët kyçe**: interpretim, pjesë teatrore, rol, pjesëmarrje, kontribut, bashkëpunim.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme, veshje për pjesën teatrore.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**:
Gjuha dhe komunikimi, Arte, Shkathtësi për jetën.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Terma paraprakë | Lojë me role | Pesëvargëshi |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Me fjalët: pjesë teatrore, tregim, skenë, veshje, interpretim dhe fjalë të tjera që do të shtojnë, kërkoni nga nxënësit të shkruajnë një ngjarje për pesë minuta.

**Hapi 2** – Disa nga nxënësit le t'i lexojnë ngjarjet e tyre.

**PJESA KRYESORE**

Hapet libri.

**Hapi 3** – Lexoni dhe diskutoni për situatën e dhënë në libër.

**Hapi 4** – Kërkoni nga nxënësit ta përshkruajnë dhe ta komentojnë ilustrimin e dhënë.

**Hapi 5** – Punohen pyetjet që janë në librin bazë.

**Hapi 6 -** Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**Hapi 7** – Ndahen rolet dhe shikohen mundësitë për interpretim.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 8** – kërkoni nga nxënësit të krijojnë një pesëvargësh për familjen.

Pjesëmarrje

____________ ____________ (2 mbiemra, që tregojnë si është pjesëmarrja).

____________ ____________ __________ (3 folje, që tregojnë çfarë bëhet nga pjesëmarrja).

________________________________________ (1 fjali për pjesëmarrjen)

____________ (një emër tjetër për pjesëmarrjen, sinonim).

**VLERËSIMI**

- Komenton dhe diskuton për situatat e dhëna në ilustrim.
- Përshkruan situata nga pjesëmarrja në klasë.
- Vlerëson rëndësinë që ka pjesëmarrja në jetën e vendit.
- Shpreh lirshëm mendimin e saj/tij.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Pjesëmarrja ime.

| **Kapitulli:** Unë ,klasa dhe shkolla ime |
| --- |
| **Veprimtaria 2:** Gjelbërojmë mjedisin në shkollë dhe në komunitet |

**Situata e të nxënit**: Mjedisi i gjelbëruar ndihmon për një jetë më të mirë.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1, 3; II. 7; III. 2,8; IV. 3, 5; V. 1 , 8; VI. 2, 5

**RNF:** 1.1; 4.1; 5.2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan mjedisin në shkollë.
- Përshkruan mjedisin në komunitetin ku jeton.
- Vlerëson rëndësinë që ka gjelbërimi i mjedisit.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku një rast kur ke marrë pjesë në gjelbërimin e mjedisit në shkollë apo në komunitet.
- Trego një arsye pse është i rëndësishëm gjelbërimi i mjedisit.

**Fjalët kyçe**: gjelbërim, mjedis, shkollë, komunitet, aksion.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme, mjete pune.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Shkathtësi për jetën.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
| --- | --- | --- |
| Bashkëbisedim | Veprimtari praktike | Vizatim i lirë |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Bëhet një bashkëbisedim me nxënësit për gjelbërimin e mjedisit në shkollë apo në komunitet.

**PJESA KRYESORE**

Hapet libri.

**Hapi 2** – Shikohen hapësirat në mjedisin e shkollës/komunitetit.

**Hapi 3** – Kërkohet plani i gjelbërimit të mjedisit.

**Hapi 4** – Caktohen grupet e punës dhe veprimtaria për secilin grup.

**Hapi 5 –** Shikohet realizimi i detyrave për secilin grup nëpërmjet ballafaqimit të tyre.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 6** – Kërkoni nga nxënësit që ta vizatojnë ose ta fotografojnë mjedisin e gjelbëruar që krijuan.

**VLERËSIMI**

- Komenton dhe diskuton për gjendjen në të cilën ndodhen mjediset.
- Përshkruan mjedisin e ri të krijuar nga ndërhyrja e nxënësve të klasës.
- Vlerëson rëndësinë që ka gjelbërimi i mjedisit.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema:  Gjelbërojmë mjedisin në shkollë dhe në komunitet.

| |
|---|
| **Kapitulli:** Unë kam të drejta në shkollë dhe në shoqëri<br>**Tema mësimore:** Të drejtat dhe përgjegjësitë |

**Situata e të nxënit**: Çdo e drejtë ka përgjegjësinë që i korrespondon.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I. 7; II. 1; III. 1; IV. 5; VI. 1, 2

**RNF**: 1.1,2,3

| **Rezultatet e të nxënit të lëndës:** | **Kriteret e suksesit:** |
|---|---|
| Nxënësi/ja:<br><br>- Përshkruan rëndësinë që ka njohja dhe respektimi i të drejtave.<br>- Përmend rëndësinë që kanë institucionet në respektimin e të drejtave të njeriut.<br>- Vlerëson rëndësinë e të drejtave dhe përgjegjësive. | - Trego së paku një rast kur ke parë ose ke lexuar një situatë që ka të bëjë me respektimin e të drejtave.<br>- Trego një arsye pse është e rëndësishme njohja dhe respektimi i të drejtave dhe marrja e përgjegjësive. |

**Fjalët kyçe**: shkollë, të drejta, investim, pjesëmarrje, braktisje

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**:
Gjuha dhe komunikimi, Artet.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**PJESA HYRËSE**
Pjesa kryesore Pjesa përfundimtare

Stuhi mendimesh Bashkëbisedim Gushëkuqi rrethor
**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Vendosim në mes fjalën: *shkolla*. Rreth saj kërkojë nga nxënësit se çfarë të drejtash ju siguron nxënësve shkolla. Kërkoni nga nxënësit që të gjithë të japin mendimet e tyre rreth respektimit të të drejtave në shkollë.

**PJESA KRYESORE**

Hapet libri
**Hapi 2** – Lexoni dhe diskutoni për situatën e dhënë në libër.
**Hapi 3** – Kërkoni nga nxënësit të përshkruajnë dhe të komentojnë ilustrimin e dhënë.
**Hapi 4** – Punohen pyetjet që janë në librin bazë.
**Hapi 5 -** Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 7** – Shpërndani në grup nga një fletë dhe kërkoni nga nxënësit me radhë të shkruajnë nga një fjali për të drejtat e tyre në shkollë . Nxënësi që shkruan e palos fletën që të mos shihet mendimi i tij. Shkruan nxënësi tjetër dhe ai e palos fletën. Vazhdohet kështu deri sa të shkruajnë të gjithë. Fleta paloset në formë të fizarmonikës. Grupet prezentojnë punën.

**VLERËSIMI**

Komenton dhe diskuton për situatat e dhëna në ilustrim.
Përshkruan situata nga mbështetja që i jep shkolla.
Shpreh lirshëm mendimin e saj/e tij.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune – Tema: Të drejtat e mia në shkollë

| **Kapitulli:** Unë kam të drejta në shkollë dhe në shoqëri<br>**Tema mësimore:** Unë kam të drejta në familje |
|---|

**Situata e të nxënit**: Njohja e fëmijëve me të drejtat e tyre fillon në familje.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I. 7; II. 1; III. 1; IV. 5; VI. 1, 2

**RNF**: 1.1,2,3

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan familjen si grupin më të vogël shoqëror ku fillon njohja e të drejtave të fëmijëve.
- Përmend raste të respektimit dhe të mosrespektimit të të drejtave të fëmijëve.
- Vlerëson rëndësinë që ka familja në respektimin e të drejtave të fëmijëve.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku një rast kur të ka mbështetur familja në respektimin e të drejtave të tua.
- Trego një arsye pse është e rëndësishme njohja e të drejtave të fëmijëve nga ana e familjes.

**Fjalët kyçe**: përgjegjësi, të drejta, dhunë psikologjike, presion, frikë, keqtrajtim.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Artet.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Imagjinata e drejtuar | Pyetja sjell pyetjen | Diskutim i lirë |

## PJESA HYRËSE

**Hapi 1** – Si mund të veprojë Korabi në situatën kur babai kërkon ndihmën e tij? Po ti, si do të veproje në një situatë të tillë?

**Hapi 2** – Nxënësit shprehin mendimet e tyre rreth situatës për pesë minuta.

## PJESA KRYESORE

Hapet libri.

**Hapi 3** – Lexoni dhe diskutoni për situatën e dytë të dhënë në libër.
**Hapi 4** – Bëhen pyetjet që jepen në tekst. Kërkoni nga nxënësit të përshkruajnë dhe të japin mendimin e tyre se çfarë zgjidhje do t'i jepnin situatës së dhënë.

**Hapi 5** – Punohet me nxënësit, duke kaluar nga pyetja në pyetje, sipas situatës që ata do të paraqesin.

**Hapi 6 -** Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

## PJESA PËRFUNDIMTARE

**Hapi 7** – Kërkoni nga nxënësit të diskutojnë rreth rasteve që janë ndier të dhunuar në familje.

## VLERËSIMI

- Komenton dhe diskuton për situatat e dhëna në ilustrim.
- Përshkruan situata të respektimit të të drejtave, apo raste kur janë ndier të dhunuar psikologjikisht.
- Shpreh lirshëm mendimin e saj/tij.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Unë kam të drejta në familje.

**Kapitulli:** Unë kam të drejta në shkollë dhe në shoqëri

**Tema mësimore:** Të drejtat e mia në shkollë

**Situata e të nxënit**: Shkolla respekton të drejtat e nxënësve për një të ardhme më të sigurt.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I. 7; II. 1; III. 1; IV. 5; VI. 1, 2

**RNF**: 1.1,2,3

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan shkollën si mjedisi që mbron e respekton të drejtat e nxënësve.
- Përmend rëndësinë që merr mosndikimi i tyre nga ana e mësuesve, në rastet e marrjes së vendimeve.
- Vlerëson rëndësinë që ka roli i shtetit në minimizimin e braktisjes së shkollës nga ana e nxënësve.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku një rast kur të janë respektuar të drejtat e tua në shkollë.
- Trego një arsye pse është i rëndësishëm roli i shkollës në njohjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve.

**Fjalët kyçe**: shkollë, të drejta, investim, pjesëmarrje, braktisje.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Artet.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Stuhi mendimesh | Bashkëbisedim | Gushëkuqi rrethor |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Vendosim në mes fjalën: *shkolla*. Rreth saj kërkohet nga nxënësit të tregojnë se çfarë të drejtash iu siguron nxënësve shkolla. Kërkoni nga nxënësit që të gjithë t'i japin mendimet e tyre rreth respektimit të të drejtave në shkollë.

**PJESA KRYESORE**

Hapet libri.

**Hapi 2** – Lexoni dhe diskutoni për situatën e dhënë në libër.

**Hapi 3** – Kërkoni nga nxënësit ta përshkruajnë dhe ta komentojnë ilustrimin e dhënë.

**Hapi 4** – Punohen pyetjet që janë në librin bazë.

**Hapi 5 -** Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 7** – Shpërndani në grup nga një fletë dhe kërkoni nga nxënësit me radhë të shkruajnë nga një fjali për të drejtat e tyre në shkollë. Nxënësi, që shkruan, e palos fletën që të mos shihet mendimi i tij. Shkruan nxënësi tjetër dhe ai e palos fletën. Vazhdohet kështu deri sa të shkruajnë të gjithë. Fleta paloset në formë të fizarmonikës. Grupet prezentojnë punën.

**VLERËSIMI**

- Komenton dhe diskuton për situatat e dhëna në ilustrim.
- Përshkruan situata nga mbështetja që i jep shkolla.
- Shpreh lirshëm mendimin e saj/tij.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Të drejtat e mia në shkollë.

| |
|---|
| **Kapitulli:** Unë kam të drejta në shkollë dhe në shoqëri<br>**Tema mësimore:** Përgjegjësitë në komunitet |

**Situata e të nxënit**: Fëmijët kanë nevojë për mbështetjen e komunitetit ku jetojnë.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I. 7; II. 1; III. 1; IV. 5; VI. 1, 2

**RNF**: 1.1,2,3

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan ndihmën dhe mbështetjen e komunitetit ndaj fëmijëve.
- Përmend kontributin që duhet të japë secili prej fëmijëve.
- Vlerëson rëndësinë e komunitetit për jetën e fëmijës.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku një rast kur ke kontribuar në komunitet.
- Trego një arsye pse është e rëndësishme mbështetja që duhet të japë komuniteti ndaj teje.

**Fjalët kyçe**: komunitet, përmbytje, bodrum, abuzim seksual, rrëmbim, shfrytëzim.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Artet, Matematikë.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Imagjinatë e drejtuar | Të nxënit në bashkëpunim | Pesëvargëshi |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Kërkohet nga nxënësit që nëpërmjet imagjinatës së tyre të thonë se si do ta kishin organizuar mjedisin në lagjen e tyre. Të tregojnë për përgjegjësitë që ata kanë marrë në komunitetin ku jetojnë, si dhe për mbështetjen që ua jep komuniteti atyre.

**Hapi 2** – Disa nga nxënësit mund ta shprehin me fjalë ose me anë të vizatimit imagjinatën e tyre lidhur me rregullimin e mjedisit në lagjen e tyre.

**PJESA KRYESORE**

Hapet libri
**Hapi 3** – Lexoni dhe diskutoni për situatën e dhënë në libër.

**Hapi 4** – Ju kërkohet nxënësve që të flasin rreth ideve të ndryshme.

**Hapi 4 –** Të shprehen se çfarë mund të bënin nxënësit në një situatë të ngjashme.
**Hapi 5** – Punohen pyetjet që janë në librin bazë.

**Hapi 6 -** Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 7** – kërkoni nga nxënësit të krijojnë një pesëvargësh për komunitetin.

Komunitet

____________ __________ (2 mbiemra, që tregojnë si është komuniteti).

____________ ___________ _________ (3 folje që tregohet çfarë bëhet në komunitet).

________________________________________ (1 fjali për komunitetin).

____________ (një emër tjetër për komunitetin, sinonim).

**VLERËSIMI**

- Komenton dhe diskuton për situatat e dhëna në ilustrim.
- Përshkruan situata nga kontributi i tyre në komunitet.
- Përshkruan situata nga mbështetja që ua ka dhënë komuniteti.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Përgjegjësitë në komunitet.

| |
|---|
| **Kapitulli:** Unë kam të drejta në shkollë dhe në shoqëri<br><br>**Tema mësimore:** Ndal dhunës në familje |

**Situata e të nxënit**: Ndërgjegjësimi i fëmijëve për t'u mbrojtur nga dhuna në familje.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I. 7; II. 1; III. 1; IV. 5; VI. 1, 2

**RNF**: 1.1,2,3

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan format e dhunës në familje.
- Përmend pasojat që vijnë nga përdorimi i dhunës në familje.
- Vlerëson rëndësinë që ka mbrojtja e fëmijëve nga dhuna në familje.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku një rast kur ke patur probleme nga përdorimi i dhunës në familje.
- Trego një arsye pse është i rëndësishëm ndërgjegjësimi i fëmijëve për mbrojtjen e të drejtave të tyre në familje.

**Fjalët kyçe**: dhunë, mirëkuptim, keqtrajtim, ndërgjegjësim, harmoni.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arte, Shkathtësi për jetën.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Stuhi mendimesh | Bashkëbisedim | Pesëvargëshi |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Realizohet me nxënësit Stuhi mendimesh me grupin e fjalëve: *Dhunë në familje*. Të gjitha mendimet e nxënësve shkruhen në dërrasë.

**PJESA KRYESORE**

Hapet libri

**Hapi 2** – Lexoni dhe diskutoni për situatën e dhënë në libër.

**Hapi 3** – Kërkoni nga nxënësit ta përshkruajnë dhe ta komentojnë ilustrimin e dhënë.

**Hapi 4** – Punohen pyetjet që janë në librin bazë.

**Hapi 5 -** Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 6** – kërkoni nga nxënësit të krijojnë një pesëvargësh për dhunën në familje.

Dhunë

_____________ _____________ (2 mbiemra, që tregojnë si është dhuna).

___________ ____________ ___________ (3 folje, që tregojnë çfarë ndodh nga dhuna).

___________________________________________ (1 fjali për dhunën).

____________ (një emër tjetër për dhunën).

**VLERËSIMI**

- Diskuton për situatat e dhëna në ilustrim.
- Përshkruan situata të përdorimit të dhunës dhe mundësive për shmangien e saj.
- Shpreh lirshëm mendimin e saj/tij.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Ndal dhunës në familje.

| **Kapitulli:** Unë kam të drejta në shkollë dhe në shoqëri<br><br>**Tema mësimore:** Jo, dhunës në shkollë |
|---|

**Situata e të nxënit**: Të luftojmë për më pak dhunë dhe më shumë dashuri.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I. 7; II. 1; III. 1; IV. 5; VI. 1, 2

**RNF**: 1.1,2,3

| **Rezultatet e të nxënit të lëndës:**<br>Nxënësi/ja:<br><br>- Përshkruan rëndësinë që ka mbrojtja e fëmijëve nga dhuna.<br>- Përmend disa nga shkaqet e lindjes së dhunës.<br>- Vlerëson rëndësinë që ka shmangia e dhunës në shkollë. | **Kriteret e suksesit:**<br><br>- Trego së paku një rast kur ka patur dhunë në shkollë.<br>- Tregohet se cili ka qenë shkaku i përdorimit të dhunës në një situatë të caktuar.<br>- Trego një arsye, pse është e rëndësishme që të shmanget përdorimi i dhunës. |
|---|---|

**Fjalët kyçe**: dhunë, rregulla, zbatim, afishim, keqkuptim.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Artet, Shkathtësi për jetën.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Stuhi mendimesh | Të nxënët në bashkëpunim | Gushëkuqi rrethor |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Me grupin e fjalëve: *dhuna në shkollë,* realizohet një stuhi mendimesh. Kërkohet që të shkruhen të gjitha mendimet e nxënësve.

**Hapi 2** – Disa nga nxënësit le t'i shprehin mendimet e tyre rreth saj.

**PJESA KRYESORE**

Hapet libri

**Hapi 3** – Lexoni dhe diskutoni për situatën e dhënë në libër.

**Hapi 4** – Kërkoni nga nxënësit ta përshkruajnë veprimin e mësueses në lidhje me Korabin.

**Hapi 5** – Diskutohet me nxënësit shprehja: "Stop dhunës ndaj dëshirave!"

**Hapi 6 -** Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 7** – Shpërndani në grup nga një fletë dhe kërkoni nga nxënësit me radhë të shkruajnë nga një fjali për mbrojtjen nga dhuna në shkollë. Nxënësi, që shkruan, e palos fletën që të mos shihet mendimi i tij. Shkruan nxënësi tjetër dhe ai e palos fletën. Vazhdohet kështu deri sa të shkruajnë të gjithë. Fleta paloset në formë të fizarmonikës. Grupet prezentojnë punën.

**VLERËSIMI**

- Komenton dhe diskuton për situatat e dhëna në ilustrim.
- Përshkruan situata të ndryshme rreth mbrojtjes nga dhuna në shkollë.
- Shpreh lirshëm mendimin e saj/tij.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Jo, dhunës në shkollë.

| **Kapitulli:** Ngjarje dhe aktivitete në vendbanimin tim<br><br>**Tema mësimore:** Shkolla ime |
|---|

**Situata e të nxënit**: Shkolla është vendi ku nxënësit marrin mësime, edukohen dhe shoqërohen ndërmjet vete.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

RNSH: I. 1, 3; II.1, 6; III. 8; IV. 5; VI.3

RNF: 5. 2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:
- Përshkruan shkollën dhe njerëzit që punojnë në të.
- Analizon situatat e dhëna në libër.
- Përshkruan aktivitete që bëhen në shkollën e tij/saj.

**Kriteret e suksesit:**

- Shpreh lirshëm mendimet e tij/ e saj.
- Shkruaj disa fjali për festën e shkollës së tij/saj.

**Fjalët kyçe:** festë, aktivitet, shkollë, nxënës, prindër, të ftuar.

**Burimet:** Libri i nxënësit, fletore pune.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Stuhi mendimesh | Mësimdhënia e ndërsjellë | Shkrimi i lirë |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1**- Kërkoni nga nxënësit të tregojnë se çfarë është shkolla dhe kush punon në shkollë. Mendimet e tyre shkruhen në tabelë dhe diskutohet rreth tyre.

**PJESA KRYESORE**
Hapet libri

**Hapi 2**–Kërkoni nga nxënësit të ndahen në numrat 1 dhe 2. Nxënësi me numrin 1 do ta lexojë situatën 1 dhe do ta pyesë nxënësin 2 rreth situatës së lexuar (pra nxënësi 1 luan rolin e mësuesit).
E njëjta punë bëhet me situatën 2, vetëm se nxënësit ndërrojnë rolet. Pra, nxënësi 2 lexon situatën dhe bën pyetje për nxënësin 1.

**Hapi 3** -Punohet rubrika e pyetjeve për të dy situatat, bashkë me nxënësit.

- Kur është dita e shkollës suaj?
- Po ju, si e organizoni ditën e festës në shkollën tuaj?
- Si e vlerësoni aktivitetin e nxënësve?
- Diskutoni në klasë dhe organizoni edhe ju një aktivitet të tillë në shkollën tuaj.

**Hapi 4** – Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 6** – Kërkoni nga nxënësit të shkruajnë për temën **"Festa e shkollës sime"** dhe ta paraqesin me vizatim atë.
Disa nxënës lexojnë punimin e tyre.

**VLERËSIMI**
- Shprehin lirshëm mendimet.
- Shkruan për festën e shkollës së tij/saj.

Detyrë shtëpie : Fletore pune: Tema: Shkolla ime.

| |
|---|
| **Kapitulli:** Ngjarje dhe aktivitete në vendbanimin tim<br>**Tema mësimore:** Bukuritë e vendit tim |

**Situata e të nxënit**: Kosova është vendi ynë. Në vendin tonë ka shumë male, vargmale, fusha, lumenj e bukuri të tjera natyrore.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

RNSH: I. 1, 3; II.1, 6; III. 8; IV. 5; VI.3

RNF: 5. 2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:
- Përshkruan Kosovën dhe vettië e saj.
- Analizon situatat e dhëna në libër.
- Gjen në hartë qytetin/fshatin e tij/saj.
- Shkruan disa vargje për Kosovën.

**Kriteret e suksesit:**

- Shpreh lirshëm mendimet e tij/saj.
- Shkruaj disa vargje për Kosovën.

**Fjalët kyçe:** Kosovë, male, fusha, lumenj, bukuri, hartë, qytete.

**Burimet:** Libri i nxënësit, fletore pune, harta e Kosovës.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Pyetja sjell pyetjen | Lexim i drejtuar | Shkrimi i lirë/Karrigia e autorit |

**PJESA HYRËSE**
**Hapi 1**- Paraqitet para nxënësve harta e Kosovës. Bisedoni me nxënësit për pyetjet:

- A e dini se çfarë është harta?

- Cili është vendi ynë?
- Kush jeton në të?
- Cilat janë bukuritë e vendit tonë?
- Në cilin qytet/ fshat jetojmë ne?
- Cili është kryeqyteti i Kosovës?
- Cilat janë komunat e Kososvës?

**PJESA KRYESORE**
Hapet libri

**Hapi 2**–Lexoni situatën e dhënë, duke analizuar bashkë me nxënësit atë. Analizoni dhe foton e dhënë në libër.

**Hapi 3** -Punohet rubrika e pyetjeve, bashkë me nxënësit.

-A do të kishe dëshirë që edhe ti të bëje një shëtitje me aeroplan si Ana?

-Gjej në hartën e Kosovës qytetin tënd.

-Përshkruaj se me cilat vende në hartë përkufizohet Kosova.

-Cili është kryeqyteti i Kosovës? Gjej atë në hartë.

**Hapi 4** – Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 6** – Kërkoni nga nxënësit t'i shkruajnë disa vargje për: "**Kosova- vendi im**"
Nxënësit ulen në një karrige dhe lexojnë vargjet e shkruara.

**VLERËSIMI**
- Shprehin lirshëm mendimet.
- Shpreh dashurinë për Kosovën me disa vargje.

Detyrë shtëpie: Fletore pune: Tema: Bukuritë e vendit tim.

| |
|---|
| **Kapitulli:** Ngjarje dhe aktivitete në vendbanimin tim<br><br>**Tema mësimore:** Festojmë së bashku |

**Situata e të nxënit**: Festa kombëtare festohet në të gjitha vendet ku ka shqiptarë. Festën shtetërore të Republikës së Kosovës e festojnë të gjithë kosovarët që jetojnë brenda dhe jashtë Kosovës.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

RNSH: I. 1, 3; II.1, 6; III. 8; IV. 5; VI.3

RNF: 5. 2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:
- Përshkruan se çfarë është festa.
- Krahason festën shtetërore me atë kombëtare.
- Shkruan për emocionet që sjellin festat.
- Vlerëson rëndësinë e organizimit të këtyre fesatve.

**Kriteret e suksesit:**

- Shpreh lirshëm mendimet e tij/saj.
- Paraqit me shkrim dhe vizatim emocione të festave të caktuara.

**Fjalët kyçe:** Festë kombëtare, festë shtetërore, flamuj, Kosovë, Shqipëri.

**Burimet:** Libri i nxënësit, fletore pune, flamuj të Kosovës e të Shqipërisë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës. **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Stuhi mendimesh | Diagram Veni | Ditari dypjesësh |

**PJESA HYRËSE**
**Hapi 1**- Kërkoni nga nxënësit të mendojnë se se çfarë u vjen në mendje kur përmendet fjala "Festë". Mendimet e nxënësve shkruhen në tabelë dhe diskutohet rreth tyre.

**PJESA KRYESORE**
Hapet libri.

**Hapi 2**–Lexohen situatat e dhëna dhe bisedohet për festat e përshkruara.

**Hapi 3** -Punohet rubrika e pyetjeve bashkë me nxënësit.

- Cili është dallimi në mes të festës kombëtare dhe shtetërore?

**Hapi 4**-Vizatohet në tabelë një diagram Veni dhe bashkë me nxënësit krahasohen festat kombëtare dhe shtetërore.

- Përshkruaj emocionet e tua në ditën e këtyre festave.

**Hapi 5**- Kërkohet nga nxënësit të shkruajnë nga një karakteristikë për secilën nga këto festa.

Nxënësit lexojnë punimet dhe diskutohet rreth tyre

**Hapi 6** – Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**
**Hapi 6** – Kërkoni nga nxënësit ta ndajnë fletoren me një vijë në mes, të shkruajnë për emocionet në ato ditë fesatsh, si dhe të paraqesin me vizatim diçka për atë ditë.

| 17 Shkurti - Pavarësia e Kosovës | 28 Nëntori - Pavarësia e Shqipërisë |
|---|---|
| | |

**VLERËSIMI**
- Shprehin lirshëm mendimet.
- Shpreh emocionet për këto ditë festash.

Detyrë shtëpie : Fletore pune: Tema: Festojmë së bashku.

**Kapitulli:** Ngjarje dhe aktivitete në vendbanimin tim

**Tema mësimore:** Mjediset natyrore dhe kulturore të vendit tonë

**Situata e të nxënit**: Vendi ynë është Republika e Kosovës. Kosova ka shumë vende të rëndësishme për të vizituar. Përmes tyre tregohet historia e vendit tonë.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

RNSH: I. 1, 3; II.1, 6; III. 8; IV. 5; VI.3

RNF: 5. 2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan se çfarë janë bukuritë natyrore dhe kulturore të vendit tonë.
- Analizon vendet e paraqitura në libër.
- Vlerëson rëndësinë e vizitës dhe të mirëmbajtjes së këtyre vendeve.

**Kriteret e suksesit:**

- Shpreh lirshëm mendimet e tij/saj.
- Shkruaj për rëndësinë historike dhe mirëmbajtjen e bukurive natyrore dhe kulturore.

**Fjalët kyçe:** kulturë, histori, respekt, mirëmbajtje.

**Burimet:** Libri i nxënësit, fletore pune, videoprojektor.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
| --- | --- | --- |
| Stuhi mendimesh | Lexim i drejtuar | Ditari dypjesësh |

**PJESA HYRËSE**
**Hapi 1**- Kërkoni nga nxënësit të tregojnë se çfarë do të thotë **bukuri natyrore,** e çfarë **vende kulturore.** Bashkë me nxënësit bëhet shpjegimi dhe kërkohet të tregojnë vende që kanë bukuri natyrore dhe kulturore të Kosovës.

**PJESA KRYESORE**
Hapet libri.

**Hapi 2**–Lexohen situatat e dhëna dhe bisedohet për vendet e përshkruara, duke analizuar edhe fotot për secilin vend.

**Hapi 3** -Punohet rubrika e pyetjeve bashkë me nxënësit.
-A i ke vizituar këto vende?

-Merr informacione mbi rëndësinë që kanë këto vende.

-Gjej edhe vende të tjera që tregojnë bukuritë natyrore dhe kulturore të vendit tonë.

**Hapi 4**- Përgatitni në videoprojektor, që të shihen edhe pamje të vendeve të përmendura.

**Hapi 5** – Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 6** – Kërkoni nga nxënësit ta japin mendimin e tyre për fjalinë:

| |
|---|
| Ne duhet ta kujtojmë me respekt historikun e këtyre vendeve dhe të kujdesemi për mirëmbajtjen e tyre. |

Nxënësit lexojnë punimet.

**VLERËSIMI**
- Shprehin lirshëm mendimet.
- Shkruaj për rëndësinë historike dhe mirëmbajtjen e bukurive natyrore dhe kulturore.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Mjediset natyrore dhe kulturore të vendit tonë.

**Kapitulli:** Ngjarje dhe aktivitete në vendbanimin tim

**Tema mësimore:** Ekspozita jonë

**Situata e të nxënit** : Nxënësit janë pjesë e rëndësishme e aktiviteteve që organizohen në shkollë. Hapja e ekspozitave nga ana e tyre bën që ata ta rrisin vetëveprimin.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

RNSH: I. 1, 3; II.1, 6; III. 8; IV. 5; VI.3

RNF: 5. 2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Jep kuptimin e fjalës *Ekspozitë.*
- Analizon ekspozitën në situatën e dhënë.
- Përgatit planin për hapjen e një ekspozite në klasë.

**Kriteret e suksesit:**

- Shpreh lirshëm mendimet e tij/saj.
- Bëj planin për hapjen e ekspozitës në klasë.

**Fjalët kyçe:** ekspozitë, punime, kulturë, vizitorë.

**Burimet:** Libri i nxënësit, fletore pune.

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Stuhi mendimesh | Lexim i drejtuar | Projekt |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1**- Kërkoni nga nxënësit të tregojnë se çfarë do të thotë fjala ***Ekspozitë***.
Mendimet e tyre shkruhen në tabelë.

**PJESA KRYESORE**
Hapet libri

**Hapi 2**–Lexohet situata e dhënë dhe bisedohet për të.
- Çfarë mendon për ekspozitën që bënë Ana dhe Mati me shokët e klasës?
- A të pëlqen titulli i ekspozitës? Pse?

**Hapi 3** -Punohet rubrika e pyetjeve bashkë me nxënësit.

A ke qenë pjesëmarrës në ndonjë ekspozitë?

**-** Si e keni organizuar punën për hapjen e saj?

**-** Çfarë emocioni keni ndier?

**-** Pse ka rëndësi hapja e ekspozitave?

**Hapi 4** – Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 5** – Kërkoni nga nxënësit të ndahen në grupe, ta bëjnë planin për hapjen e një ekspozite në klasë dhe të tregojnë si do ta e titullojnë atë.
Grupet do ta prezentojnë punën dhe do të zgjidhet plani më i mirë i paraqitur. Atë plan të zgjedhur do t'ua jepni nxënësve si detyrë shtëpie shtesë që t'i bëjnë përgatitjet dhe ta hapni ekspozitën në klasë.

**VLERËSIMI**
- Shprehin lirshëm mendimet.
- Bëj planin për hapjen e ekspozitës në klasë.

**Detyrë shtëpie :** Fletore pune: Tema: Ekspozita jonë.

| **Kapitulli:** Të afërmit e mi jetojnë në vende të ndryshme |
|---|
| **Tema mësimore:** Atdheu |

**Situata e të nxënit**: Atdheu është vendi ku kemi lindur ne dhe të parët tanë.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1,7, III.1, 4, VI.6, 7

**RNF**: 1.1, 2 ; 3. 1

**RNSH:** I.1,3,4,5; II.1; III.1,7 ; IV.3; V.1; VI.1

**RNF**: 1.1; 3.1;6.1

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan atdheun e tij/saj.
- Diskuton për bukuritë e atdheut të tij/saj.
- Vlerëson rëndësinë e mbrojtjes së atdheut për një jetë të mirë.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku dy karakeritika të atdheut tonë.
- Shkruaj një fjali për atdheun.

**Fjalët kyçe**: atdhe, dashuri, krenari, komb.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arte , Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës. **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Stuhi mendimesh | Të nxënit në bashkëpunim | Shkrimi i lirë dhe Karrigia e autorit |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1.** Kërkoni nga nxënësit të tregojnë se çfarë u vjen në mendje kur përmendet fjala"ATDHE". Nxënësit për 2 minuta listojnë mendimet, e më pas ato shkruhen në tabelë dhe diskutohet rreth tyre.

**Hapi 2**: Mësuesi/ja ka përgatitur fotografi ose pamje në projektor nga vendi ynë. Diskutoni me nxënësit për to.

**PJESA KRYESORE**
Hapet libri

**Hapi 3** – Kërkoni të lexohen vargjet e Naim Frashërit dhe diskutoni rreth tyre. Përgjigjuni në pyetjet e dhëna.
**Hapi 4** - Kërko nga nxënësit ta lexojnë situatën 2 dhe të diskutojnë rreth saj.
**Hapi 5** – Puno rubrikën e pyetjeve.
**Hapi 6**- lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 7**– Kërko nga nxënësit që të shkruajnë r temën "Unë kujdesem për Atdheun". Punën e nxënësve kontrollojeni dhe vlerësojeni.
Disa nga nxënësit ulen në karrige para të tjerëve dhe e lexojnë punimin.
**VLERËSIMI**

- Përshkruan atdheun.
- Shpreh lirshëm mendimet.

- Shkruan për kujdesin e atdheut.

- **Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Atdheu.

| Kapitulli: Të afërmit e mi jetojnë në vende të ndryshme |
|---|
| **Tema mësimore:** Të afërmit e mi jetojnë larg atdheut |

**Situata e të nxënit**: Kudo që të jetojmë ne, duhet të mos e harrojmë gjuhën tonë, traditat e zakonet tona.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1,7, III.1, 4, VI.6, 7

**RNF**: 1.1, 2 ; 3. 1

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Identifikon të afërm që jetojnë larg atdheut.
- Liston arsye të largimit nga atdheu.
- Vlerëson rëndësinë e ruajtjes së gjuhës, traditave dhe zakoneve tona.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku dy arsye të largimit të njerëzve nga atdheu.
- Shkruaj së paku tri argumente për rëndësinë e ruajtjes së gjuhës, traditave dhe zakoneve tona.

**Fjalët kyçe** : atdhe, gjuhë, zakon, traditë.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune.
**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arte , Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës. **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Dil rrotull-fol rrotull | Të nxënit në bashkëpunim | Argumenti |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1.** Kërkoni nga nxënësit të lëvizin nëpër klasë, duke e përcjellë ecjen e tyre me një muzikë ose rrahje shuplakash. Kur përmend fjalën ***stop***, nxënësit duhet të ndalen, të kapen për dore me shokun/shoqen që e kanë afër dhe t`iu përgjigjen në pyetjes që e thoni për të gjithë. Kjo lëvizje vazhdon aq herë, sa pyetje keni përgatitur ju për nxënësit.
*A keni të afërm që jetojnë jashtë atdheut?*
*Pse janë larguar ata?*
*A duhet ata ta flasin gjuhën tonë dhe pse?*

**Hapi 2**: Kërkoni nga nxënësit të ulen dhe më pas disa t'u përgjigjen pyetjeve që i thatë më lart.

**PJESA KRYESORE**
Hapet libri.

**Hapi 3** – Kërkoni të lexohen vargjet e Asdrenit dhe diskutoni rreth tyre.
**Hapi 4** – Puno rubrikën e pyetjeve.
**Hapi 5**- Kërko nga nxënësit të shkruajnë një këshillë për njerëzit që jetojnë larg atdheut dhe disa nga ata ta lexojnë këshillën e shkruar.
**Hapi 6**- Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 7**– Kërkoni nga nxënësit në grup t'i përgjigjen pyetjes:
**Pse është e domosdohme të ruhen gjuha, tradita dhe zakonet tona?**
Nxitni nxënësit të japin sa më shumë argumente. Grupet prezentojnë punimet. Diskutohet për argumentet e dhëna.
**VLERËSIMI**
- Shpreh lirshëm mendimet.
- Bashkëpunon me shokët/shoqet.
- Jep argumente të qëndrueshme në punën në grup.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Të afërmit e mi jetojnë larg atdheut.

| **Kapitulli:** Të afërmit e mi jetojnë në vende të ndryshme |
|---|
| **Tema mësimore:** Vendndodhja e të afërmve të mi |

**Situata e të nxënit**: Njerëzit nuk jetojnë të gjithë në të njëjtin vend.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1,7, III.1, 4, VI.6, 7

**RNF**: 1.1, 2 ; 3. 1

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Liston vendbanimet e të afërmve të tij/saj.
- Përshkruan takimet me të afërmit.
- Vlerëson rëndësinë e takimeve me të afërmit e tij/saj.

**Kriteret e suksesit:**

- Listo vendbanimet e të afërmve të tu.
- Shkruaj për dashurinë e të afërmve të tu.

**Fjalët kyçe**: Dita e Faresifisit, dhuratë, simbol, takim

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, fletë me tabela.
**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arte, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.
**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Tabela e koncepteve | Të nxënit në bashkëpunim | Shkrimi i lirë |

**PJESA HYRËSE**
**Hapi 1-** U shpërndahen nxënësve tabela dhe kërkohet nga ata t'i plotësojnë.

| Familjarët | Vendi ku jetojnë | Takohemi: nganjëherë - disa herë - shpesh |
|---|---|---|
| Gjyshërit | | |
| Xhaxhallarët | | |
| Dajallarët | | |
| Hallat | | |
| Tezet | | |

**Hapi 2-** Pas plotësimit, nxënësit në dyshe do të diskutojnë për vendet në të cilat jetojnë të afërmit e tyre. Kërkohet të ndahen në grup nxënësit që kanë të afërm në vende të tjera brenda Kosovës dhe grupi që kanë të afërm jashtë atdheut dhe të bisedojnë për ta.

**PJESA KRYESORE**
Hapet libri

**Hapi 3** – Lexohet situata e dhënë dhe diskutohet rreth saj.
**Hapi 4** – Nxënësit ta krahasojnë vendndodhjen e të afërmve në situatën e librit me atë të familjarëve të tyre.
**Hapi 5**- Puno rubrikën e pyetjeve.
**Hapi 6**- Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 7**– Kërkoni nga nxënësit të shkruajnë për temën: "**Ndiej mall për të afërmit e mi**"
Disa nga nxënësit lexojnë punimet.
**VLERËSIMI**

- Shpreh lirshëm mendimet.
- Bashkëpunon me shokët/shoqet.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Vendndodhja e të afërmve të mi.

| |
|---|
| **Kapitulli:** Të afërmit e mi jetojnë në vende të ndryshme<br>**Tema mësimore:** Ruajmë traditat tona |

**Situata e të nxënit** Të diskutohet se zakonet dhe traditat zënë vend të rëndësishëm në historinë e një populli.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1,7, III.1, 4, VI.6, 7

**RNF**: 1.1, 2 ; 3. 1

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Identifikon gatimet tradicionale.
- Tregon për veshjet tradicionale për burra dhe gra.
- Vlerëson rëndësinë që ka ruajtja dhe respektimi i traditave dhe i kulturës sonë të përbashkët.

**Kriteret e suksesit:**

- Përshkruaj dy veshje tradicionale një për gra dhe një për burra.
- Përmend disa gatime tradicionale që ju i përdorni në familjen tuaj.

**Fjalët kyçe:** zakon, traditë, besë, trashëgim.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme me veshje tradicionale për gra dhe burra, gatime tradicionale, pamje nga panaire të ndryshme të organizuara.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**:
Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Gushëkuqi rrethor | Pyetja sjell pyetjen | Ditari dypjesësh |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1**– Përgatitni fotografi ose paraqitni në projektor ushqime dhe veshje tradicionale. Bisedoni me nxënësit për to. Kërkoni t'i përmendin ushqimet tradicionale që i bëjnë në shtëpi.

**Hapi 2-** Kërkoni nga nxënësit në grupe në një fletë të shkruajnë emra të ushqimeve tradicionale. E shkruan i pari nxënës një ushqim, e kalon letrën te tjetri ,e kështu me radhë te të gjithë nxënësit e grupit.

Herën e dytë vazhdon i njëjti veprim, por nxënësit do të shkruajnë emra të veshjeve tradicionale.

Secili grup prezenton punën para të tjerëve.

**PJESA KRYESORE**
Hapet libri.

**Hapi 2** – Lexohet informacioni mbi organizimin e Ditës së Farefisit.

**Hapi 3-** Bisedoni për fotografitë e dhëna. Diskuto për veshjet tradicionale të paraqitura në figurë.

- Çfarë muzike dëgjohet në organizime të tilla?
- Cilat valle luhen?
- Si ndiheni ju në një organizim të tillë?
- Kërkoni nga nxënësit të tregojnë një rast nga jeta e tyre kur ka gatime dhe veshje tradicionale.

**Hapi 4** –Diskutoni rubrikën e pyetjeve. Çfarë kuptoni me besën e shqiptarit? Të tregojnë ndonjë rast kur është nbajtur besa e shqiptarit.

**Hapi 5** – Lexoni informacionin e dhënë dhe diskutoni rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

Hapi 7 – Nxënësit ta ndajnë fletoren me një vijë në mes dhe të shkruajnë argumente se:

| Pse është mirë të përdoren: | |
|---|---|
| Gatimet tradicionale | Veshjet tradicionale |
| | |

VLERËSIMI

- Emërton ushqimet dhe veshjet tradicionale në bazë të figurës.
- Përshkruan rëndësinë që kanë ushqimet dhe veshjet tradicionale.
- Argumenton pse ka rëndësi ruajtja e traditave dhe e kulturës sonë!

Detyrë shtëpie: Fletore Pune: Tema: Ruajmë traditat tona.

**PJESA KRYESORE**
Hapet libri.

**Hapi 3** – Lexohet situata e dhënë dhe diskutohet rreth saj.
**Hapi 4** – Nxënësit ta krahasojnë vendndodhjen e të afërmve në situatën e librit me atë të familjarëve të tyre.
**Hapi 5**- Puno rubrikën e pyetjeve.
**Hapi 6**- Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 7**– Kërkoni nga nxënësit të shkruajnë për temën: "**Ndiej mall për të afërmit e mi**"
Disa nga nxënësit lexojnë punimet.
**VLERËSIMI**

- Shpreh lirshëm mendimet.
- Bashkëpunon me shokët/shoqet.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Vendndodhja e të afërmve të mi.

| |
|---|
| **Kapitulli:** Të afërmit e mi jetojnë në vende të ndryshme<br><br>**Tema mësimore:** Jemi të ngjashëm, por ndryshojmë |

**Situata e të nxënit**: Të tregojnë se njerëzit kanë kultura të ndryshme, varësisht prej vendit se ku jetojnë.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1,7, III.1, 4, VI.6, 7

**RNF**: 1.1, 2 ; 3. 1

| Rezultatet e të nxënit të lëndës: | Kriteret e suksesit: |
|---|---|
| Nxënësi/ja:<br><br>- Identifikon dallimet kulturore që kanë njerëzit brenda dhe jashtë vendit.<br>- Përshkruan ngjashmëritë që kanë njerëzit kudo që janë.<br>- Krahason kulturat, traditat dhe zakonet e njerëzve që jetojnë në vende të ndryshme. | - Përshkruaj një moment kur jemi të ndryshëm dhe të barabartë.<br><br>- Tregon së paku një fjalë të huaj dhe ndonjë simbol të një vendi të huaj. |

**Fjalët kyçe:** kulturë, të ngjashëm, të ndryshëm, komunitet, simbol, gjuhë, zakon, traditë.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Artet, Shkencat e natyrës, Jeta dhe puna

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Ditari dypjesësh | Marrëdhënia pyetje - përgjigje | Shkrim i lirë |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Shkruani në tabelë fjalët:

| Të ngjashëm | Ndryshojmë |
|---|---|
| | |

**Hapi 2-** Kërkoni nga nxënësit të tregojnë sa më shumë fjalë se pse jemi të ngjashëm dhe pse ndryshojmë.

Nxitni nxënësit që të shprehin mendime të ndryshme lidhur me këto dy fjalë.

**PJESA KRYESORE**
Hapet libri:
**Hapi 3** – Lexohet situata e dhënë dhe diskutohet rreth saj, duke kërkuar nga nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve, si:

Çfarë vendosën të bëjnë në Ditën e Farefisit? Pse?

A keni bërë ndonjëherë me të afërmit ose shokët/shoqet diçka të tillë?

Çfarë kuptuan fëmijët atë ditë? Çfarë të drejta kanë njerëzit kudo që jetojnë?

**Hapi 4** – Kërkoni nga nxënësit të ndahen në katër grupe dhe të tregojnë ndonjë karakteristikë dhe fjalë në gjuhën e vendit që u caktohet, si për shembull:

Grupi 1- Angli;

Grupi 2 - Gjermani;

Grupi 3 - Zvicër;

Grupi 4 – Amerikë;

**Hapi 5** - Punohet rubrika e pyetjeve.

**Hapi 6** – Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 8** – Nxitni nxënësit të shkruajnë një ese të shkurtër lidhur me temën: "Jemi të ngjashëm, por ndryshojmë". Nxënësit do ta lexojnë punimin para klasës.

VLERËSIMI
- Tregon raste të ndryshme lidhur me ngashmëritë dhe dallimet e njerëzve në vende të ndryshme.
- Tregon gatishmëri bashkëpunimi me shokët/shoqet e grupit.

Detyrë shtëpie: Fletore pune: Tema: Jemi të ngjashëm, por ndryshojmë.

| |
|---|
| **Kapitulli:** Raporti njeri - natyrë<br><br>**Tema mësimore:** Mjedisi ku jetoj |

**Situata e të nxënit**: Interesimi për çështjen e mjedisit në ditët e sotme është shumë i rëndësishëm, prandaj duhet të rritet ndërgjegjësimi i të gjithëve në këtë drejtim.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**Fjalët kyçe**: rrezik, kujdes, i panjohur, siguri.

1.
RNSH: I. 1, 7; II.1, 6, 7; III. 4; IV. 5; V.9

RNF: 2.3, 5.1,2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përmend bukuritë e mjedisit ku jeton.
- Vlerëson rëndësinë e mjedisit të pastër.
- Shkruan disa fjali për rëndësinë e mjedisit ku jeton.

**Kriteret e suksesit:**
- Shkruaj disa fjali për rëndësinë e mjedisit ku jeton.
- Diskuto për situatën dhe informacionin e dhënë.

Fjalët kyçe: mjedis, gjelbërim, festë, ditëlindje, shoqëri.

Burimet: Libri i nxënësit, fletore pune.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Imagjinatë e drejtuar | Lexim i drejtuar | Ditari dypjesësh |

**PJESA HYRËSE**
**Hapi 1** –Kërkoni nga nxënësit të shkruajnë një ngjarje sikur do të festojnë një festë në bregun e një lumi. Kërkoni nga ata të shkruajnë sipas këtyre pyetjeve:
- Si do të organizojnë festën?
- Si do të ndihen gjatë festës?
- Pse ndryshon kjo festë nga festat e tjera?
- Çfarë do të bëjnë, pasi të përfundojë festa?

Kërkoni nga disa nxënës ta lexojnë ngjarjen e krijuar.

**PJESA KRYESORE**
Hapet libri.

**Hapi 2 –** Kërkoni nga nxënësit ta lexojnë situatën e dhënë dhe të diskutojnë rreth saj.
**Hapi 3-**Le ta krahasojnë ngjarjen e shkruar më parë me situatën e dhënë.
**Hapi 4**: Analizohet figura e dhënë dhe punohet rubrika e pyetjeve.
Kërkoni nga nxënësit të diskutojnë për vendimin e Anës që të mos marrin teknologji me vete.
**Hapi 5** – Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet:
- Pse duhet të ndërgjegjësohen njerëzit për ruajtjen e mjedisit?
- Çfarë duhet bërë për mbrojtjen e mjedisit?

**PJESA PËRFUNDIMTARE**
**Hapi 6** – Kërkoni nga nxënësit ta ndajnë fletoren me një vijë në mes dhe në njërën anë ta shkruajnë fjalinë e dhënë, e në anën tjetër ta japin shpjegimin se si e kuptojnë atë fjali.

| | |
|---|---|
| ***«Nëna natyrë»*** *konceptohet në cilësinë e natyrës si burim jete, prandaj ajo duhet të ruhet dhe të mbrohet nga njeriu.* | |

Disa nxënës lexojnë mendimin e tyre.

**VLERËSIMI**
- Shprehin lirshëm mendimet.
- Vlerëson rëndësinë e mjedisit të pastër.

Detyrë shtëpie: Fletore pune: Tema: Mjedisi ku jetoj.

| |
|---|
| **Kapitulli:** Raporti njeri - natyrë<br><br>**Tema mësimore:** Pasuritë natyrore të vendit tim |

**Situata e të nxënit**: Kosova ka pyje, lumenj, male, dhe toka bujqësore, të cilat janë një nga burimet më të rëndësishme natyrore që ndihmojnë në zhvillimin ekonomik të vendit.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

Fjalët kyçe: rrezik, kujdes, i panjohur, siguri.

2.

RNSH: I. 1, 7; II.1, 6, 7; III. 4; IV. 5; V.9

RNF: 2.3, 5.1,2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:
- Identifikon pasuri natyrore të vendit tonë, si: lumenj, fusha, male.
- Përshkruan bukurinë e këtyre pasurive natyrore.
- Shkruan për bukuritë e vendit tonë.

**Kriteret e suksesit:**
- Shkruaj disa fjali për bukuritë e vendit tonë.
- Diskuto për situatën dhe informacionin e dhënë.

Fjalët kyçe: pasuri, vlerë, bukuri, mal, fushë, lumë, mbitokësore, nëntokësore.

Burimet: Libri i nxënësit, fletore pune, fotografi, video-incizime me bukuritë natyrore të vendit tonë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Diskutim i drejtuar | Lexim i drejtuar | Shkrimi i lirë |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** –Kërkoni nga nxënësit t'i shkruajnë vendet (lumenj, fusha, male, shpella, ujvara, monumente), të cilat do të kishin dëshirë t'i vizitonin, nëse do të organizohej një ekskursion nga shkolla.
Nxënësit do t'i shkruajnë vendet, e më pas mendimet e tyre shkruhen në tabelë.
**Hapi 2**- Mund të paraqitni fotografi ose një video-incizim me bukuritë e vendit tonë dhe diskutoni rreth tyre.

**PJESA KRYESORE**
Hapet libri.
**Hapi 3 –** Kërkoni nga nxënësit ta lexojnë situatën e dhënë dhe të diskutojnë rreth saj.
**Hapi 4**: Analizohet figura e dhënë dhe punohet rubrika e pyetjeve.

- Cilin prej vendeve të mësipërme keni parë?
- Cili të ka pëlqyer më shumë? Pse?
- Trego për ndonjë vend tjetër, jashtë Kosovës, që ti ke vizituar.
- Çfarë të ka bërë më shumë përshtypje?

**Hapi 5** – Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 6** – Kërkoni nga nxënësit të shkruajnë për temën "Bukuritë e vendit tim".

Nxënësit në grup lexojnë punimin e tyre dhe secili grup vendos që ta lexojë njërin shkrim para të tjerëve.

**VLERËSIMI**
- Shprehin lirshëm mendimet
- Bashkëpunon në grup, duke respektuar rregullat e grupit.
- Vlerëson rëndësinë e bukurive – pasurive të vendit tonë.

Detyrë shtëpie: Fletore pune: Tema: Pasuritë natyrore të vendit tim.

**Kapitulli:** Raporti njeri - natyrë

**Tema mësimore:** Njeriu dhe natyra

**Situata e të nxënit**: Ne duhet të mësojmë të jetojmë me natyrën, prandaj na duhet që të sigurojmë një mjedis të pastër.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

Fjalët kyçe: rrezik, kujdes, i panjohur, siguri.

3.
RNSH: I. 1, 7; II.1, 6, 7; III. 4; IV. 5; V.9

RNF: 2.3, 5.1,2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:
- Përshkruan të mirat që marrim nga natyra.
- Analizon sjelljet e njeriut në raport me natyrën.
- Vlerëson rëndësinë e rujatjes së natyrës.

**Kriteret e suksesit:**
- Përmend së paku dy të mira që na jep natyra.
- Jep disa argumente të sjelljes jo të mirë të njeriut me natyrën.

**Fjalët kyçe:** natyrë, kujdes, respekt, raport, bashkëveprim.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, fotografi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Pyetja sjell pyetjen | Lexim i drejtuar | Shkrimi i lirë |

**PJESA HYRËSE**
**Hapi 1** –Kërkoni nga nxënësit të përgjigjen në pyetje:
- Çfarë të mira marrim nga natyra?
- Çfarë të mire i jep njeriu natyrës?
- Çfarë gabime bëjmë ne me natyrën?

Kërkohet nga nxënësit të diskutojnë për raportin njeri- natyrë.

**PJESA KRYESORE**
Hapet libri.

**Hapi 2 –** Kërkoni nga nxënësit ta lexojnë situatën e dhënë, të diskutojnë rreth saj dhe rubrikës së pyetjeve.

- Për çfarë do të bisedonin nxënësit?
- Çfarë këshilla mendoni që ndau Ana?
- Pse është i rëndësishëm raporti njeri-natyrë?
- Po ti, çfarë këshilla do t'u kishe dhënë shoqeve/shokëve të tu?
- Trego disa veprime, përmes të cilave tregoni kujdes për natyrën.

**Hapi 5** – Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 6** – Kërkoni nga nxënësit të shkruajnë për temën: "Të dua natyrë, ti më fal të mira". Nxënësit në grup lexojnë punimin e tyre dhe secili grup vendos që ta lexojë njërin shkrim para të tjerëve.

**VLERËSIMI**

- Shprehin lirshëm mendimet.
- Bashkëpunon në grup, duke respektuar rregullat e grupit
- Vlerëson rëndësinë e rujatjes së natyrës.

Detyrë shtëpie: Fletore pune: Tema: Njeriu dhe natyra.

| |
|---|
| **Kapitulli:** Raporti njeri - natyrë<br><br>**Tema mësimore:** Ndotja e mjedisit |

**Situata e të nxënit**: Nxënësit duhet ta kuptojnë rëndësinë që kanë problemet e mjedisit dhe të marrin pjesë aktive në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tij.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**Fjalët kyçe:** rrezik, kujdes, i panjohur, siguri.

4.
RNSH: I. 1, 7; II.1, 6, 7; III. 4; IV. 5; V.9

RNF: 2.3, 5.1,2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:
Flet për kujdesin që duhet të tregojë ndaj mjedisit.
- Analizon figurat dhe situatat e dhëna në libër.
- Vlerëson rëndësinë që ka një mjedis i pastër.

**Kriteret e suksesit:**

- Shpreh lirshëm mendimet e tij/saj.
- Përmend disa veprime për mbrojtjen e mjedisit.
- Shkruan së paku tri këshilla për mbrojtjen e mjedisit.

**Fjalët kyçe**: mjedis, kujdes, mbeturina, pastërti.

**Burimet:** Libri i nxënësit, fletore pune, fotografi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Xhigsou | Lexim i drejtuar | Rrjeti i diskutimit |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** –Kërkoni nga nxënësit të ndahen në grupe dhe të shkruajnë çfarë dinë për ndotjen e natyrës dhe secili grup të shkruajë një këshillë për detyrën që i është dhënë:
Grupi 1: Ndotja e tokës;
Grupi 2: Ndotja e ujit;
Grupi 3: Ndotja e ajrit.
Secili grup e prezenton punën e bërë dhe diskutohet rreth tyre.

**PJESA KRYESORE**
Hapet libri.

**Hapi 2**–Kërkoni nga nxënësit ta lexojnë situatën e dhënë dhe të diskutojnë rreth saj.

**Hapi 3-** Kërkoni nga nxënësit ta shikojnë figurën e dhënë dhe ta bëjnë krahasimin mes dy pjesëve të figurës, ambentit të pastër dhe të ndotur.
**Hapi 4** - Punohet rubrika e pyetjeve.
**Hapi 5** – Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**
**Hapi 6** – Kërkoni nga nxënësit në grup të japin sa më shumë argumente për përgjigjet Po dhe Jo që janë dhënë në tabelë:

| Po | A është njeriu ndotësi kryesor i natyrës? | Jo |
|---|---|---|
| | | |

Nxënësit më pas do të debatojnë për argumentet e fuqishme që kanë dhënë.

**VLERËSIMI**
- Shprehin lirshëm mendimet.
- Bashkëpunon në grup, duke respektuar rregullat e grupit
- Argumenton pasojat që vijnë nga ndotja e ambientit.

Detyrë shtëpie : Fletore pune: Tema: Ndotja e mjedisit.

| |
|---|
| **Kapitulli:** Raporti njeri - natyrë<br><br>**Tema mësimore:** Flora dhe fauna |

**Situata e të nxënit**: **Flora** dhe **fauna** përbëjnë tërësinë e të gjitha llojeve të bimëve dhe të kafshëve të një zone apo vendi të caktuar.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**Fjalët kyçe:** rrezik, kujdes, i panjohur, siguri.

5.
RNSH: I. 1, 7; II.1, 6, 7; III. 4; IV. 5; V.9

RNF: 2.3, 5.1,2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:
Flet për kujdesin që duhet të tregojë ndaj bimëve dhe kafshëve.
- Analizon figurat dhe situatat e dhëna në libër.
- Vlerëson rëndësinë për kujdesin ndaj bimëve dhe kafshëve.

**Kriteret e suksesit:**

- Shpreh lirshëm mendimet e tij/saj.
- Shkruan një këshillë për kujdesin ndaj bimëve dhe kafshëve.

**Fjalët kyçe:** bimë, herbarium, flora, fauna, album.

**Burimet:** Libri i nxënësit, fletore pune, fotografi me bimë e kafshë të vendit tonë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**:

Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Pyetja sjell pyetjen | Lexim i drejtuar | Turi i galerisë |

**PJESA HYRËSE**
**Hapi 1** –Paraqitni para nxënësve dy foto.
Foto 1 - me bimë të ndryshme të vendit tonë.
Foto 2 - me kafshë të ndryshmë të vendit tonë. Kërkoni nga nxënësit të ndahen në dyshe: nxënësi 1 dhe 2 dhe të punojnë për 5 minuta. Nxënësit me numrin 1 ta përshkruajnë foton 1, kurse nxënësit 2 ta përshkruajnë foton 2.
Ndihmoni me pyetje:

- Çfarë shihet në foto?
- Ku rriten këto bimë (ku jetojnë këto kafëshë)?
- Çfarë di për këto bimë/ këto kafshë?
- A e di si quhen me një emër të gjitha bimët e një vendi/ kafshët e një vendi?

Më pas diskutoni për shkrimet e tyre.

**PJESA KRYESORE**
Hapet libri.

**Hapi 2**–Kërkoni nga nxënësit ta lexojnë situatën e dhënë dhe të diskutojnë rreth saj.

**Hapi 3-** Kërkoni nga nxënësit ta shikojnë figurën e dhënë dhe ta bëjnë krahasimin mes dy figurave.
**Hapi 4**-Punohet rubrika e pyetjeve.

- Çfarë kërkoi mësuesja nga nxënësit?
- Çfarë është herbariumi?
- Pse janë të rëndësishme flora dhe fauna?
- Si mund të kujdesemi për florën dhe faunën tonë?
- Ua jepni një mesazh shoqeve/shokëve tuaj.

**Hapi 5-** Kërkoni nga nxënësit të shkruajnë nga një mesazh për bimët dhe kafshët dhe ta lexojnë atë.

**Hapi 6** – Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 7** – Kërkoni nga nxënësit të paraqesin me vizatim se si kujdeset për bimën ose kafshën që e pëlqen.

Nxënësit ekspozojnë vizatimet dhe diskutohet rreth tyre.

**VLERËSIMI**

- Shprehin lirshëm mendimet.
- Shkruan për bimët dhe kafshët e vendit tonë.

Detyrë shtëpie: Fletore pune: Flora dhe fauna.

| **Kapitulli:** Raporti njeri - natyrë<br><br>**Tema mësimore:** Kujdesem për bimët |
|---|

**Situata e të nxënit**: Bimët janë shumë të dobishme për njerëzimin. Por bimët kanë nevojë për kujdes, ato kanë nevojë për dritë, ujë, pleh etj.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**Fjalët kyçe:** rrezik, kujdes, i panjohur, siguri.

6.
RNSH: I. 1, 7; II.1, 6, 7; III. 4; IV. 5; V.9

RNF: 2.3, 5.1,2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:
- Përshkruan lloje të ndryshme të bimëve.
- Flet për kujdesin që duhet të tregojë ndaj bimëve.
- Analizon figurat dhe situatat e dhëna në libër.
- Vlerëson rëndësinë për kujdesin ndaj bimëve.

**Kriteret e suksesit:**
- Shpreh lirshëm mendimet e tij/saj.
- Trego së paku një veprim që bën për kujdesin për bimët.

**Fjalët kyçe**: fidan, bimë kuruese, kujdes, shkurre, teknologji, oksigjen, vreshta.

**Burimet:** Libri i nxënësit, fletore pune, fotografi me bimët e vendit tonë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**:

Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Puzzle | Të nxënit në bashkëpunim | Posteri |

**PJESA HYRËSE**
**Hapi 1**- Merr tri foto: një lule që rritet në dhomë, një lule kopshti dhe një pemë. Priti fotot në forma të ndryshme, si puzzle dhe futi nëpër koverta. Shpërndaj nga një kovertë në grup dhe kërko ta ngjesin foton në fletën A/4 . Pasi ta zbulojnë figurën, ngjitni në tabelë dhe bisedoni për llojet e bimëve. Bëj pyetje dhe nxit nxënësit të tregojnë sa më shumë njohuri për bimët dhe kujdesin që duhet të kemi për to.

**PJESA KRYESORE**
Hapet libri.

**Hapi 2**–Kërkoni nga nxënësit ta lexojnë situatën e dhënë dhe të diskutojnë rreth saj.

**Hapi 3-** Kërkoni nga nxënësit ta shikojnë figurën e dhënë.

**Hapi 4**-Punohet rubrika e pyetjeve.
- Si iu duk dhurata e gjyshërve të Anës?

- Pse gjyshërit kishin menduar që t'u bënin dhuratë të gjithë fëmijëve?

- Çfarë u mësoi gjyshi fëmijëve?

- A keni marrë ndonjëherë një dhuratë të tillë?

**Hapi 5** – Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**
**Hapi 6** – Kërkoni nga nxënësit t'i shkruajnë pesë fjali, që tregojnë për kujdesin që duhet bërë për bimët.
Nxënësit lexojnë fjalitë, zgjedhin disa nga ato, shkruajnë në një flipçart dhe krijojnë në klasë posterin" Ne kujdesemi për bimët".
**VLERËSIMI**
- Shprehin lirshëm mendimet.
- Shkruan për kujdesin për bimët.

Detyrë shtëpie: Fletore pune: Tema: Kujdesem për bimët.

| **Kapitulli:** Raporti njeri - natyrë **Tema mësimore:** Kujdesem për kafshët |
|---|

**Situata e të nxënit**: **Kafshët luajnë një rol të rëndësishëm në jetën tonë familjare. Ndonjëherë ato ndodhen në situata të vështira dhe kanë nevojë për ndihmën tonë.**

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

RNSH: I. 1, 7; II.1, 6, 7; III. 4; IV. 5; V.9

RNF: 2.3, 5.1,2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:
- Përshkruan lloje të ndryshme të kafshëve.
- Flet për kujdesin që duhet të tregojë ndaj kafshëve.
- Analizon figurat dhe situatat e dhëna në libër.
- Vlerëson rëndësinë për kujdesin ndaj kafshëve.

**Kriteret e suksesit:**

- Shpreh lirshëm mendimet e tij/saj.
- Trego së paku një veprim që bën për kujdesin për kafshët.

**Fjalët kyçe:** kafshë, kujdes, miqësi, dashuri

**Burimet:** Libri i nxënësit, fletore pune, fletë A/4, asociacioni i përgatitur.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Asociacioni | Të nxënit në bashkëpunim | Kontrata |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1**- Përgatitni një asociacion në fletë A/ 3 apo me programin e asociacionit dhe zgjidhni bashkë me nxënësit.

| | | | |
|---|---|---|---|
| A.1 Qumështi | B. 1 Letargji | C.1 Pupla | D. 1 Flamuri |
| A .2 Lëkura | B.2 I bardhë | C. 2 Vezë | D. 2 Dykrenare |
| A. 3 Mishi | B.3 I zi | C. 3 Zogu | D. 3 Grabitqare |
| A. 4 Viçi | B.4 Mjalti | C. 4 Mishi | D. 4 Fluturon |
| A - LOPA | B - ARIU | C – PULA | D – SHQIPONJA |
| KAFSHËT E VENDIT TONË | | | |

**PJESA KRYESORE**
Hapet libri

**Hapi 2**–Kërkoni nga nxënësit ta lexojnë situatën e dhënë dhe të diskutojnë rreth saj.

**Hapi 3-** Kërkoni nga nxënësit të diskutojnë për figurën e dhënë.

**Hapi 4**-Punohet rubrika e pyetjeve.

- Ku jetonin një pjesë e familjes së Matit?
- Çfarë kishte atje?
- Si kujdesej Mati?
- Çfarë të mirash marrim ne prej tyre?
- A jeni kujdesur ndonjëherë për kafshë të ndryshme?
- Trego kujdesin që do të tregoje në një situatë të tillë.

**Hapi 5** – Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

- Pse duhet të kujdesemi për kafshët?
- Pse është i rëndësishëm vaksinimi i kafshëve?
- Cila është rëndësia e bashkëpunimit me veterinerin?

**PJESA PËRFUNDIMTARE**
**Hapi 6** – Mendoni sikur ju doni të merrni një kafshë në shtëpi. Prindërit kërkojnë nga ju të shkruani se si do të kujdeseni për të. Pra, ata kërkojnë nga Ju të bëni një "**kontratë**", të cilën do ta nënshkrujë edhe prindi, edhe ti.
Shkruaje: **Kontratë për kujdesin ndaj kafshës sime.**
Shkruaj të gjitha veprimet që ti do t'i bësh për t'u kujdesur për kafshën tënde. Shkruaj në një fletë A/4, zbukuroje kontratën dhe ekspozoje në klasë.
Zgjidhni kontratën më të bukur.
**VLERËSIMI**

- Shprehin lirshëm mendimet.
- Shkruan për kujdesin për kafshët.

Detyrë shtëpie: Fletore pune: Tema: Kujdesem për kafshët.

| |
|---|
| **Kapitulli:** Raporti njeri - natyrë<br><br>**Tema mësimore:** Uji është jetë |

**Situata e të nxënit** : Uji është i rëndësishëm për një jetë të shëndetshme, prandaj ne duhet ta ruajmë atë dhe ta mbajmë të pastër.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

RNSH: I. 1, 7; II.1, 6, 7; III. 4; IV. 5; V.9

RNF: 2.3, 5.1,2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:
- Përshkruan ujin si shumë të rëndësishëm për jetë.
- Flet për kujdesin që duhet të tregojë për mbrojtjen e ujit nga ndotja.
- Analizon figurat dhe situatat e dhëna në libër.
- Vlerëson rëndësinë e ujit për jetën e njeriut.

**Kriteret e suksesit:**

- Shpreh lirshëm mendimet e tij/saj.
- Shkruaj disa fjali për rëndësinë e ujit.

**Fjalët kyçe:** ujë, i pastër, i domosdoshëm, ndotje, higjienë.

**Burimet:** Libri i nxënësit, fletore pune, fotografi me bimë e kafshë të vendit tonë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**:

Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Loja- Pantomima | Të nxënit në bashkëpunim | Shkrimi i lirë |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1**- Kërkoni nga nxënësit të bëhen rreth dhe ta luajnë lojën sikur po lajnë duart. Luani edhe ju, duke bërë t'ju imitojnë nxënësit: Fërkoni duart para, pas, gishtat në mes. Përsëritni këtë veprim për disa herë. Pyetni nxënësit:

- Çfarë bëmë?
- Me çfarë mbajmë higjienën e trupit dhe të shtëpisë?
- Çfarë është uji?
- Për çfarë e përdorim ujin?

**Hapi 2**- Paraqitni një fotografi, ku shihet ujë i ndotur dhe bisedoni rreth saj.

**PJESA KRYESORE**
Hapet libri.

**Hapi 3**–Kërkoni nga nxënësit ta lexojnë situatën e dhënë dhe të diskutojnë rreth saj. Pse Anës iu kujtua fjala e mësueses **Uji është jetë?**

**Hapi 4-** Kërkoni nga nxënësit të diskutojnë për figurën e dhënë.

**Hapi 5**- Punohet rubrika e pyetjeve.

- Çfarë po bënin fëmijët?
- Pse Mati u kërkoi që të ishin të kujdesshëm?
- Trego disa karakteristika të ujit.
- Pse është i rëndësishëm uji për jetën tonë?
- Si mund ta mbrojmë ujin nga ndotja?

**Hapi 6** – Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.
- Cilët janë ndotësit e ujit?

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 6** – Kërkoni nga nxënësit të shkruajnë për temën **"Uji është jetë".** Disa nxënës lexojnë punimin e tyre.

**VLERËSIMI**
- Shprehin lirshëm mendimet.
- Shkruan për kujdesin për mbrojtjen e ujit.

Detyrë shtëpie: Fletore pune: Tema: Uji është jetë.

| **Kapitulli:** Raporti njeri - natyrë<br><br>**Tema mësimore:** Rëndësia e ujit për jetën e njeriut |
|---|

**Situata e të nxënit**: Njerëzit hapën liqene artificiale dhe ndërtuan rrjetin e ujësjellësit për t'i furnizuar me ujë të pijshëm të gjitha fshatrat e qytetet.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

RNSH: I. 1, 7; II.1, 6, 7; III. 4; IV. 5; V.9

RNF: 2.3, 5.1,2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:
- Shkruan rregulla për kursimin e ujit.
- Flet për kujdesin që duhet të tregojë për kursimin e ujit.
- Vlerëson rëndësinë e kursimit të ujit të pijshëm.

**Kriteret e suksesit:**

- Shpreh lirshëm mendimet e tij/saj.
- Shkruaj disa fjali për rëndësinë e ujit të pijshëm.

**Fjalët kyçe:** pus, ujësjellës, i pijshëm, ujitje, larje, pastrim.

**Burimet:** Libri i nxënësit, fletore pune.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Bashkëbisedim | Të nxënit në bashkëpunim | Pyetje argumentuese |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1**- Kërkoni nga nxënësit të tregojnë se çfarë iu vjen në mendje kur përmendet fjala: **Kursim i ujit.**
Çfarë duhet bërë për kursimin e ujit?
Nxënësit shprehin lirshëm mendimet e tyre, shkruhen në tabelë dhe diskutohet rreth tyre.

**PJESA KRYESORE**
Hapet libri.

**Hapi 2**–Kërkoni nga nxënësit ta lexojnë situatën e dhënë dhe të diskutojnë rreth saj.

**Hapi 3-** Kërkoni nga nxënësit të diskutojnë për figurën e dhënë dhe ta bëjnë krahasimin e furnizimit me ujë, që është bërë dikur dhe tani, dhe si punohet rubrika e pyetjeve.

- A ke parë ndonjëherë pus? Përshkruaje atë.
- Çfarë mendon ti për vështirësitë që kishin njerëzit kur merrnin ujin nga pusi?
- A mendon se uji i pusit është i pijshëm? Pse?
- Si vjen uji deri në shtëpitë tona?
- Cili është liqeni, nga i cili furnizohet qyteti juaj me ujë të pijshëm?
- Pse është e rëndësishme ta kursejmë ujin?
- Trego një rast kur ti kursen ujin.

**Hapi 4-** Lexoni këshillat për kursimin e ujit. Shtoni bashkë me nxënësit edhe disa këshilla të tjera për kursimin e ujit.

**Hapi 5** – Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.
- Sa ka ujë në tokë dhe ku gjendet ai?
- Çfarë uji është në dete e oqeane?
- Çfarë bënë njerëzit për të marrë ujë të pijshëm?
- Për çfarë përdoret uji?

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 6** – Kërkoni nga nxënësit të japin sa më shumë argumente për pyetjen:

**Nëse në tokë ka kaq shumë ujë, pse është problem uji i pijshëm?**
Diskutohet për punimet e nxënësve.

**VLERËSIMI**
- Shprehin lirshëm mendimet.
- Shkruan për rëndësinë e ujit të pijshëm.

Detyrë shtëpie : Fletore pune: Tema: Rëndësia e ujit për jetën e njeriut.

| |
|---|
| **Kapitulli:** Raporti njeri – natyrë<br>**Tema mësimore:** Toka dhe ajri |

**Situata e të nxënit**: Toka ku ne jetojmë dhe zhvillojmë veprimtarinë tonë është mjaft e rëndësishme. Ajri që ne thithim shpeshherë është i ndotur, sidomos në zonat urbane, ku është e përqendruar edhe popullsia më e madhe.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

RNSH: I. 1, 7; II.1, 6, 7; III. 4; IV. 5; V.9

RNF: 2.3, 5.1,2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan tokën dhe ajrin si shumë të rëndësishëm për jetë.
- Flet për kujdesin që duhet të tregojë për mbrojtjen e tokës dhe të ajrit nga ndotja.
- Vlerëson rëndësinë e tokës dhe të ajrit për jetën e njeriut.

**Kriteret e suksesit:**

- Shpreh lirshëm mendimet e tij/saj.
- Shkruaj disa fjali për rëndësinë e tokës dhe të ajrit.

**Fjalët kyçe:** ajri, toka, interneti, pa ngjyrë, jetë, ndotje, kujdes.

**Burimet:** Libri i nxënësit, fletore pune
**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Copëza të përziera | Të nxënit në bashkëpunim | Kubimi |

## PJESA HYRËSE

**Hapi 1**- Shkruani në fletë ose në tabelë fjalët e përziera dhe kërkoni nga nxënësit në grupe t'i renditin fjalët për të krijuar fjali me kuptim.

1. Kryesor, është, ndotësi, njeriu, tokës, i **( Ndotësi kryesor i tokës është njeriu).**

**2.** Duhet, kemi, kujdes, tokën, shumë, për , të, ne, mbrojtjen, e
( **Ne duhet të kemi shumë kujdes për mbrojtjen e tokës).**
**3.** më e mirë, parandalimin, mënyra, për, e ndotjes, këmbë, së ajrit, ose me, është, të ecim, biçikletë, në
(***Mënyra më e mirë për parandalimin e ndotjes së ajrit është të ecim në këmbë ose me biçikletë.)***
4. sa më, i makinave, pak, përdorimi, parandalojë, ndotjen, do ta, e ajrit

**(Përdorimi sa më pak i makinave, do ta parandalojë ndotjen e ajrit.)**

**Hapi 2**- Kërkoni nga secili grup të lexohen fjalitë dhe diskutoni rreth tyre.

## PJESA KRYESORE

Hapet libri.

**Hapi 3**–Kërkoni nga nxënësit të lexojnë situatën dhe figurën e dhënë dhe të diskutojnë rreth saj.

**Hapi 5**-Punohet rubrika e pyetjeve.

- Çfarë projekti po përgatiste Ana?

- Trego disa karakteristika të ajrit.

- Po për tokën, çfarë di?

- Pse është i rëndësishëm ajri për jetën tonë?

- Po toka, pse është e rëndësishme?

- Si mund ta mbrojmë ajrin dhe tokën nga ndotja?

**Hapi 6** – Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 6** – Kërkoni nga nxënësit të ndahen në dyshe në numrat 1 dhe 2. Nxënësit me numrin 1 do të shkruajnë për ujin, kurse nxënësit me numrin 2 për ajrin.

1.

| |
|---|
| **Përshkruaje**: Si duket Toka?<br>**Krahasoje:** Me çka mund ta krahasosh tokën?<br>**Shoqëroje**:Çfarë iu vjen në mendje, kur përmendet toka?<br>**Analizoje:** Cilët janë ndotësit e tokës?<br>**Zbatoje**: Si mund të zvogëlojmë ndotjen e tokës?<br>**Vlerësoje:** Pse është e rëndësishme të mbrohet toka nga ndotja? |
| 2. |
| **Përshkruaje**: Si është ajri?<br>**Krahasoje:** Me çka mund ta krahasosh ajrin?<br>**Shoqëroje**:Çfarë iu vjen në mendje, kur përmendet ajri?<br>**Analizoje:** Cilët janë ndotësit e ajrit?<br>**Zbatoje**: Si mund ta zvogëlojmë ndotjen e ajrit?<br>**Vlerësoje:** Pse është e rëndësishme të mbrohet ajri nga ndotja? |

Më pas, nxënësit në dyshe do të bisedojnë për plotësimet që kanë bërë.

**VLERËSIMI**

- Shprehin lirshëm mendimet.
- Shkruan për kujdesin për mbrojtjen e tokës dhe të ajrit.

Detyrë shtëpie: Fletore pune: Tema: Uji është jetë.

**Kapitulli:** Llojllojshmëri në shoqëri
**Tema mësimore:** Të gjithë së bashku

**Situata e të nxënit**: Të tregojë se është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi mes njerëzve. Me bashkëpunim çdo punë bëhet më e mirë.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1, III.1, IV.3, V.3, VI.1, 6

**RNF**: 1.1, 3; 3. 1, 2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Analizon rëndësinë e nevojës për grupet shoqërore dhe njerëzit që e rrethojnë.
- Tregon gatishmëri për të ndihmuar.
- Vlerëson rëndësinë e bashkëpunimt mes vete.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku një ngjarje, me të cilën ke ndihmuar të tjerët.
- Trego disa grupe shoqërore që ti merr pjesë dhe bashkëpunimin që keni aty.

**Fjalët kyçe:** grup shoqëror, familje, komunitet, respekt, mirëqenie, bashkëpunim.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.
**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Imagjinatë e drejtuar | Të nxënit në bashkëpunim | Mësoj përmes lojës |

**PJESA HYRËSE**
**Hapi 1**-Kërkoni nga nxënësit t'i ulin kokat, t'i mbyllin sytë dhe të krijojnë në kokat e tyre një ngjarje. Lexoni tekstin ngadalë dhe me intonacion.

*Sot mungove në shkollë, sepse ishe i sëmurë. Kisha pesë orë mësimi. Sa vështirë do ta kem të mësoj mësimet, pasi nuk dëgjova mësuesen duke shpjeguar. Çfarë të bëj? Ta thërras mësuesen? Jo, nuk bën. Të bisedoj me ndonjë shok apo shoqe? Pse? Çfarë mund të bëjnë ata për mua?*

**Hapi 2**-Kërkoni nga nxënësit të shkruajnë një ngjarje dhe më pas disa prej tyre e lexojnë atë.

**PJESA KRYESORE**
Hapet libri.

**Hapi 3**–Lexohet situata e dhënë në libër. Për kë flitet në situatën e lexuar? Çfarë mendon ti për Anën? A të pëlqeu mënyra si e shpjegoi Ana mësimin? Pse? A të ka ndodhur ty të ndihmosh ndonjë shok/shoqe në mësime apo të kanë ndihmuar ty?
**Hapi 4-**Krahasoni shkrimin që e bëtë në fillim me situatën në libër.
**Hapi 5**- Punoni rubrikën e pyetjeve.
**Hapi 6**- Lexoni informacionin e dhënë dhe diskutoni rreth tij.
**PJESA PËRFUNDIMTARE**
**Hapi 7** – Kërkoni nga nxënësit që të shpjegojnë një mësim përmes një loje, duke u bazuar në situatën e dhënë. Zgjidhni nxënësin që e krijoi lojën më të bukur.

**VLERËSIMI**
- Komenton dhe diskuton për situatën e dhënë.
- Jep shembuj nga jeta e tij/saj.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Të gjithë së bashku.

| |
|---|
| **Kapitulli:** Llojllojshmëri në shoqëri<br>**Tema mësimore:** Diversiteti etnik e kulturor |

**Situata e të nxënit**: Diversiteti apo llojllojshmëria kulturore është e rëndësishme për botën, sepse vendet e punës dhe shkollat përbëhen gjithnjë e më shumë nga grupe të ndryshme kulturore, racore dhe etnike.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**:III

**RNSH:** I.1, III.1, IV.3, V.3, VI.1, 6

**RNF**: 1.1, 3; 3. 1, 2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan diversitetin etnik e kulturor.
- Analizon respektin dhe mirëkuptimin mes njerëzve.
- Vlerëson rëndësinë e respektit për një jetë më të mirë.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku një rast të diversitetit etnik apo kulturor nga jeta e tij/saj.
- Shkruaj një fjali për diversitetin.

**Fjalët kyçe:** diversitet, ndryshime etnike, kulturë, besim fetar, gjuhë zyrtare.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, fotografi të ndryshme, videoprojektor.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Bashkëbisedim | Të nxënit në bashkëpunim | Duart tona |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1**-Përgatitni fotografi ose pamje në videoprojektor, ku paraqiten klasa të nxënësve të përbëra nga fëmijë të racave të ndryshme. Bisedoni me nxënësit për to. Kërkoni nga ata të tregojnë se çfarë dallojnë mes vete këta fëmijë, çfarë kanë të përbashkët, a duhet të sillemi njëjtë me të gjithë dhe pse.

**PJESA KRYESORE**
Hapet libri.

**Hapi 2**–Lexohet situata e dhënë në libër. Për kë flitet në situatën e lexuar? Për çfarë diskutojnë ata?
**Hapi 3-**Punoni rubrikën e pyetjeve.

- Çka kupton me fjalën diversitet?
- Cilët popuj jetojnë në vendin tonë?
- A kanë ata të drejta?
- A respektohen të drejtat e tyre?
- Pse duhet të respektohen popujt pavarësisht përkatësisë etnike?

**Hapi 4**-Kërkoni nga nxënësit të tregojnë diçka nga ekeperienca e tyre, a kanë pasur ndonjë rast ku respektohen ose jo të drejtat pavarësisht përkatësisë etnike.

**Hapi 5**- Lexoni informacionin e dhënë dhe diskutoni rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**
**Hapi 6** – Kërkoni nga nxënësit në grupe, në një fletë A/3, ta vizatojnë dhe ta ngjyrosin secili dorën e tij/saj dhe ta shkruajnë nga një fjali për diversitetin. Punimet ekspozohen në klasë analizohen, vlerësohen dhe zgjedhet punimi më i bukur.

**VLERËSIMI**
- Komenton dhe diskuton për situatën e dhënë.
- Jep shembuj nga jeta e tij/saj.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Diversiteti etnik e kulturor.

| |
|---|
| **Kapitulli:** Llojllojshmëri në shoqëri<br>**Tema mësimore:** Jetojmë së bashku me tolerancë e dashuri |

**Situata e të nxënit**: Fjala tolerancë nënkupton gatishmërinë për të pranuar ose për të toleruar mendimet e të tjerëve.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1, III.1, IV.3, V.3, VI.1, 6

**RNF**: 1.1, 3; 3. 1, 2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Demonstron tolerancë dhe solidaritet në komunikim dhe bashkëpunim me të tjerët.
- Përshkruan raste të tolerancës mes shokëve/shoqeve.
- Vlerëson rëndësinë e tolerancës për bëshkëpunim dhe mirëkuptim.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku një rast kur je treguar tolerant/e.
- Trego së paku një rast kur nuk je treguar tolerant/e.

**Fjalët kyçe:** familje, nëna, babai, vajza, djali në mobileri te dollapët e kuzhinës.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune,

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Bashkëbisedim | Të nxënit në bashkëpunim | Shkrimi i lirë |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1**-Kërkoni nga nxënësit ta tregojnë mendimin e tyre për fjalinë më poshtë:
***Unë kur bisedoj me shokët, gjithnjë dua të bëhet ashtu siç them unë!***
Kërkoni nga nxënësit t'i shprehin lirshëm mendimet e tyre.
**Hapi 2**- Më pas, vazhdoni me pyetje:

- A mendoni se duhet të dëgjohen edhe mendimet e të tjerëve?
- Çfarë mendoni për ata që nuk dëgjojnë asnjë mendim?
- Tregoni një rast kur keni penguar shokët, sepse doje të bëhej siç doje ti.

**PJESA KRYESORE**
Hapet libri.

**Hapi 2**–Lexohet situata e dhënë në libër. Për kë flitet në situatën e lexuar? Çfarë mendoni ju, cili është problemi në atë familje?

**Hapi 3-**Punoni rubrikën e pyetjeve.

- Çfarë është toleranca?
- Si do e zgjidhje ti këtë problem?

**Hapi 4**- Kërkoni nga nxënësit ta luajnë në klasë rolin e anëtarëve të familjes dhe me tolerancë të vendosin cilët dollapë do t'i blejnë.

**Hapi 5**- Lexoni informacionin e dhënë dhe diskutoni rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**
**Hapi 6** – Kërkoni nga nxënësit të shkruajnë për temën: "**Unë jam tolerant".**
Disa nxënës lexojnë punimet e tyre.
**VLERËSIMI**

- Komenton dhe diskuton për situatën e dhënë.
- Luan rolin dhe bashkëpunon me të tjerët.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Jetojmë së bashku me tolerancë e dashuri.

| |
|---|
| **Kapitulli:** Llojllojshmëri në shoqëri<br>**Tema mësimore:** Njeriu dhe profesionet |

**Situata e të nxënit** : Njerëzit shkojnë në shkollë për të marrë njohuri për një profesion të caktuar.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1, III.1, IV.3, V.3, VI.1, 6

**RNF**: 1.1, 3; 3. 1, 2

| **Rezultatet e të nxënit të lëndës:** | **Kriteret e suksesit:** |
|---|---|
| Nxënësi/ja:<br><br>- Tregon profesionet e prindërve të tij.<br>-Përshkruan punën që bëhet sipas profesionit.<br>- Vlerëson rëndësinë e llojllojshmërisë së profesioneve për një jetë më të mirë. | - Trego profesionet e prindërve.<br>- Trego çfarë profesioni do të kesh kur të rritesh dhe pse. |

**Fjalët kyçe:** familje nëna, babai, vajza, djali në mobileri te dollapët e kuzhinës.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune,

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.
**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Xhigsou | Mësimdhënia e ndërsjellë | Shkrimi i lirë |

**PJESA HYRËSE**
**Hapi 1**-Kërkoni nga nxënësit t'i tregojnë profesionet që dinë. Mendimet e tyre shkruhen në tabelë. Më pas, kërkoni nga ata të bëhen rreth në klasë dhe të tregojnë për profesionet e prindërve të tyre.
**Hapi 2**- Kërkoni të ndahen në grupe sipas profesionit të përbashkët të prindërve dhe të shkruajnë në një fletë A/4 se çfarë dinë për atë profesion. Mund të mbetet ndonjë nxënës i vetëm, sepse nuk ka asnjë prind i nxënësve në klasë atë profesion, atëherë mund ta ndihmojë mësuesi/ja.

**Hapi 3**- Secili grup paraqet punimin para të tjerëve**.**
**PJESA KRYESORE**
Hapet libri.

**Hapi 4**–Kërkohet nga nxënësit të lexojnë në dyshe me shokun/shoqen e bankës situatën 1. Nxënësi 1 lexon situatën, nxënësi 2 bën pyetje rreth saj.

**Hapi 5-**Punoni rubrikën e pyetjeve.

**Hapi 6**–Kërkohet nga nxënësit të lexojnë në dyshe me shokun/shoqen e bankës situatën 2. Nxënësi 2 lexon situatën, nxënësi 1 bën pyetje rreth saj.

**Hapi 7-**Punoni rubrikën e pyetjeve"Diskutojmë së bashku".

**Hapi 8**- Lexoni informacionin e dhënë dhe diskutoni rreth tij. Ndani tabelën në dy pjesë, kërkoni mendimet nga nxënësit dhe plotësoni.

| Profesionet e njerëzve që jetojnë në fshat | Profesionet e njerëzve që jetojnë në qytet |
|---|---|
| | |

**PJESA PËRFUNDIMTARE**
**Hapi 6** – Kërkoni nga nxënësit të shkruajnë për temën: "**Kur të rritem, do të bëhem…".**
Kërkohet nga nxënësit të ndahen në grupe sipas profesionit që kanë shkruar dhe në grup t'i lexojnë punimet.

**VLERËSIMI**

- Lexon qartë dhe u përgjigjet saktë pyetjeve që ia bën shoku.
- Përshkruan profesionet e ndryshme.
- Shkruan për profesionin që i pëlqen.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Njeriu dhe profesionet.

| |
|---|
| **Kapitulli:** Së bashku dhe të barabartë<br>**Tema mësimore:** Të ndryshëm, por të barabartë |

**Situata e të nxënit**: Njerëzit nuk dallohen vetëm nga raca, gjuha, besimi fetar, kultura, por edhe nga gjinia. Njerëzit janë të gjinisë femërore dhe mashkullore.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1, III.1, IV.3, V.3, VI.1, 6

**RNF**: 1.1, 3; 3. 1, 2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Analizon dallimet në aspektin gjinor djalë-vajzë.
- Karahason dallimet dhe të përbashkëtat mes të dy gjinive.
- Tregon për të drejtat e barabarta në mes të dy gjinive.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego për dallimet gjinore.
- Trego së paku dy të drejta të barabarta mes femrave e meshkujve.

**Fjalët kyçe:** gjini, djalë, vajzë, të barabartë, të ndryshëm.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune,

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.
**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Pyetja sjell pyetjen | Të nxënit në bashkëpunim | Shkrimi i lirë |

**PJESA HYRËSE**
**Hapi 1**-Shkruhet në tabelë 8 Marsi.
Kërkohet nga nxënësit të tregojnë:
*Çfarë feste është 8 Marsi?*
*Pse festohet kjo festë?*
*A kishin gratë dikur të drejta të barabarta me burrat? Pse?* Nxiten nxënësit të tregojnë për dallimet gjinore që kanë qenë dikur.

**PJESA KRYESORE**
Hapet libri.

**Hapi 2**–Kërkohet nga nxënësit ta lexojnë situatën 1 dhe të bisedojnë rreth saj.
*Në mes cilëve u zhvillua biseda? Çfarë pyetje do t'i bëje gjyshit të Matit, po të ishe me të? A keni biseduar në familjen tuaj ndonjëherë për këto fakte?*

**Hapi 3-**Punoni rubrikën e pyetjeve.

- Si ka qenë dikur dallimi mes vajzës e djalit?

- Po sot, a ka dallim mes vajzës dhe djalit? Pse?

- Po në familjen tuaj, a ka ndryshime të tilla?

- A mendon edhe ti se të dy gjinitë duhet të kenë të drejta të barabarta? Pse?

**Hapi 4**- Lexoni informacionin e dhënë dhe diskutoni rreth tij. Kërkoni nga ata të shpjegojnë fjalitë: ***Gratë dhe burrat kanë të drejtën për shkollim, punësim, respekt dhe pjesëmarrje aktive në gjithë jetën e vendit.***

**PJESA PËRFUNDIMTARE**
**Hapi 6** – Kërkoni nga nxënësit të shkruajnë për temën: "**Unë dhe motra ime kemi të drejta të barabarta".**
Disa nga nxënësit do t'i lexojnë punimet.

**VLERËSIMI**

- Analizon situatën dhe jep argumente rreth saj.
- Shpreh lirshëm mendimin e tij/saj.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Të ndryshëm, por të barabartë.

**Kapitulli:** Së bashku dhe të barabartë
**Tema mësimore:** Të punojmë së bashku

**Situata e të nxënit**: Në familje dhe në shoqëri njerëzit jetojnë së bashku. Për të patur një jetë më të mirë, ata duhet të kujdesen për të gjitha punët e shtëpisë.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1, III.1, IV.3, V.3, VI.1, 6

**RNF**: 1.1, 3; 3. 1, 2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan punët që bëjnë të gjithë në familje.
- Rendit punët që bën secili në familje.
- Vlerëson rëndësinë e ndihmës ndaj njëri-tjetrit në familje.
-

**Kriteret e suksesit:**

- Listo punët që kryen ti në familje.
- Trego së paku nga dy punë që kryen secili në familjen tuaj.

**Fjalët kyçe:** kujdes, ndihmë, dashuri, respekt.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, fotografi me punët që kryejnë anëtrët e familjes, videoprojektor.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.
**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Diagram Veni | Të nxënit në bashkëpunim | Ditari tripjesësh |

**PJESA HYRËSE**
**Hapi 1**-Paraqiten para nxënësve fotografi ose punë të ndryshmenë videoprojektor që kryhen në familje nga anëtarët e afmiljes. Nxiten nxënësit të bisedojnë rreth tyre.
**Hapi 2**-Kërkohet nga nxënësit në grup t'i krahasojnë burrat dhe gratë, të përbashkëtat dhe dallimet mes tyre.




**Hapi 3** – Grupet prezentojnë punimet.
**PJESA KRYESORE**
Hapet libri.

**Hapi 4**–Kërkohet nga nxënësit ta lexojnë situatën 1 dhe të bisedojnë rreth saj. *Në mes cilëve u zhvillua biseda? A do të pëlqente të ishe edhe ti në autobus? Pse?*

**Hapi 5-**Punoni rubrikën e pyetjeve.

- *Pse xhaxhai mendon që burrat nuk janë për punë shtëpie?*
- *A ju pëlqen përgjigja e Drinit? Pse?*
- *Po ti, si do të përgjigjeshe në një situatë të tillë? Pse?*

**Hapi 6**- Kërkoni nga nxënësit të tregojnë se si kryhen punët në shtëpinë e tyre. A i kryen ato vetëm mami apo edhe të tjerët? Pse?

**Hapi 7**- Lexoni informacionin e dhënë dhe diskutoni rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 8-**Kërkohet nga nxënësit ta plotësojnë tabelën.

Në shtëpinë time të gjithë punojmë. Ne kryejmë këto punë:

| **Mami** | **Babi** | **Unë** |
|---|---|---|
| | | |

**D**isa nga nxënësit do t'i lexojnë punimet.

**VLERËSIMI**

- Analizon situatën dhe jep argumente rreth saj.
- Shpreh lirshëm mendimin e tij/saj.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Të punojmë së bashku.

| |
|---|
| **Kapitulli:** Së bashku dhe të barabartë<br>**Tema mësimore:** Veprimtaria 3:"Unë, ti të barabartë!" |

**Situata e të nxënit**: Puna që bëhet në bashkëpunim, është e kryer më mirë.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1, III.1, IV.3, V.3, VI.1, 6

**RNF**: 1.1, 3; 3. 1, 2

| **Rezultatet e të nxënit të lëndës:** | **Kriteret e suksesit:** |
|---|---|
| Nxënësi/ja:<br>- Bashkëpunon me shokët dhe shoqet e grupit.<br>- Zbaton rregullat e punës në grup.<br>- Vlerëson rëndësinë e bashkëpunimit me njëri-tjetrin.<br>- | - Trego së paku nga dy arsye që ndihmojnë bashkëpunimin mes shokëve e shoqeve në klasë. |

**Fjalët kyçe:** kujdes, ndihmë, dashuri, respekt.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune,

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Këndet | Të nxënit në bashkëpunim | Punë në grupe |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1**- Ngjitni në katër anët e klasës nga një fletë A/4, në të cilën ke shkruar:

1. Futboll;
2. Basketboll;
3. Vallëzim;
4. Not.

Kërkoni nga nxënësit të shkojnë te këndi ku është ngjitur loja që u pëlqen dhe të tregojnë pse e pëlqejnë atë lojë. Numëro në secilin grup sa djem e vajza janë. Pyet nxënësit:
A ndahen lojërat sipas gjinisë? Pse? Nxitni nxënësit të japin sa më shumë mendime.

**PJESA KRYESORE**

Hapet libri.

**Hapi 2**- Kërkohet nga nxënësit ta lexojnë situatën 1 dhe të bisedojnë rreth saj. Punoni rubrikën e pyetjeve ”Diskutojmë së bashku”.

- Çfarë ka dëshirë të luajë Lola?
- Pse vëllezërit nuk e marrin në lojë?
- A kanë të drejtë ata?
- A ka në klasën tuaj ndonjë vajzë që dëshiron të luajë futboll?
- Provoni edhe ju që ta mbani topin me këmbë.
- Kush mund ta fitojë garën?

**Hapi 3-**- Kërkohet nga nxënësit ta lexojnë situatën 2 dhe të bisedojnë rreth saj. Punoni rubrikën e pyetjeve.

- Cili vallëzim e fitoi garën? Pse?
- Pse bashkëpunimi sjell fitore?
- A keni provuar të kërceni në klasë apo në ndonjë festë familjare?
- Trego raste kur bashkëpunimi ju ka ndihmuar që të keni sukses.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 4 –**Kërkoni nga nxënësit të kryejnë bashkë lojëra me qëllim bashkëpunimi. Këto aktivitete mund të planifikohen në orën e ardhshme. Ata do të ndahen në grupe me nga tre djem e tri vajza dhe të organizojnë:

Grupi 1: Kuiz me pyetje nga lënda Shoqëria dhe mjedisi.

Grupi 2: T'i shkruajnë 10 rregulla për punën në grup.

Grupi 3: Të shkruajnë një situatë, që ka të bëjë me bashkëpunimin mes shokëve në klasë.

Grupi 4: T'i shkruajnë 10 argumente që bashkëpunimi ndihmon njëri - tjetrin.

**Hapi 5-** Secili grup paraqet punimin dhe vlerësohen për punën e bërë.

**VLERËSIMI**

- Shpreh lirshëm mendimin e tij/saj.
- Bashkëpunon me shokët/shoqet

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Veprimtaria 4 - ”Unë, ti të barabartë!”

**Kapitulli:** Konsultohemi së bashku dhe vendosim

**Tema mësimore:** Vendosim së bashku në familje

**Situata e të nxënit**: Të rriturit dëgjojnë fëmijët duke marrë në konsideratë mendimin e tyre.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1,3; III.1, 8; IV. 5; V. 6, 8; VI. 2, 5

**RNF**: 1.1;4.1,2

| **Rezultatet e të nxënit të lëndës:** | **Kriteret e suksesit:** |
| --- | --- |
| Nxënësi/ja:<br><br>- Përshkruan familjen si grupin më të vogël shoqëror ku duhet të merret mendimi i secilit.<br>- Përmend rolin që luan çdo anëtar i familjes në marrjen e vendimeve.<br>- Vlerëson rëndësinë e familjes për t'ua mundësuar fëmijëve pjesëmarrjen në vendimmarrje. | - Trego së paku një rast kur familja ka marrë në konsideratë mendimin tënd.<br>- Trego një arsye pse është e rëndësishme pjesëmarrja e fëmijëve në vendimmarrje në familje. |

**Fjalët kyçe**: pjesëmarrje, kamp veror, mirëkuptim, parim.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Artet, Matematikë.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Lojë | Imagjinatë e drejtuar | Bisedë e lirë |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Kërkohet nga nxënësit se si nëpërmjet një loje, do t'ua kërkonin prindërve apo motrave e vëllezërve mirëkuptimin për t'i kaluar pushimet së bashku me shoqet/shokët. Kërkoni nga nxënësit ta shkruajnë mendimin e tyre për pesë minuta.

**Hapi 2** – Disa nga nxënësit le ta lexojnë mendimin e shprehur.

**PJESA KRYESORE**

Hapet libri.
**Hapi 3** – Lexoni dhe diskutoni për situatën e dhënë në libër. Nxitet imagjinata e nxënësve për të shprehur se si mund të vazhdojë situata e dhënë. Cila mund të ishte zgjidhja më e mirë.
**Hapi 4** – Kërkoni nga nxënësit ta përshkruajnë dhe ta komentojnë ilustrimin e dhënë.
**Hapi 5 -** Punohen pyetjet që janë në librin bazë.
**Hapi 6 -** Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 7** – Zhvillohet me nxënësit një bisedë e lirë se si veprojnë ata për t'u kërkuar prindërve diçka në familje.

**VLERËSIMI**

- Diskuton për situatat e dhëna në ilustrim.
- Përshkruan se si e ka mbështetur familja në rastet kur e ka shprehur mendimin e saj/e tij.
- Analizon situatën në të cilën marrin një vendim në familjen e tyre.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Vendosim së bashku në familje.

| **Kapitulli:** Konsultohemi së bashku dhe vendosim<br><br>**Tema mësimore:** Vendosim së bashku në shkollë |
|---|

**Situata e të nxënit**: Vendimi merret me mirëkuptim, duke respektuar mendimin e të tjerëve.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1,3; III.1, 8; IV. 5; V. 6, 8; VI. 2, 5

**RNF**: 1.1;4.1,2

| **Rezultatet e të nxënit të lëndës:**<br>Nxënësi/ja:<br><br>- Përshkruan shkollën si vendin ku merren mendime të përbashkëta.<br>- Përmend rregullat që duhet të zbatohen gjatë marrjes së vendimit.<br>- Vlerëson rëndësinë që ka vendimmarrja e përbashkët në shkollë. | **Kriteret e suksesit:**<br><br>- Trego së paku një rast kur është arritur mirëkuptimi brenda klasës në marrjen e një vendimi.<br>- Trego një arsye pse është e rëndësishme të dëgjohet mendimi i të gjithëve. |
|---|---|

**Fjalët kyçe**: plan aktivitetesh, listim, votim, mendim i shumicës, vendimmarrje.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Artet, Matematikë.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Pyetje - përgjigje | Të nxënit në bashkëpunim | Shkrim i lirë |

## PJESA HYRËSE

**Hapi 1** – Para nxënësve paraqitet një video, ku tregohet një rast se si është realizuar një vendimmarrje nga ana e nxënësve për një problem të caktuar.

**Hapi 2** – Pyetni nxënësit dhe kërkoni nga ata që të flasin rreth situatës.

## PJESA KRYESORE

Hapet libri.

**Hapi 3** – Lexoni dhe diskutoni për situatën e dhënë në libër.

**Hapi 4** – Kërkoni nga nxënësit të tregojnë se si e hartojnë ata planin e aktiviteteve.

**Hapi 5** – Punohen pyetjet që janë në librin bazë.

**Hapi 6 -** Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

## PJESA PËRFUNDIMTARE

**Hapi 7** – Nxënësve u kërkohet që të bëjnë një shkrim të lirë, ku shkruajnë se si merret një vendim i përbashkët.

## VLERËSIMI

- Komenton dhe diskuton për situatat e dhëna në ilustrim.
- Bashkëpunon me të tjerët për të arritur në një vendimmarrje të përbashkët.
- Shpreh lirshëm mendimin e saj/tij në shkollë.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Vendosim së bashku në shkollë.

| **Kapitulli:** Konsultohemi së bashku dhe vendosim<br><br>**Tema mësimore:** Vendimmarrja në komunitet |
|---|

**Situata e të nxënit**: Të marrësh një vendim të drejtë tregon pjekuri dhe zgjuarsi.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë **Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1,3; III.1, 8; IV. 5; V. 6, 8; VI. 2, 5

**RNF**: 1.1;4.1,2

| **Rezultatet e të nxënit të lëndës:** | **Kriteret e suksesit:** |
|---|---|
| Nxënësi/ja:<br><br>- Përshkruan komunitetin si grupin e madh shoqëror, ku merren vendime të rëndësishme.<br>- Përmend pjesëmarrjen e tyre në jetën e komunitetit.<br>- Vlerëson rëndësinë që ka vendimmarrja në komunitet. | - Trego së paku një rast kur të ka mbështetur komuniteti.<br>- Trego një arsye pse janë të rëndësishëm bashkëveprimi dhe mbështetja e komunitetit. |

**Fjalët kyçe**: vendimmarrës, komunitet, egoist, alternativë, preferencë.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Artet.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| kllaster | Bashkëbisedim | Dil rrotull - fol rrotull |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Realizohet një kllaster me fjalën *komunitet,* duke u fokusuar te mbështetja e komunitetit, vendimmarrja, zgjidhja e problemeve.
**Hapi 2** – Kërkohet nga nxënësit që ta japin mendimin e tyre se çfarë dinë për komunitetin.

**PJESA KRYESORE**

Hapet libri.

**Hapi 3** – Lexoni dhe diskutoni për situatën e dhënë në libër.

**Hapi 4** – Kërkoni nga nxënësit ta përshkruajnë dhe ta komentojnë ilustrimin e dhënë.

**Hapi 5** – Punohen pyetjet që janë në librin bazë.

**Hapi 6 -** Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 7** – Kërkohet nga nxënësit që të lëvizin nëpër klasë dhe të përcillet lëvizja me një muzikë oe rrahje shuplakash. Kur mësuesja thotë *stop,* nxënësit kapen për dore dhe japin përgjigjen e pyetjes që thotë mësuesja. Përsëritet disa herë kjo veprimtari që të përgjigjen në sa më shumë pyetje. Pyetjet: Çfarë shqetësimi kishin fëmijët? Si do ta zgjidhnin këtë problem ata? Me kë do të takoheshin? Cili ishte vendimi që mund të merrej?

**VLERËSIMI**

- Komenton dhe diskuton për situatat e dhëna në ilustrim.
- Përshkruan situata nga marrja e vendimeve në komunitet.
- Vlerëson rëndësinë që ka vendimmarrja në komunitet.
- Shpreh lirshëm mendimin e saj/tij.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Vendimmarrja në komunitet.

**Kapitulli:** Konsultohemi së bashku dhe vendosim

**Tema mësimore:** Respektojmë mendimin ndryshe

**Situata e të nxënit** : Mendimi ndryshe krijon mundësi për të ecur përpara.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1,3; III.1, 8; IV. 5; V. 6, 8; VI. 2, 5

**RNF**: 1.1;4.1,2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan mendimin ndryshe si shumë të rëndësishëm që tregon kulturë.
- Mban qëndrim **pro** apo **kundër** mendimit ndryshe.
- Vlerëson rëndësinë që ka mendimi ndryshe për një shoqëri demokratike.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku një rast kur ke shprehur mendimin ndryshe për një problem të caktuar.
- Trego një arsye pse është e rëndësishme të vlerësohet mendimi ndryshe.

**Fjalët kyçe**: diversitet, kamping, paragjykim, shtrat, hatër, qëndrim.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Artet.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Stuhi mendimesh | Bashkëbisedim | Shkrim i lirë |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Realizo një stuhi mendimesh me fjalën *diversitet*. Kërkoni nga nxënësit të shprehin se si e kuptojnë këtë fjalë.

**Hapi 2** – Shkruhen dhe lexohen nga nxënësit mendimet e të gjithëve.

**PJESA KRYESORE**

Hapet libri.

**Hapi 3** – Lexoni dhe diskutoni për situatën e dhënë në libër. A duhen paragjykuar njerëzit?

**Hapi 4** – Kërkoni nga nxënësit ta përshkruajnë dhe ta komentojnë ilustrimin e dhënë.

**Hapi 5** – Punohen pyetjet që janë në librin bazë. Jepen argumenta **pro** dhe **kundër** për situatën e dhënë.

**Hapi 6 -** Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 7** – Shkrim i lirë: "Vlerësoj mendimin ndryshe". Kërkoni nga nxënësit t'i shkruajnë 2 - 3 fjali dhe t'i lexojnë ato.

**VLERËSIMI**

- Komenton dhe diskuton për situatat e dhëna në ilustrim.
- Përshkruan situata ku ka mbizotëruar mendimi ndryshe.
- Vlerëson rëndësinë që ka mendimi ndryshe.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Respektojmë mendimin ndryshe.

| |
|---|
| **Kapitulli:** Konsultohemi së bashku dhe vendosim<br><br>**Tema mësimore:** Përvojat na ndihmojnë |

**Situata e të nxënit**: Përvojat na ndihmojnë për ta bërë akoma më mirë një punë.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1,3; III.1, 8; IV. 5; V. 6, 8; VI. 2, 5

**RNF**: 1.1;4.1,2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan si e ndihmon përvoja njeriun.
- Bën dallimin mes përvojës dhe zakonit.
- Vlerëson rëndësinë që ka përvoja në realizimin e një pune.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku një rast kur të ka ndihmuar përvoja.
- Trego një arsye pse është e rëndësishme përvoja për ty.

**Fjalët kyçe**: përvojë, kordele, i/e veçantë, epitet, lozonjare

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Artet, Shkathtësi për jetën.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Stuhi mendimesh | Bashkëbisedim | Pesëvargësh |

## PJESA HYRËSE

**Hapi 1** – Kërkoni nga nxënësit që të thonë se si e kuptojnë fjalën *përvojë*. Kërkoni përgjigje nga shumë nxënës dhe shkruajini ato në tabelë.

## PJESA KRYESORE

Hapet libri.

**Hapi 2** – Lexoni dhe diskutoni për situatën e dhënë në libër.

**Hapi 3** – Kërkoni nga nxënësit ta përshkruajnë dhe ta komentojnë ilustrimin e dhënë.

**Hapi 4** – Sa herë keni provuar ndonjë punë dhe keni dështuar? Si keni vepruar më pas?

**Hapi 5** – Punohen pyetjet që janë në librin bazë.

**Hapi 6 -** Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

## PJESA PËRFUNDIMTARE

**Hapi 7** – kërkoni nga nxënësit të krijojnë një pesëvargësh për përvojën.

Përvoja

______________ ______________ (2 mbiemra, që tregojnë si është përvoja).

__________ _________ _________ (3 folje,që tregojnë se për çfarë të ndihmon përvoja).

__________________________________________ (1 fjali për familjen).

____________ (një emër tjetër për përvojën, sinonim).

## VLERËSIMI

- Komenton dhe diskuton për situatat e dhëna në ilustrim.
- Përshkruan situata nga përvojat e saj/tij.
- Vlerëson rëndësinë që ka përvoja në jetën e njeriut.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Përvojat na ndihmojnë.

| |
|---|
| **Kapitulli:** Konsultohemi së bashku dhe vendosim<br><br>**Tema mësimore:** Edhe unë vendos |

**Situata e të nxënit**: Fëmijët luajnë rol të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1,3; III.1, 8; IV. 5; V. 6, 8; VI. 2, 5

**RNF**: 1.1;4.1,2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan faktin se sa i dëgjohet fjala në familje.
- Tregon se si merren vendimet në familjen e saj/tij.
- Vlerëson rëndësinë që ka të dëgjuarit e mendimit të saj/tij në familje.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku një rast kur të është dëgjuar fjala dhe është bërë si ke propozuar ti.
- Trego një arsye se pse duhet të merret në konsideratë mendimi yt në familje.

**Fjalët kyçe**: vendos, kuriozitet, shkëmbinj të thepisur, brigje.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Artet.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Termat paraprakë | Lexim dhe diskutim i drejtuar | Ditari dypjesësh |

## PJESA HYRËSE

**Hapi 1** – Me fjalët: vendos vetë, mbështetje, diskutim, zgjidhje e problemit dhe fjalë të tjera që do të shtojnë, kërkoni nga nxënësit të shkruajnë një ngjarje për pesë minuta.

**Hapi 2** – Disa nga nxënësit le t'i lexojnë ngjarjet e tyre.

## PJESA KRYESORE

Hapet libri.

**Hapi 3** – Lexoni dhe diskutoni për situatën e dhënë në libër.

**Hapi 4** – Kërkoni nga nxënësit ta përshkruajnë dhe ta komentojnë ilustrimin e dhënë.

**Hapi 5** – Punohen pyetjet që janë në librin bazë. Cili duhet të vendosë për ju? Nxënësit diskutojnë mbi shkollimin, përdorimin e celularit, si e zgjedhin shokun, librin që do ta lexojnë, emisionin që do ta ndjekin etj.

**Hapi 6 -** Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

## PJESA PËRFUNDIMTARE

**Hapi 7** – Kërkojuni nxënësve që ta ndajnë fletoren me një vijë në mes dhe të shkruajnë në njërën anë për gjërat që ata vendosin vetë, e në anën tjetër do të shkruajnë për gjërat që vendosin prindërit.

## VLERËSIMI

- Komenton dhe diskuton për situatat ku ai përfshihet në diskutim.
- Përshkruan situata kur mendimi i saj/tij merret në konsideratë nga familja.
- Vlerëson rëndësinë që ka pjesëmarrja e tij në vendimmarrje në familje.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Edhe unë vendos.

| **Kapitulli:** Konsultohemi së bashku dhe vendosim<br><br>**Tema mësimore:** Si të marr një vendim të drejtë |
|---|

**Situata e të nxënit**: Nxënësit mësojnë si të marrin një vendim të drejtë.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1,3; III.1, 8; IV. 5; V. 6, 8; VI. 2, 5

**RNF**: 1.1;4.1,2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan mundësinë se si mund të marrin një vendim të drejtë.
- Përmend karakteristikat që ka në momentet e dilemave në marrjen e vendimeve.
- Vlerëson rëndësinë që ka marrja e vendimit të drejtë.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku një rast kur ke marrë një vendim të drejtë për një problem të caktuar.
- Trego një arsye pse është e rëndësishme marrja e vendimeve të drejta.

**Fjalët kyçe**: komunikim, situatë, proces, vendim i drejtë.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Artet.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Diskutim i njohurive paraprake | Bashkëbisedim | Diagrami i Venit |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Kërkoni nga nxënësit të tregojnë se si kanë vepruar për ta marrë vendimin e drejtë? A janë ndodhur në situata të vështira ku u është dashur që të zgjedhin se çfarë vendimi duhet të marrin.

**Hapi 2** – Disa nga nxënësit le ta shprehin mendimin e tyre për sa u tha më lart.

**PJESA KRYESORE**

Hapet libri.

**Hapi 3** – Lexoni dhe diskutoni për situatën e dhënë në libër.

**Hapi 4** – Kërkoni nga nxënësit ta përshkruajnë dhe ta komentojnë ilustrimin e dhënë.

**Hapi 5** – Punohen pyetjet që janë në librin bazë.

**Hapi 6 -** Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij. Si mund ta japim gjithmonë vendimin e drejtë?

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 7** – Kërkoni nga nxënësit që të gjejnë nëpërmjet Diagramit të Venit të veçantat dhe të përbashkëtat që ka marrja e një vendimi të drejtë dhe marrja e një vendimi të gabuar, të nxituar.

**VLERËSIMI**

- Komenton dhe diskuton për situatat e dhëna në ilustrim.
- Përshkruan situata kur ka marrë vendimin e duhur.
- Vlerëson rëndësinë që ka marrja e vendimit të drejtë.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Si të marr një vendim të drejtë?

| **Kapitulli:** Konsultohemi së bashku dhe vendosim |
|---|
| **Tema mësimore:** Vizitë në kuvendin komunal: Si merren vendimet? |

**Situata e të nxënit**: Nxënësit të mësojnë se si merret vendimi në kuvendin komunal.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I.1,3; III.1, 8; IV. 5; V. 6, 8; VI. 2, 5

**RNF**: 1.1;4.1,2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan mënyrën se si merren vendimet.
- Përmend mundësitë se si mund të bëhet një kërkesë për të zgjidhur një problem.
- Vlerëson rëndësinë që ka marrja e vendimeve.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku një rast nëse ke marrë pjesë në një vendimmarrje në komunë.
- Trego një arsye pse është e rëndësishme marrja e vendimeve në kuvendin komunal.

**Fjalët kyçe**: kuvend komunal, vendimmarrje, kërkesë, shqyrtim.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme nga veprimtaria në kuvendin komunal.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**:

Gjuha dhe komunikimi, Arte, Shkathtësi për jetën, Edukata Fizike, Sportet dhe Shëndeti.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Pyetje - Përgjigje | Ekskursion | Votimi |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Diskutoni me nxënësit. Si u bë kërkesa për ta realizuar vizitën në kuvendin komunal? Cila ishte përgjigjia? Si u vendos që të vazhdohej më pas për realizimin e ekskursionit?

**PJESA KRYESORE**

**Hapi 2** – Realizohet vizita në kuvendin komunal.

**Hapi 3** – Pritja nga kryetari i komunës dhe nga të gjithë anëtarët e asamblesë.

**Hapi 4** – Lexohet kërkesa që është përgatitur nga nxënësit. Paraqiten fakte, materiale dhe informacione se përse do t'i votojnë anëtarët e asamblesë.

**Hapi 5 –** Nxënësit japin zgjidhjet e tyre dhe diskutohet rreth mundësive të zgjidhjes së problemit.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 6** – Kalohet në votimin e kërkesës së nxënësve. Vendoset zgjidhja që pranohet nga shumica, që është bindëse dhe e realizueshme.

**VLERËSIMI**

- Komenton dhe diskuton mundësitë e marrjes së vendimeve në kuvendin komunal.
- Përshkruan situata që komuna u jep rëndësi shqetësimeve dhe problemeve të qytetarëve të saj.
- Vlerëson rëndësinë që ka kuvendi komunal në zgjidhjen e problemeve të komunitetit.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune: Tema: Vizitë në kuvendin komunal - si merren vendimet?

| **Kapitulli**: Llojet e pasurive dhe ndarja e tyre<br>**Tema mësimore:** Pasuritë natyrore |
|---|

**Situata e të nxënit**: Të tregojne se pasuritë natyrore ose burimet natyrore janë të mira materiale që gjenden në natyrë dhe që mund të përdoren nga njeriu.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**Fjalët kyçe:** rrezik, kujdes, i panjohur, siguri.

7.
RNSH: I.7; II.1, 6, 7; III.1; IV.1 ; V.9; VI. 7

RNF: 1. 1; 2. 3; 3. 1; 5.1

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Idenifikon llojet e pasurive natyrore.
- Analizon figurat në libër.
- Vlerëson rëndësinë e shfrytëzimit të pasurive natyrore.

**Kriteret e suksesit:**

- Shpreh lirshëm mendimet.
- Listo pasuritë natyrore që di.

**Fjalët kyçe**: pasuri natyrore, diell, ujë, ajër, tokë, kafshë, bimë, minerale, lëndë djegëse.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.
**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Kllaster | Lexim i drejtuar | Pesëvargësh |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Kërkohet nga nxënësit të tregojnë se çfarë dinë për pasuritë natyrore, duke bërë plotësimet e kërkuara.




Plotësimi bëhet në tabelë bashkë me nxënësit.

**PJESA KRYESORE**
Hapet libri.
**Hapi 2** – Lexohet dhe analizohet situata e dhënë. Pyetni:
Çfarë kërkoi mësuesja? Cilat ishin përgjigjet e nxënësve? Përse përdoren pasuritë natyrore?
Kërko nga nxënësit t'i vërejnë figurat në libër dhe të diskutojnë rreth tyre.
**Hapi 3** – Punoni rubrikën e pyetjeve.

- Shkruaj ti çfarë di për pasuritë natyrore?
- Pse janë të rëndësishme ato?
- Pse duhet të kujdesemi ne për mbrojtjen e tyre?

**PJESA PËRFUNDIMTARE**
**Hapi 4** – Kërkoni nga nxënësit të krijojnë një pesëvargësh për pasuritë natyrore.

Pasuritë natyrore.

__________________ __________________2 mbiemra.

__________________ __________________ __________________3 folje.

____________________________________________________________1 fjali.

__________________1 emër tjetër, sinonim.

**VLERËSIMI**
- Idenifikon pasuritë natyrore.
- Analizon figurat në libër.
- Vlerëson rëndësinë e shfrytëzimit të pasurive natyrore.

**Detyrë shtëpie**: Fletore pune: Tema: Pasuritë natyrore.

| **Kapitulli:** Llojet e pasurive dhe ndarja e tyre<br>**Tema mësimore:** Pasuritë nëntokësore |
|---|

**Situata e të nxënit**: Pasuritë natyrore janë mbitokësore dhe nëntokësore.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë **Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

RNSH: I.7; II.1, 6, 7; III.1; IV.1 ; V.9; VI. 7

RNF: 1. 1; 2. 3; 3. 1; 5.1

Fjalët kyçe: rrezik, kujdes, i panjohur, siguri.

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Idenifikon llojet e pasurive nëntokësore.
- Analizon figurat në libër.
- Vlerëson rëndësinë e shfrytëzimit të pasurive nëntokësore.

**Kriteret e suksesit:**

- Shpreh lirshëm mendimet.
- Listo pasuritë nëntokësore dhe mbitokësore.

**Fjalët kyçe**: pasuri mbitokësore, nëntokësore, lëndë djegëse, minerale, shkëmbinj.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**:
Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës. **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Copëza të përziera | Lexim i drejtuar | Ditari dypjesësh |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – U shpërdahen nxënësve në grupe etiketa më fjali si më poshtë. Në mungesë të etiketave, mund t'i shkruani në tabelë si fjalë të përziera si më poshtë.
**Hapi 2** – Kërkoni nga nxënësit në dyshe t'i rregullojnë fjalët dhe të shkruajnë fjali me kuptim.

1. **natyrore, janë, mbitokësore, dhe, pasuritë, nëntokësore**
(Pasuritë natyrore janë mbitokësore dhe nëntokësore).
2. **këto, janë, sipërfaqen, quhen, disa, mbitokësore, nga, në e, pasuri, dhe, pasuri, tokës**
( Disa nga këto pasuri janë në sipërfaqen e tokës dhe quhen pasuri mbitokësore.

3. **pasuri, janë, nëntokë, që, ato, nëntokësore, pasuri, quhen**

(Ato pasuri që janë nën tokë, quhen pasuri nëntokësore.)
**Hapi 3**- Secili grup lexon fjalitë e shkruara dhe bisedohet rreth tyre.

**PJESA KRYESORE**
**Hapi 4** – Lexohet dhe analizohet situata e dhënë.
-Në mes kujt zhvillohet biseda?
-Ku po udhëtonin Ana me prindërit?
-Çfarë mësoi Ana nga ky udhëtim?
-A do të doje të ishe edhe ti me ata? Pse?
**Hapi 5-**Kërko nga nxënësit t'i vërejnë figurat në libër dhe të diskutojnë rreth tyre.
**Hapi 6** – Punoni rubrikën e pyetjeve.

- Çfarë prodhohet në termocentralin e Obiliqit?
- Ku nxirret thëngjilli?
- Si ndahen pasuritë natyrore?
- Çfarë mendoi Ana për tokën? Po ti, çfarë mendon?

**PJESA PËRFUNDIMTARE**
**Hapi 7**–Kërkoni nga nxënësit ta plotësojnë tabelën:

| Çfarë janë pasuritë mbitokësore? | Çfarë janë pasuritë nëntokësore? |
|---|---|
| | |
| Listo disa nga pasuritë mbitokësore. | Listo disa nga pasuritë nëntokësore. |
| | |

Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.

**VLERËSIMI**

- Klasifikon pasuritë mbitokësore dhe nëntokësore.
- Bashkëpunon me grupin.

**Detyrë shtëpie**: Fletore pune: Tema: Pasuritë nëntokësore.

| Kapitulli: Llojet e pasurive dhe ndarja e tyre<br>Tema mësimore: Trashëgimia e profesioneve |
|---|

**Situata e të nxënit**: Të tregojnë se dikur profesionet janë quajtur zeje dhe njerëzit që janë marrë me atë profesion janë quajtur zejtarë.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

RNSH: I.7; II.1, 6, 7; III.1; IV.1 ; V.9; VI. 7

RNF: 1. 1; 2. 3; 3. 1; 5.1

Fjalët kyçe: rrezik, kujdes, i panjohur, siguri.

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Liston zeje të ndryshme të vendit tonë.
- Përshkruan disa nga zejet që janë trashëguar brez pas brezi.
- Vlerëson rëndësinë e ruajtjes së profesioneve të trashëguara.

**Kriteret e suksesit:**

- Shpreh lirshëm mendimet.
- Bashkëpuno në grup për një punë cilësore.

**Fjalët kyçe**: trashëgimi, profesion, plisaxhi, argjentar, nallban, zdrukthëtar, vorbëtar.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, fotografi, videoprojektor, punime dore.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.
**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Pyetja sjell pyetjen | Xhigsou | I ftuari në klasë |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Përgatitni pamje në videoprojektor ose fotografi, në të cilat tregohen punime nga zejtarë të ndryshëm, si p.sh. punime argjendi, veshje që përdoren nëpër ahengje të ndryshme që janë të punuara me fije ari (dallamë, jelek), zbukurime të ndryshme të shtëpisë të punuara me dorë, veshje tradicionale, enë balte etj. Mund të kërkoni nga nxënësit që të sjellin në klasë punime dore të ndryshme që kanë në shtëpi.
**Hapi 2** – Bashkë me nxënësit bisedoni për ato punime.

- *Kush merret me punimin e tyre?*
- *Si quhen njerëzit që merren me këto punime?*
- *A kanë vlerë këto punime? Pse?*

**Hapi 3**- Tregoju nxënësve se njerëzit që merren me këto punime quhen zejtarë.

**PJESA KRYESORE**

Hapet libri.
**Hapi 4** – Lexohet dhe analizohet situata e dhënë.
Nxënësit ndahen në 5 grupe dhe secili grup analizon informacionin dhe fotografinë për njërën zeje që kanë paraqitur nxënësit në projektin e dhënë në libër. Po ashtu, ata edhe do të shtojnë atë çka dinë, çka kanë dëgjuar ose çka kanë parë për këto zeje.
Grupi 1-ZDRUKTHTARËT
Grupi 2-NALLBANËT
Grupi 3-VORBËTARËT
Grupi 4-PLISAXHINJTË
Grupi 5-ARXHENDARËT
Grupet punën e tyre do ta prezantojnë para të tjerëve.
**Hapi 6** – Punoni rubrikën e pyetjeve.

- Pse ruhen këto zeje?
- A është përcjellë ndonjë zeje në familjen tuaj nga gjenerata në gjeneratë?

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 7**–Ftoni në klasë një zejtar, që mund të jetë i afërm i ndonjërit nxënës dhe të tregojë për punën që e bën.
Nxitni nxënësit të bëjë pyetje rreth asaj zeje.
(Mund edhe të vizitohet punëtoria e tij/saj).

**VLERËSIMI**

- Vlerëson rëndësinë e profesioneve të trashëguara.
- Bën pyetje për të marrë sa më shumë informacion nga zejtari i ftuar.

**Detyrë shtëpie**: Fletore pune: Tema: Trashëgimia e profesioneve.

| **Kapitulli:** Llojet e pasurive dhe ndarja e tyre<br>**Tema mësimore:** Kursejmë energjinë |
|---|

**Situata e të nxënit**: Njerëzit duhet ta kursejnë energjinë. Si kursimi, edhe përdorimi i mirë i energjisë, sjellin dobi.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

RNSH: I.7; II.1, 6, 7; III.1; IV.1 ; V.9; VI. 7

RNF: 1. 1; 2. 3; 3. 1; 5.1

Fjalët kyçe: rrezik, kujdes, i panjohur, siguri.

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan raste të kursimit të energjisë elektrike.
- Analizon mënyra të kursimit të energjisë elektrike.
- Vlerëson rëndësinë e prodhimit të energjisë alternative.

**Kriteret e suksesit:**

- Shpreh lirshëm mendimet.
- Trego raste të kursimit të energjisë elektrike.

**Fjalët kyçe**: energji, kursim, pasuri të papërtëritshme, pasuri të përtëritshme.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, fotografi, fletë A/3.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.
**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Diskutim i drejtuar | Të nxënit në bashkëpunim | Punë krijuese |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** –Paraqitni të shkruara në fletë A/4 ose në tabelë fjalitë më poshtë. Kërkoni nga nxënësit t'i analizojnë ato fjali. Nxitni një diskutim në klasë për kursimin e energjisë.

***Kursimi i energjisë është kulturë! Kurse energjinë, kursen para!***

***Përdorimi i pakursyer i energjisë ndot ambientin!***

**PJESA KRYESORE**

Hapet libri.

**Hapi 2** – Lexohet dhe analizohet situata e dhënë.

**Hapi 3** – Punoni rubrikën e pyetjeve.

- Cila ishte biseda mes gjyshit e Anës?
- A kishte të drejtë gjyshi? Pse?
- Pse është e rëndësishme të kursehet energjia elektrike?
- A mund të jetojmë pa energji elektrike?
- Trego raste, kur ti kursen energjinë elektrike?

**Hapi 4**- Kërkoni nga nxënësit të shkruajnë një këshillë që e dëgjojnë nga prindërit për kursimin e energjisë elektrike.

**Hapi 5-** Disa nga nxënësit lexojnë këshillën e shkruar.

**Hapi 6** –Lexohet informacioni i dhënë. Diskutohet me nxënësit: **pse është shumë i rëndësishëm prodhimi i energjisë alternative?**

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 7** –Nxënësit në grupe të krijojnë një poster për kursimin e energjisë elektrike. Punimet do të ekspozohen dhe do të zgjedhet posteri më i bukur dhe më domethënës.

**VLERËSIMI**

- Vlerëson rëndësinë e prodhimit të energjisë alternative.
- Tregon bukur raste nga jeta e tij për kursimin.

**Detyrë shtëpie**: Fletore pune: Tema: Kursejmë energjinë.

| **Kapitulli:** Llojet e pasurive dhe ndarja e tyre<br>**Tema mësimore:** Riciklimi i mbetjeve |
|---|

**Situata e të nxënit**: Riciklimi është procesi i ripërpunimit të mbeturinave.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

RNSH: I.7; II.1, 6, 7; III.1; IV.1 ; V.9; VI. 7

RNF: 1. 1; 2. 3; 3. 1; 5.1

Fjalët kyçe: rrezik, kujdes, i panjohur, siguri.

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan mënyrën e riciklimit të mbeturinave.
- Kategorizon mbeturinat sipas llojit.
-Vlerëson rëndësinë e riciklimit dhe të ripërpunimit të mbeturinave.

**Kriteret e suksesit:**

- Kategorizo mbeturinat sipas llojit.
- Trego së paku dy arsye për rëndësine e klasifikimit të mbeturinave.

**Fjalët kyçe** :riciklim, ripërdorim, klasifikim, mbrojtje.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune,

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.
**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Brainstorming/Shqyrtimi kategorizues | Të nxënit në bashkëpunim | Punë krijuese |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Pyetni nxënësit se çfarë u vjen në mendje kur përmendet fjala **riciklim.**
Mendimet e nxënësve shkruhen në tabelë dhe diskutohet rreth tyre.
**Hapi 2**- Kërkoni nga nxënësit të tregojnë se si bëhet klasifikimi i mbeturinave në grupe dhe diskutoni për to.

**PJESA KRYESORE**
Hapet libri**.**
**Hapi 3** – Lexohet dhe analizohet situata e dhënë.

**Hapi 4** – Punoni rubrikën e pyetjeve.

- Çfarë mendoni ju për këtë nismë?
- A ndodh në shkollën tuaj riciklimi i mbeturinave?
- Pse është i rëndësishëm riciklimi i mbeturinave?
- A do të doje edhe ti të ishe pjesë e ekipit të riciklimit? Pse?
- Bashkë me nxënësit, në orën e Edukatës fizike, organizoni në shkollë një aksion të tillë.

**Hapi 5-** Lexohet informacioni i dhënë dhe analizohet. Kërkoni nga nxënësit të shpjegojnë se pse thuhet që: ***KLASIFIKIMI, RIPËRDORIMI dhe RICIKLIMI janë tri fjalët më të rëndësishme që ndihmojnë natyrën dhe mjedisin ku jetojmë.***

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 7** –Nxënësit ta vizatojnë dorën dhe në secilin gisht t'u përgjigjen pyetjeve:
1.**Kush** i grumbullon mbeturinat?
2.**Çfarë** duhet bërë me mbeturinat?
3.**Ku** duhet hedhur ato?
4.**Kur** hidhen mbeturinat?
5.**Pse** duhen ricikluar mbeturinat?
6.**Si** riciklohen mbeturinat?
7.7.Shkruajnë një mesazh për riciklimin e mbeturinave.




**VLERËSIMI**

- Vlerëson rëndësinë e riciklimit të mbeturinave.
- Jep argumente bindëse për rëndësinë e riciklimit të mbeturinave.

**Detyrë shtëpie**: Fletore pune: Tema: Riciklimi i mbetjeve.

| Kapitulli: Llojet e pasurive dhe ndarja e tyre<br>Tema mësimore: Veprimtaria 4: Ta mbrojmë mjedisin ku jetojmë |
|---|

**Situata e të nxënit**: Riciklimi është procesi i ripërpunimit të mbeturinave.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

RNSH: I.7; II.1, 6, 7; III.1; IV.1 ; V.9; VI. 7

RNF: 1. 1; 2. 3; 3. 1; 5.1

Fjalët kyçe: rrezik, kujdes, i panjohur, siguri

9.

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Formojnë poster për kursimin e energjisë, të ujit dhe të drunjve.
- Mban ligjëratë për kursimin e energjisë, të ujit dhe të drunjve.
- Interviston shokët/shoqet në lidhje me kursimin e energjisë, të ujit dhe të drunjve.

**Kriteret e suksesit:**

- Shkruaj një thënie të bukur për kursimin e energjisë, të ujit dhe të drunjve.
- Shkruaj disa pyetje për intervistën me nxënës.

**Fjalët kyçe**: mbrojtje, kursim, ujë, energji elektrike, dru.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, fleta A/3

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arti pamor, Jeta dhe puna, Shkencat e natyrës.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Brainstorming/Shqyrtimi kategorizues | Të nxënit në bashkëpunim | Punë krijuese |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Kërkoni nga nxënësit të ndahen në tri grupe dhe të krijojnë postera për:

Grupi 1: mbrojtjen dhe kursimin e ujit.

Grupi 2: kursimin i energjisë elektrike.

Grupi 3: mbrojtjen dhe kursimin e drunjve.

**Hapi 2**- Kërkoni nga nxënësit të shkojnë nëpër klasat e tjera dhe t'i tregojnë posterat dhe meazhin që japin ata. Kjo le të bëhet me qëllim të socializimit të nxënësve.

**Hapi 3** – Disa nxënës që kanë marrë si detyrë të përgatitin një ligjëratë për kursimin e energjisë, të ujit dhe të drunjve, ta mbajnë atë para nxënësve të klasave të tjera.

**Hapi 4** – Nxënësit, që kanë përgatitur pyetjet rreth kësaj teme, le të bëjnë një intervistë me nxënësit e klasave të tjera.

**VLERËSIMI**

- Vlerëson mesazhin e paraqitur në poster.
- Bashkëpunon me shokët/shoqet e grupit.

**Detyrë shtëpie** : Fletore pune – Tema: Veprimtaria 4- Ta mbrojmë mjedisin ku jetojmë.

| **Kapitulli:** Gjendja e mjedisit në vendbanimin tim<br><br>**Tema mësimore:** Njeriu dhe mjedisi natyror |
|---|

**Situata e të nxënit**: Kujdesi për mjedisin jetësor është detyrë e çdo banori në planetin tokë.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I. 1,7; II. 1,6, 7; III. 4; IV. 5; V. 1,9;

**RNF**: 2.3; 5.1,2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan mjedisin natyror ku jeton.
- Përmend disa gjëra që e bëjnë jetën e saj/ tij të lumtur.
- Vlerëson rëndësinë që ka natyra për jetën e njeriut.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku një gjë që e bën jetën tënde të lumtur.
- Trego një arsye pse duhet të kujdesesh për natyrën.

**Fjalët kyçe**: natyrë, gjelbërim, kujdes, çmoj, e dobishme.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arte, Njeriu dhe Natyra, Shkathtësi për jetën.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Termat paraprakë | Të nxënit në bashkëpunim | Shkrim i lirë |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Me fjalët: natyrë, njeri, diskutim, kujdes dhe fjalë të tjera që do të shtojnë, kërkoni nga nxënësit të shkruajnë se çfarë dinë ata për natyrën.

**Hapi 2** – Disa nga nxënësit le ta lexojnë atë që kanë shkruar.

**PJESA KRYESORE**

Hapet libri.

**Hapi 3** – Lexoni dhe diskutoni për situatën e dhënë në libër.

**Hapi 4** – Kërkoni nga nxënësit ta përshkruajnë dhe ta komentojnë ilustrimin e dhënë. Të flasin pse është e rëndësishme që të kujdesen për natyrën.

**Hapi 5** – Punohen pyetjet që janë në librin bazë.

**Hapi 6 -** Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 7** – kërkoni nga nxënësit t'i shkruajnë 2-3 fjali se si kudesen për një bimë/ kafshë që kanë në shtëpi.

**VLERËSIMI**

- Komenton dhe diskuton për situatën e dhënë në ilustrim.
- Përshkruan se si kujdeset për natyrën.
- Shpreh lirshëm mendimin e saj/tij.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune – Tema: Njeriu dhe mjedisi natyror.

| **Kapitulli:** Gjendja e mjedisit në vendbanimin tim<br><br>**Tema mësimore:** Njeriu dhe mjedisi kulturor |
|---|

**Situata e të nxënit**: Kultura është një përmbledhje e gjuhës, e stileve të jetesës, e bindjeve, e zakoneve, e vlerave, e besimeve, e normave etj.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I. 1,7; II. 1,6, 7; III. 4; IV. 5; V. 1,9;

**RNF**: 2.3; 5.1,2

| **Rezultatet e të nxënit të lëndës:** | **Kriteret e suksesit:** |
|---|---|
| Nxënësi/ja:<br><br>- Përshkruan se çfarë është kultura.<br>- Përmend disa prej gjërave që përmblidhen te kultura.<br>- Vlerëson rëndësinë që ka kultura e një vendi si trashëgimi e të parëve. | - Trego së paku një tregues që flet për kulturën tonë.<br>- Trego një arsye pse është e rëndësishme trashëgimnia kulturore e një vendi. |

**Fjalët kyçe**: mjedis, kulturë, besim, normë, vlerë, muze, bibliotekë, stil.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe komunikimi, Arte, Shkathtësi për jetën.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Stuhi mendimesh | Të nxënët bashkëpunues | Pesëvargëshi |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Realizo me nxënësit një stuhi mendimesh. Kërko prej tyre që të tregojnë se çfarë dinë për mjedisin kujturor. Shkruhen të gjitha mendimet e nxënësve në dërrasën e zezë.

**PJESA KRYESORE**

Hapet libri.

**Hapi 2** – Nxënësit diskutojnë rreth figurës së paraqitur në tekst.

**Hapi 3** - Lexoni dhe diskutoni për situatën e dhënë në libër.

**Hapi 4** – Kërkoni nga nxënësit ta përshkruajnë dhe ta komentojnë ilustrimin e dhënë.

**Hapi 5** – Punohen pyetjet që janë në librin bazë.

**Hapi 6 -** Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 8** – kërkoni nga nxënësit të krijojnë një pesëvargësh për kulturën.

Pjesëmarrje

_______________ _____________ (2 mbiemra, që tregojnë si është kultura).

______________ _____________ ____________ (3 folje, që tregojnë rëndësinë e kulturës).

______________________________________________ (1 fjali për kulturën).

_____________ (një emër tjetër për kulturën, sinonim).

**VLERËSIMI**

- Komenton dhe diskuton për situatën e dhënë në ilustrim.
- Përshkruan nga se është e përbërë kultura.
- Vlerëson rëndësinë që ka mjedisi kulturor i një vendi.
- Shpreh lirshëm mendimin e saj/tij.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune – Tema: Njeriu dhe mjedisi kulturor.

| |
|---|
| **Kapitulli:** Gjendja e mjedisit në vendbanimin tim<br><br>**Tema mësimore:** Një mjedis i pastër për të gjithë |

**Situata e të nxënit**: Për një mjedis të pastër duhet të luftojmë të gjithë.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I. 1,7; II. 1,6, 7; III. 4; IV. 5; V. 1,9;

**RNF**: 2.3; 5.1,2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan mjedisin në shkollë.
- Përshkruan mjedisin në komunitetin ku jeton.
- Vlerëson rëndësinë që ka gjelbërimi i mjedisit.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku një rast kur ke marrë pjesë në pastrimin e mjedisit në shkollë apo në komunitet.
- Trego një arsye pse është i rëndësishëm mjedisi i pastër.

**Fjalët kyçe**: gjelbërim, ndotje, park, pastërti, protestë.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuha dhe Komunikimi, Artet, Njeriu dhe Natyra.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Tryezë e rrumbullakët | Të nxënëst në bashkëpunim | Marrdhënia pyetje - përgjigje |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Nxënësit forojnë një tryezë të rrumbullakët. Ata diskutojnë me njëri - tjetrin rreth mjedisit. Çfarë duhet të bëjë secili prej tyre për një mjedis të pastër.

**PJESA KRYESORE**

Hapet libri.

**Hapi 2** – Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin se pse po ndodhte protesta?

**Hapi 3** – Kërkohet të diskutojnë pse janë të rëndësishme protestat?

**Hapi 4** – Diskutohet rreth habisë së Anës dhe faktit nëse ajo kishte të drejta apo jo.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 5** – Përgatit etiketa me numrat nga 1-5. Përgatiten disa pyetje dhe iu drejtohen nxënësve për: mjedisin në shkollë, mjedisin në komunitet, kujdesin ndaj tyre, aksione që nxënësit kanë realizuar në shkollë apo në komunitet, etj. Nxënësit vlerësojnë njëri - tjetrin me pikë për përgjigjet e dhëna.
**Hapi 6** – Nxënësve u kërkohet të vizatojnë një mjedis se si do ta dëshironin ata.

**VLERËSIMI**

- Flet për mjedisin në shkollë dhe në komunitet.
- Përshkruan si realizohet një protestë.
- Vlerëson rëndësinë që ka mjedisi i pastër.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune – Tema: Një mjedis i pastër për të gjithë.

| |
|---|
| **Kapitulli:** Gjendja e mjedisit në vendbanimin tim<br><br>**Tema mësimore:** Kujdesem për higjienën personale |

**Situata e të nxënit**: Higjiena personale na ndihmon për një shëndet të mirë.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I. 1,7; II. 1,6, 7; III. 4; IV. 5; V. 1,9;

**RNF**: 2.3; 5.1,2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan kujdesin që tregon për higjienën personale.
- Tregon se si vepron për të patur një higjienë të mirë personale.
- Vlerëson rëndësinë që ka higjiena personale për një shëndet të mirë.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku një veprimin tëndin ku tregon kujdesin për higjienën personale.
- Trego një arsye pse është e rëndësishme mbajtja e higjienës personale te njeriu.

**Fjalët kyçe**: higjienë personale, pastërti, kujdes, kontroll, rregull.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme, mjete të higjienës personale.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**:
Gjuha dhe komunikimi, Artet, Shkathtësi për jetën.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Stuhi mendimesh | Imagjinatë e drejtuar | Shkrim i lirë |

**PJESA HYRËSE**

**Hapi 1** – Kërkoju nxënësve që t'i shprehin mendimet e tyre se çfarë kuptojnë me higjienë personale? Të gjitha mendimet e nxënësve i shkruani në dërrasën e zezë.

**Hapi 2** – Nxënësit japin mendime për higjienën e tyre personale.

**PJESA KRYESORE**

Hapet libri.

**Hapi 3** – Lexoni dhe diskutoni për situatën e dhënë në libër. Mendimet e mësueses.

**Hapi 4** – Kërkoni nga nxënësit ta imagjinojnë planin e Matit. Si mendon që ta organizojë Mati planin javor?

**Hapi 5** – Punohen pyetjet që janë në librin bazë.

**Hapi 6 -** Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

**PJESA PËRFUNDIMTARE**

**Hapi 7** – U kërkohet nxënësve që t'i shkruajnë për 5 minuta 2-3 fjali: “Kujdesem për higjienën time personale”.

**VLERËSIMI**

- Diskuton për situatën e dhënë në ilustrim.
- Përshkruan mënyrën se si kujdeset për higjenën e saj/tij personale.
- Ndërton një plan veprimi për t'u kujdesur për higjienën personale.
- Shpreh lirshëm mendimin e saj/tij.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune – Tema: Kujdesem për higjienën personale.

| |
|---|
| **Kapitulli:** Gjendja e mjedisit në vendbanimin tim<br>**Tema mësimore:** Higjiena në komunitet |

**Situata e të nxënit**: Fëmijët ndihmojnë për ta mbajtur pastër komunitetin ku jetojnë.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** I. 1,7; II. 1,6, 7; III. 4; IV. 5; V. 1,9;

**RNF**: 2.3; 5.1,2

| **Rezultatet e të nxënit të lëndës:** | **Kriteret e suksesit:** |
|---|---|
| Nxënësi/ja:<br><br>- Përshkruan mjedisin e komunitetit ku jeton.<br>- Përmend raste të aksioneve që kanë bërë për higjienën dhe pastërtinë në komunitetin e tyre.<br>- Vlerëson rëndësinë që ka mbajtja pastër e ambientit në komunitetin ku jetojnë. | - Trego së paku një rast kur ke marrë pjesë në ndonjë aksion që është organizuar në komunitetin ku ti jeton.<br>- Trego një arsye pse është e rëndësishme mbajtja pastër e mjedisit të komunitetit. |

**Fjalët kyçe**: higjienë, komunitet, kujdes, përgjegjësi, pastërti, mikrob, parazit, angazhim.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto të ndryshme.
**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**:
Gjuha dhe komunikimi, Arte, Njeriu dhe Natyra, Shkathtësi për jetën.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Imagjinata e drejtuar | Të nxënëst në bashkëpunim | Diskutim i lirë |

## PJESA HYRËSE

**Hapi 1** – Kërko nga nxënësit që ta shprehin mendimin e tyre se si do të veprojnë në komunitetin e tyre për të përmirësuar higjenën dhe pastërtinë. Pyeten nxënësit se çfarë mund të bëjnë?

**Hapi 2** – Nxënësit shprehin mendimet e tyre rreth situatës për pesë minuta dhe japin propozime konkrete.

## PJESA KRYESORE

Hapet libri.

**Hapi 3** – Lexoni dhe diskutoni për situatën e dhënë në libër.

**Hapi 4** – Bëhen pyetjet që jepen në tekst. Kërkoni nga nxënësit të përshkruajnë dhe ta japin mendimin e tyre se çfarë zgjidhje do t'i jepnin situatës së dhënë. Si do të vepronin ata në komunitetin e tyre?

**Hapi 5** – Punohet me nxënësit, duke kaluar nga pyetja në pyetje, sipas propozimeve që ata do të bëjnë.

**Hapi 6 -** Lexohet informacioni i dhënë dhe diskutohet rreth tij.

## PJESA PËRFUNDIMTARE

**Hapi 7** – Kërkoni nga nxënësit të diskutojnë rreth ndonjë rasti konkret, nëse kanë bërë ndonjë aksion në lagjen e tyre.

## VLERËSIMI

- Komenton dhe diskuton për situatën e dhënë në ilustrim.
- Tregon se si do të vazhdojë më tej situata.
- Përshkruan një veprimtari që ka kryer në komunitetin ku jeton.
- Shpreh lirshëm mendimin e saj/tij.
- Vlerëson rëndësinë që ka mbajtja e higjienës në komunitet.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune – Tema: Higjiena në komunitet.

| |
|---|
| **Tema mësimore:** Lojë zbavitëse / loja me ruletë |

**Situata e të nxënit**: Nëpërmjet lojës, nxënësit t'i kontrollojnë njohuritë e marra në çdo muaj të vitit shkollor.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** *I. 1,2, 7; II. 1; III. 2, 4; IV. 3; V. 8; VI. 1*

**RNF**: 1.1; 2.1; 3.1; 4.1; 5.2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan informacionin dhe njohuritë e marra gjatë vitit shkollor.
- Përmend vështirësitë që ka hasur gjatë të mësuarit.
- Vlerëson rëndësinë që ka marrja e njohurive të sakta nga ana e tyre.

**Kriteret e suksesit:**

- Përgjigju së paku dy pyetjeve te loja me ruletë.
- Trego një arsye pse është e rëndësishme t'u përgjigjeni saktë pyetjeve të planifikuara për çdo muaj të vitit.

**Burimet**: Libri i nxënësit, ruletë, çertifikatë, foto të ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**:

Gjuha dhe komunikimi, Arte, Matematika, Njeriu dhe Natyra, Shkathtësi për jetën, Edukata Fizike, Sportet dhe Shëndeti.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Loja me ruletë | Konkursi mësimor | Diskutim i lirë |

## PJESA HYRËSE

**Hapi 1** – Sqarohen nxënësit për mënyrën e organizimit të lojës. Ndahen ata në dy grupe. Secili grup zgjedh liderin e tij. Përgatiten për konkurs.

**Hapi 2** – Bëhen pyetje nga nxënësit, në qoftë se kanë ndonjë gjë të paqartë rreth lojës.

## PJESA KRYESORE

**Hapi 3** – Nxënësit me radhë vijnë dhe rrotullojnë ruletën. Aty ku ndalon ruleta, te pyetja përkatëse, nxënësi duhet të përgjigjet saktë.

**Hapi 4** – Nxënësi vlerësohet për përgjigjen e dhënë. Shokët bëjnë plotësimet e duhura.

**Hapi 5** – Fiton konkursin grupi që grumbullon më shumë pikë.

**Hapi 6 –** Grupi fitues vlerësohet edhe me çertifikatë: Për njohuri të sakta shkencore në lëndën "Shoqëria dhe Mjedisi 3".

## PJESA PËRFUNDIMTARE

**Hapi 7** – Zhvillohet një diskutim i lirë me nxënësit për arritjet, mangësitë e këtij vitit akademik. Shikohen mundësitë për arritje edhe më të mira në të ardhmen.

## VLERËSIMI

- Jep përgjigje të sakta rreth pyetjeve që i bëhen.
- Aktivizohet në përgjigjet që duhet t'i japë grupi që përfaqëson.
- Formulon fjali të plota dhe të sakta gjatë konkursit.
- Analizon me kujdes përgjigjen që duhet të japë.
- Argumenton përgjigjen e tij, duke marrë pjesë aktivisht në konkurs.

| |
|---|
| **Tema mësimore:** Provo veten |

**Situata e të nxënit**: Qëndrueshmëria e njohurive të marra gjatë gjithë vitit.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë **Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** *I. 1,2, 7; II. 1; III. 2, 4; IV. 3; V. 8; VI. 1*

**RNF**: 1.1; 2.1; 3.1; 4.1; 5.2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan ngjarje, situata, fenomene nga jeta në familje, në shkollë dhe në komunitet.
- Përmend karakteristikat e anëtarëve të grupeve shoqërore të familjes, të shkollës dhe të shoqërisë.
- Vlerëson rëndësinë e institucioneve të tilla, si: familja, shkolla dhe shoqëria për të ardhmen e fëmijëve.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku një rast kur ke patur sukses në familje, në shkollë dhe në komunitet.
- Trego një arsye pse është e rëndësishme të vlerësohet mbështetja e familjes, e shkollës dhe e komunitetit në jetën e nxënësve.

**Burimet**: Fletore pune

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**:
Gjuha dhe komunikimi, Arte, Matematika, Njeriu dhe Natyra, Shkathtësi për jetën

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Sqarimi paraprak | Puna e pavarur | Diskutimi i lirë |

## PJESA HYRËSE

**Hapi 1** – Sqaroni nxënësit se si do të punojnë për zgjidhjen e ushtrimeve që janë dhënë te Fletorja e punës.

## PJESA KRYESORE

**Hapi 3** – Nxiten nxënësit që t'i punojnë ushtrimet që janë vendosur te rubrika "Provo veten", në Fletore pune 3.

**Hapi 4** – Kërkoni nga nxënësit të përshkruajnë se si i kanë plotësuar ushtrimet e dhëna.

**Hapi 5** – Kërkohet nga nxënësit ta arsyetojnë logjikën e zgjidhjes së ushtrimeve.

**Hapi 6 –** Lexohen ushtrimet e punuara dhe diskutohet rreth tyre.

## PJESA PËRFUNDIMTARE

**Hapi 7** – Kërkoni nga nxënësit të tregojnë qëndrueshmërinë e njohurive të marra gjatë gjithë klasës së tretë.

## VLERËSIMI

- Plotëson fjalitë e dhëna me fjalët që mungojnë.
- Përshkruan bukuritë natyrore të vendit të saj/tij.
- Nëpërmjet numrave, gjen shkronjën dhe zbulon fjalinë, të cilën e shkruan në hapësirën e duhur.
- Analizon një ngjarje të caktuar, duke shprehur mendimin e saj/tij nëpërmjet diskutimit të lirë.

**Detyrë shtëpie:** Fletore pune – Tema: Provo veten.

**Tema mësimore:** Projekti "Gazeta jonë"

**Situata e të nxënit**: Informimi i nxënësve nëpërmjet gazetës së klasës/shkollës.

**Fusha kurrikulare**: Edukim për shoqërinë / **Lënda:** Edukim për shoqërinë

**Shkalla e kurrikulës**: II / **Klasa**: III

**RNSH:** *I. 1,2, 7; II. 1; III. 2, 4; IV. 3; V. 8; VI. 1*

**RNF**: 1.1; 2.1; 3.1; 4.1; 5.2

**Rezultatet e të nxënit të lëndës:**
Nxënësi/ja:

- Përshkruan saktë ngjarjet që kërkon të përcjellë nëpërmjet gazetës.
- Evidenton njohuritë e marra gjatë vitit akademik.
- Përmend data dhe fakte të rëndësishme në materialet përshkruese.
- Vlerëson rëndësinë që ka pasqyrimi i informacioneve të ndryshme nëpërmjet gazetës.

**Kriteret e suksesit:**

- Trego së paku një material që ti e ke dorëzuar për gazetën që keni bërë.
- Trego një arsye pse është e rëndësishme përgatitja e gazetës në klasë/shkollë.

**Fjalët kyçe**: gazetë, informacion, material, sistemim, diskutim.

**Burimet**: Libri i nxënësit, fletore pune, foto, informacione të ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**:

Gjuha dhe komunikimi, Arte, Matematika, Njeriu dhe Natyra, Shkathtësi për jetën, Edukata Fizike, Sportet dhe Shëndeti.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

| Pjesa hyrëse | Pjesa kryesore | Pjesa përfundimtare |
|---|---|---|
| Mbledhja e informacionit | Hartimi i gazetës | Vlerësimi i projektit |

## PJESA HYRËSE

**Hapi 1** – Nxënësve u është bërë e qartë që në fillim të vitit akademik që t'i ruajnë të gjitha punimet më të mira, sukseset që kanë arritur, informacionet e grumbulluara etj. Nxënësit ndajnë detyrat. Ata marrin informacionet e duhura për hartimin e gazetës.
**Hapi 2** – Kërkohet mendim nga nxënësit për vendosjen e emrit të gazetës: Toleranca/ Mirëkuptimi / etj ... . Me mendimin e shumicës vendoset emri i gazetës.

## PJESA KRYESORE

**Hapi 3** – Sistemimi i krijimeve të nxënësve, i arritjeve dhe i rezultateve të suksesshme që kanë patur gjatë vitit etj.

**Hapi 4** – Priten artikuj, fakte, ngjarje, kuriozitete ose raporte statistikore.

**Hapi 5** – Gjërat e prera vendosen mbi një tabak të bardhë letre, që do të shërbejë si format i gazetës. Më pas, kjo ekspozohet në klasë. Aty tregohen disa prej arritjeve të nxënësve.

**Hapi 6 –** Gjatë punës me projektin merren parasysh: tema e projektit, synimi, objektivat që do të arrihen, përshkrimi i projektit, pjesëmarrësit në projekt, përfituesit e tij, format e punës, afati i realizimit, produkti i punës.

## PJESA PËRFUNDIMTARE

**Hapi 7** – Në fund bëhet vlerësimi i gjithë projektit. Evidentohen vështirësitë që hasën nxënësit gjatë punës, evidentohen sukseset e tyre përgjatë gjithë vitit, vihet theksi te njohuritë dhe shprehitë e fituara në këtë lëndë. Në fund, finalizohet punimi i projektit, i cili ekspozohet në mjediset e klasës/shkollës.

## VLERËSIMI

- Merr pjesë në grumbullimin e materialeve.
- Aktivizohet për nxjerrjen e informacioneve.
- Përpunon dhe sistemon informacionet e nxjerra.
- Analizon materialet që duhet të vendosen në gazetë.
- Argumenton rëndësinë që ka hartimi i gazetës.

**Ekskursion: "Shijojmë bukuritë natyrore të vendit tonë"**

Mësuesi organizon një ekskursion që zgjat dy orë i lihet mësuesit që të vendosë së bashku me nxënësit vendin se ku do të shkojnë dhe se çfarë do të shikojnë. Vendimi merret, pasi bien dakord të gjithë nxënësit e klasës se cilën prej bukurive natyrore të zonës së tyre do të vizitojnë. Në rast se nuk janë të gjithë dakord për të shkuar në të njëjtin vend, atëherë bëhet me votim. Klasa do të shkojë në vendet, që bie dakord shumica e klasës.

Mësuesi/ja mendon që të organizojë edhe bisedë me nxënësit, për t'i njohur ata më mirë me bukurisë natyrore që do të vizitojnë dhe të marrin më shumë informacion rreth tyre. Organizohen diskutime në minigrupe për të veçantat që vë re secili grup.

Në fund, bëhet konkluzioni i gjithë aktivitetit, ku nxënësit tregojnë për mbresat e tyre nga ekskursioni që organizuan. Ajo që vlen të theksohet, është fakti që nxënësit duhet të dinë t'i shijojnë bukuritë natyrore të vendit të tyre dhe t'i vlerësojnë pasuritë natyrore të vendit ku jetojnë.